



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në “Bashkinë Vau Dejës”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
“FINANCIAR”
TË USHTRUAR NË BASHKINË VAU DEJËS”

Tiranë, Mars 2023

Nr.	Përmbajtja	Faqe
	Legjenda dhe shkurtimet	1-3
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4-13
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4-4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-10
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	11-13
II.	HYRJA	13-19
1.	Objekti i auditimit	13-13
2.	Qëllimi i auditimit	13-14
3.	Identifikimi i çështjes	14-14
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	14-14
5.	Përgjegjësitë e audituesve	15-16
6.	Kriteret e vlerësimit	16-16
7.	Standardet e auditimit	16-17
8.	Metodat e auditimit	17-18
9.	Dokumentimi i auditimit	18-19
	III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	20-149
10	-Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	20-20
12	IV. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	21-117
11	1 Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin	21-31
12	2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit	31-40
13	3. Mbi burimin e krijimit të të ardhurave dhe mbledhja e tyre	40-60
14	4. Vlerësimi i raportimit financiar	60-81
15	5. Zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme	81-114
16	6. Ankesa	115-117
	IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	118-132
	V. ANEKSE	133-149

Shkurtime

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
SHA	Shoqëri Anonimë.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1021/1 prot., datë 15.11.2022 të miratuara nga Kryetari i KLSH, nga data 21.11.2022 deri më datë 23.12.2022 në institucionin Bashkia Vau Dejës u krye në teren auditimi “Financiar”.

Auditimi mbuloi periudhën nga data 01.01.2021 deri në 31.12.2021 dhe u shtri mbi çështjet kryesore të veprimtarisë së institucionit si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare dhe të ardhurat. Për përfitimin e rezultateve të auditimit, grupi i auditimit u mbështet mbi dy elementë: në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe në punën konkrete mbi evidencat e auditimit, por kryesisht mbi këtë të fundit. Audituesit janë kujdesur që evidencat me të cilat kanë punuar për të argumentuar rezultatet e auditimit, të plotësonin tre cilësi: të ishin të përshtatshme (të kishin lidhje me çështjen që auditohet), të besueshme (burimi nga vjen evidenca të ketë besueshmëri) dhe të mjaftueshme (sasia e evidencës të jetë e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve të auditimit). Në përfundim të punës audituse në terren, nga grupi i auditimit janë mbajtur dhe protokolluar në subjekt 7 akt konstatime dhe 2 akt verifikime. Nga subjekti u paraqitën kundërshtitë për aktet e mbajtura. Pas hartimit të akteve të konstatimit dhe projekt raportit, nga subjekti i audituar janë bërë kundërshti, të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit dhe janë bërë pjesë të materialit në projekt raport dhe në raportin përfundimtar të auditimit.

Auditimi në teren ka filluar në datën 21.11.2022 dhe ka përfunduar në datën 23.12.2022. Observacionet e akt konstatimeve janë paraqitur në KLSH në datën 16.01.2023 të cilat janë bërë pjesë e projekt raportit të auditimit.

Projekt raporti i auditimit është nisur në subjekt më shkresën nr.1021/2 prot., datë 02.02.2023 dhe me shkresën nr. 1680 datë 03.03.2023 (të dhëna të subjektit), protokolluar në KLSH me 1021/3 prot, datë 08.03.2023, Bashkia Vau Dejës ka kthyer përgjigje se është njohur me projekt raportin e auditimit në datën 02.02.2023.

Në vijim nga Bashkia Vau Dejës janë paraqitur në KLSH observacione lidhur me projektraportin e auditimit dhe me emailin e datës 13.03.2023 ka shprehur dakordësin për mos paraqitjen në takimin ballafaques në KLSH.

Observacionet e projekt raportit të auditimit janë bërë pjesë integrale e raportit të auditimit.

2.Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Përmbledhje e gjetjes	Referenca me raportin përfundimtar	Rëndësia	Rekomandimi
Gjetje nga auditimi Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura rezulton se Bashkia Vau Dejës për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2021 ka shpenzuar vlerën 639,100 lekë , për 1 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Gjithashtu konstatohet se për likuidimet	31-40	<i>E lartë</i>	Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohen, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të

<p>e subjekteve të mësipërme janë nxjerrë urdhrat përkatës nga titullari i institucionit, por nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.</p>			<p>ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.</p>
<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk ka marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, pasi në datën 31.12.2021 rezulton një vlerë e pa arkëtuar prej 195,912 mijë lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Vau Dejës e krijuar nga mos pagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat, respektivisht; -subjektet fizik/juridik në vlerë 28,844 mijë lekë, si dhe abonentë familjarë në vlerë 167,067mijë lekë. Ndërsa detyrimet e subjekteve dhe familjarëve të vitit ushtrimor 2021 janë në vlerën 149,765 lekë. Veprimet e mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 - Mospagimi i taksave dhe tatimeve.</p>	<p>40-60</p>	<p><i>E lartë</i></p>	<p>Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pavjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pambledhura ndaj evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të pa arkëtuara (debitor), në vlerën 195,912 mijë lekë, nga e cila: subjekte fizik/juridik në vlerë 28,844 mijë lekë, si dhe abonentë familjarë në vlerë 167,067 mijë lekë. Bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat tatimore” me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme: a. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruuese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), sipas</p>

			<p>nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” i ndryshuar.</p> <p>c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.</p> <p>Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana Drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar dhe Drejtorisë Juridike të Bashkisë Vau i Dejës, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, “Mospagimi i taksave dhe tatimeve</p>
<p>Gjetje nga auditimi Nga auditimi rezulton se në Bashkinë Vau Dejës gjatë vitit 2021 kanë ushtruar aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikantë dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë 21 subjekte, sipas aneksit 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se 1 subjekt (Vëllezërit Dodani), i cili vazhdon të ushtrojë aktivitetin i pa pajisur me autorizimin përkatës, për të cilin tarifa për pajisjen e mëparshme me liçencë tregtimi është ndarë në afat 1 vjeçar. Për këtë rast, nga Bashkia Vau i Dejës është aplikuar në mënyrë të gabuar tarifimi, duke e trajtuar këtë subjekt me pagesë të pjeshme, në vlerën 200,000 lekë, pra me 20% të vlerës së kësaj pagese. Janë pajisur me autorizim 10 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte si dhe nuk është ndërmarr asnjë procedura ligjore për pajisjen me autorizim 5 vjeçar sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 11 subjekte, në total vlera e munguar për</p>	40-60	E lartë	<p>Rekomandimi: Drejtoria e shërbimeve publike në bashkëpunim me Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tarifës së pataksuar prej 19,300,000 lekë sipas pasqyrës Aneks nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.</p>

<p>bashkinë Vau Dejës është 19,300,000 lekë sipas tabelës së sipërcituar. Veprime dhe Mosveprime janë në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pikës 1 germës “b”</p>			
<p>Gjetje nga auditimi Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Vau Dejës me palët e treta, u konstatua se nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe Drejtoria e Bujqësisë, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mostarifim të subjekteve për përdorimin e pronave të Bashkisë Vau Dejës, përlllogaritje e gabuar e tarifave, mosaplikim i kamatëvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e qirave, etj), veprime dhe mosveprime të cilat kanë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vau Dejës në vlerën 4,226,414 lekë. Gjithashtu referuar korrespondencës të zhvilluar midis Bashkisë Vau Dejës dhe shoqëria "SPE Gj." shpk ku në përgjigje të shkresës nr. 1695/1 datë 02.04.2019 të dërguar nga bashkia subjekti "SPE Gj." shpk me shkresën nr. 296 prot datë 05.04.2019, protokolluar në bashki me shkresën nr. 1851 prot datë 09.05.2019 i ka vendosur në dispozicion “Hartën me parcelat pyjore dhe gjurmët e rrugëve ndihmëse si dhe tabelën e detajuar me parcelat dhe gjatësinë e rrugëve ndihmëse për ndërtimin e linjës 110 kv të “HIDROCENTRALEVE NË LUMIN GJADËR” për të cilat nuk është lidhur kontratë për dhënien me qira të ngastra nr. 30 Vig tokë bujqësore me sipërfaqe prej 5.832 ha në kundërshtim me VKB nr.44, datë 21.03.2018 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 891/1 datë 16.07.2018. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenet 154, 296 801 e vijues të Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.</p>	40-60	E lartë	<p>Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës të analizojë sitatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa për lidhjen e kontratës me shoqëria “S.P.E. Gj. Sh.p.k për ngastrat nr. 2c, 4b,4c, 41b,56b,96c, Mnelë dhe ngastra nr. 30 Vig tokë bujqësore me sipërfaqe prej 6.22 ha për të cilën Bashkia Vau Dejës nuk ka lidhur kontratë sipas VKB nr.44, datë 21.03.2018.</p>
<p>Gjetje nga auditimi Rezulton se për vitin 2021 Bashkia Vau Dejës nuk ka kryer procesin e inventarizimit çka do të thotë që llogaritë analitike janë mbyllur sipas ditarit kontabël pa rakorduar me gjendjen fizike. Konstatohet se nga nëpunësi zbatues nuk janë marrë masa për hartimin dhe mbajtjen e</p>	60-81	E lartë	<p>Rekomandimi: Sektori i Financës në Bashkinë Vau Dejës, të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave</p>

<p>regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e s' kadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia si dhe nuk janë marrë masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot respektivisht; për llogaritë 32- "Inventar i imet", 202- "Studime dhe kërkime", 210- "Toka, Troje, Terrene", 211 – "Pyje, Plantacione" llog 212- "Ndërtesa e Konstruksione", 213- "Rruge, Rrjete dhe Vepra. Ujore", 214 – "Instalime teknike, makineri e pajisje", 215- "Mjete Transporti".</p> <p><i>Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël", pjesa e parë, "Rregulla të përgjithshme" kapitulli i parë "Mbajtja e kontabilitetit"; UMF nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësisve që varen prej tyre", ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësisve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj"; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 " Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 2, neni 4 ,pika 9 " përgjegjshmëria menaxheriale", Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 " Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014, pika 36, pika 52, pika 73, pika 85</i></p>			<p>për aktivitetet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.</p>
<p>Gjetje nga auditimi: Rezultoi se, për periudhën objekt auditimi janë certifikuar në total 10 prona sipas tabelës së sipërcituar si dhe për vitin 2020 janë certifikuar 35 prona objekte inventari në ndërtesa e konstruksione të administruara llog.(212) pasuri e paluajtshme (sasi e vlerë) pjesa e konsiderueshme e tyre prej 4860 prona (trajtuar analitikisht) nuk janë të regjistruara në kontabilitet dhe pasqyrat financiare në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, pasi 153 objekte janë të trashëguara nga (ish/komunat) Konstatohet se sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga sektori i aseteve, u konstatua se një pjesë e pronave janë regjistruar nga Bashkia Vau Dejës në Drejtorinë rajoneve të ASHK Vau Dejës, por pa vlerë. Kështu gjithsej janë regjistruar 45 prona por pa vlerë, gjë e cila vështirëson procesin e kontabilizimit në pasqyrat financiare si asetet të Bashkisë Vau Dejës. Për rrjedhojë</p>	60-81	E lartë	<p>Rekomandimi Sektori i Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin 45 prona të certifikuara në ASHK Shkodër, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Vau Dejës sipas aneksit nr. 4 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.</p>

<p>kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur. Në mënyrë të detajuar pronat e certifikuar nga Bashkia Vau Dejës pasqyrohen në Aneksin nr 4 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit. <i>Veprime dhe mosveprime e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16).</i></p>			
<p>Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare dërguar në degën e thesarit Shkodër me shkresën nr. 1641 prot., datë 30.03.2022 si dhe akt rkordimet me degën e thesarit konstatohet se vlera e paraqitur në llogaritë e poshtëpërmendura është e njëjtë me vlerën e rakorduar me degën e thesarit. Nga analiza e llogarive konstatohet se:- Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” në datën 31.12.2020, paraqitet në vlerën 6,208,378 lekë, në 31.12.2021 paraqitet po në vlerën 6,208,378 lekë e pa ndryshuar. -Llogaria 211 “<i>Pyje kullota plantacione</i>” më 31.12.2020 paraqitet për vlerën kontabël historike 113,039,105 lekë dhe më 31.12.2021 paraqitet po në vlerën 113,039,105 lekë e pa ndryshuar. -Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione” më 31.12.2021, paraqitet në vlerën 1,787,556,508, lekë. -Llogaria 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore” më 31.12.2020, paraqitet në vlerën 2,082,261,462 lekë, më 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie rezulton 2,123,426,367 lekë, e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat gjatë periudhës raportuese. -Llogaria . 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje”, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Vau Dejës dhe ish Komunat, në fund të vitit 2020 rezulton për vlerën 46,937,264 lekë dhe në fund të vitit 2021 për vlerën 52,920,775 lekë.- Llogaria. 215 “Mjete transporti”, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Vau Dejës dhe ish Komunat, në fund të vitit 2020 rezulton për vlerën 35,829,016 lekë dhe në fund të vitit 2021 për vlerën 42,732,433 lekë.-Llogaria 218 “Inventar ekonomik” e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Vau Dejës dhe ish Komunat, në fund të vitit 2020 rezulton për vlerën 105,773,478 lekë dhe në fund të vitit 2021 për vlerën 105,773,478 lekë e pa ndryshuar Vlera e këtyre zërave në pasqyrën e pozicionit financiar 2021, është marrë bruto nga pasqyrat financiare. Nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitet, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e</p>	60-81	E lartë	<p>Rekomandim:Sektori Ekonomike në Bashkinë Vau Dejës të marrë masa për kryerjen e inventarizimit të AAGJM, të krijojë dhe të mbajë regjistrin analitik aktiveve, ku të përmbajë të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vendodhjen, përshkrimin e aktivitet, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitet, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.</p> <p>Rekomandim: Të kryejë veprimet për përlllogaritjen e saktë të amortizimit aktiv për aktiv sipas të dhënave regjistrit të aktiveve, duke aplikuar normat e amortizimit të miratuara me qëllim saktësimin e vlerës së mbetur të AAGJ dhe reflektimi i të gjithë ndryshimeve në kontabilitet nëpërmjet sistemeve kontabël, duke pasqyruar saktë dhe realisht gjendjet e AAGJ në llogaritë përkatëse të klasës 20 dhe 21 në pasqyrat financiare.</p>

<p>shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.</p> <p>Duke qenë se nuk ka një regjistër kontabël, nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur behet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet.</p> <p>Sektori i financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar, të vitit 2021, Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata materiale" dhe pika 33.</p>			
<p>Gjetje nga auditimi: Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konstatohet se nga Bashkia Vau Dejës, nuk ka njohje dhe nuk është zbatuar ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Nuk është ngritur një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, gjë e cila është reflektuar në mangësinë e plotë të rregullave të shkruara për funksionimin e institucionit. -Nga ana e titullarit nuk është hartuar një strategji e menaxhimit të riskut për vitin 2021, manuali dhe harta e proceseve të punës, gjurma e auditimit e cila duhet të përfshinte të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë. -Nga ana e nëpunësit autorizues, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollat që synojnë minimizimin e riskut dhe dokumentimin e tij, si dhe nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e këtyre fenomeneve. -Gjithashtu, u konstatua se një numër i konsiderueshëm punonjësish, kanë rregulluar marrëdhënien e punës sipas dispozitave të Kodit të Punës, ndërkohë që pozicionet e tyre të punës, evidentohen si pozicione me status “Nëpunës Civil” dhe për rrjedhojë rekrutimi i tyre është bërë në kundërshtim me ligjin. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 20, 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. 	21-31	<i>E lartë</i>	<p>Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme për:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përkrahimit të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësisë dhe të drejtave të punonjësve të njësisë. -Grupi i Menaxhimit Strategjik, të hartoj strategjinë e riskut, regjistri i riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës. -Rregullimin e pozicioneve të punës për punonjësit të cilët sipas ligjit, duhet të trajtohen si “Nëpunës Civil”, bazuar në ligjin “Për statusin e nëpunësit Civil”, por që janë trajtuar si punonjës me “Kodin e Punës”.

			<p>si dhe të njoftojë DAP për procedurat e konkurrimit, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në ligjin për Nëpunësin Civil.</p> <p>- Sektori i Burimeve Njerëzore të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.</p>
--	--	--	--

3. Konkluzioni dhe opinioni i auditimit

I. Opinioni i pasqyrave financiare viti 2021

Objektivi i Audituesve në auditimin financiar është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nëse këto pasqyra janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar. Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduar të Bashkisë Vau Dejës për vitin e fundit ushtrimor 2021, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., si dhe shënimet dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit arrijmë në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë përmbledhëse vjetore të konsoliduar të vitin 2021, të cilat justifikojnë dhënien e **opinionit të modifikuar/kualifikuar**.

Baza për dhënien e opinionit të auditimit

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit mbi shpenzimet prej 8,970 mijë lekë, si dhe anomalitë e konstatuara të përshkruara në vijim. Gjithashtu ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e **opinionit të modifikuar/kualifikuar** të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë:

- Llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” është nënvlerësuar në vlerën **196,638,412** lekë, pasi nuk janë përfshirë detyrimet që të tretët kanë ndaj Bashkisë.

- Llogaria 4342 “*Të tjera operacione me shtetin*”, është nënvlerësuar për vlerën 59,985,267 lekë në mbyllje të vitit ushtrimor 2021;

- Llogaria 26 “*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*” është pasqyruar më pak për vlerën 350,812,349 lekë në mbyllje të vitit ushtrimor 2021;

- Llogaria 202 “*Studime dhe kërkime*” është mbivlerësuar në vlerën 61,220,902 lekë në mbyllje të vitit ushtrimor 2021;

-Sektori i financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar, të vitit 2021 si vijon:

Llogaria 210 “*Toka, Troje, Terrene*” në datën 31.12.2020, paraqitet në vlerën 6,208,378 lekë, në 31.12.2021 paraqitet po në vlerën 6,208,378 lekë e pa ndryshuar.

-Llogaria 211 “*Pyje kullota plantacione*” më 31.12.2020 paraqitet për vlerën kontabël historike 113,039,105 lekë dhe më 31.12.2021 paraqitet po në vlerën 113,039,105 lekë e pa ndryshuar.

-Llogaria 212 “*Ndërtime e konstruksione*” më 31.12.2021, paraqitet në vlerën 1,787,556,508, lekë;

-Llogaria 213 “*Rrugë, rrjete vepra ujore*” më 31.12.2020, paraqitet në vlerën 2,082,261,462 lekë, më 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie rezulton 2,123,426,367 lekë, e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat gjatë periudhës raportuese.

-Llogaria . 214 “*Instalime teknike, makineri e pajisje*”, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Vau Dejës dhe ish Komunat, në fund të vitit 2020 rezulton për vlerën 46,937,264 lekë dhe në fund të vitit 2021 për vlerën 52,920,775 lekë.

-Llogaria. 215 “*Mjete transporti*”, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Vau Dejës dhe ish Komunat, në fund të vitit 2020 rezulton për vlerën 35,829,016 lekë dhe në fund të vitit 2021 për vlerën 42,732,433 lekë.

-Llogaria 218 “*Inventar ekonomik*” e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Vau Dejës dhe ish Komunat, në fund të vitit 2020 rezulton për vlerën 105,773,478 lekë dhe në fund të vitit 2021 për vlerën 105,773,478 lekë e pa ndryshuar.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Vau Dejës:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Vau Dejës, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullativ në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Vau Dejës janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme¹, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomalitë materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me

¹ ISA 200-ISSAI 1200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomalitë materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve të tij/saj.

standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. Hyrja (Të dhëna mbi Projektin e Auditimit)

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 1021/1 prot., datë 15.11.2022 të miratuara nga Kryetari i KLSH, nga data 21.11.2022 deri më datë 23.12.2022, në subjektin Bashkia Vau Dejës, për periudhën e veprimtarisë së subjektit, nga data 01.01.2021 deri në 31.12.2021, u krye auditimi “Mbi auditimin financiar”, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. H. I., Përgjegjës Grupi.
2. A.T., Auditues.
3. E. V., Auditues.
4. G.P., Auditues.

a- **Titulli:** Auditim financiar në Bashkinë Vau Dejës.

b- **Marrësi:** Raporti i Auditimit i drejtohet subjekti të audituar Bashkia Vau Dejës

1.Objektivat dhe Qëllimi i Auditimit

-Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2021, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

-Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

2.Identifikimi i çështjes

Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjëse të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Vau Dejës, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

3.Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Kryetari i Bashkisë, z. M. B., në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. A. N., Përgjegjës në Sektorin e Financës, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe

për mirëfungsionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, etj.

4.Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t. Këto standarde, kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë së kërkuar.

Përgjegjësia jonë (e audituesve të KLSH-së), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

-Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

-Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;

-Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo legjislacioni financiar, tatimor dhe vendor në fuqi, etj.;

-Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, ankesat, etj.).

-Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, si dhe rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit njerëzor.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Vau Dejës, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

5.Kriteret e vlerësimit

▪ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

▪ Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

▪ **Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:**

-Ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

-Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”

-Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” ndryshuar me ligjin nr. 24/2015, datë 19.03.2015;

-VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”;

-Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 35, datë 5.11.2008 “Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”;

-Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;

-UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, etj;

- Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;
- Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.
- Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”;
- Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;
- Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, dhe pikat 116-117- *Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore*’.
- Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë Financave, Drejtorit të Përgjithshëm të Radiotelevizionit Shqiptar nr. 29, datë 18.12.2014 (Agjenti tatimor OSSHE faqe 4, “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive”), Fletore zyrtare 196/2014;
- **Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:**
- Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006”, aktualisht i shfuqizuar;
- VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i MF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe të njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatore të huaj”;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;
- Udhëzimi përbashkët i Ministrisë të Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.
- **Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:**
- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”;
- Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar
- VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- **Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:**

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 152-2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Niveleve të Pagave të Nëpunësve Civilë”, i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”;
- Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLS-së”;
- Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë.
- Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut;
- Legjislacioni bazë dhe detyësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

6.Standardet e auditimit

- ISSAI 100 “Parimet themelore të Auditimit të Sektorit Publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;
- ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të Auditimit të Përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i Udhëzimeve për Auditimin e Përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200 “Udhëzime për Auditimin e Përputhshmërisë”;
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm, etj.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

7.Metodat e auditimit

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe

-Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.

Ndjekja dhe zbatimi i hapave të mësipërm do të sjellin natyrshëm përcaktimin e elementëve kryesorë që do të ndiqen gjatë procesit të zbatimit të projektit të auditimit, nëpërmjet sigurimit të gjurmës së projektit të auditimit. Gjurma e auditimit është dokumentimi i procesit të realizimit të Projektit të Auditimit. Evidentimi i zbatimit të procedurave të auditimit nëpërmjet dokumentimit përfshin të gjitha fazat e kryerjes së Projektit të Auditimit që nga Planifikimi i Auditimit, Puna në Terren, Raportimi i Auditimit, Ndjekja e Rekomandimeve dhe Publikimi i Auditimit. Theksojmë se nga ana jonë do të auditohen pothuajse të gjitha fondet, si më poshtë:

▪ **Kontrolli aritmetik**

Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

▪ **Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese**

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) u konstatua se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

▪ **Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese**

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

▪ **Kontrolli i vlerësimeve**

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

▪ **Konfirmimi nga të tretët**

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

▪ **Kontrolli sipas një treguesi**

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, të cilat përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

▪ **Intervista**

▪ **Raporte dhe Informacione**

▪ **Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK**

8.Praktikat e ndjekura

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e

anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për llogaritjen e tij janë marrë shpenzimet për pagat (600), shpenzimet operative (602) dhe investimet (231).

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit, konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke iu nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që aplikon KLSH-ja².

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst, procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në analizat e marrëdhënieve ndërmjet informacionit financiar dhe jo financiar; inspektimeve që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë ose në trajtë elektronike por edhe në inspektime fizike; në observime, të cilat kanë të bëjnë me analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur ka ndodhur observimi; dhe së fundmi, kërkimi/hetimi që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetentë dhe të mirëinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9.Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi Akt-Konstatimet e mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Raport Auditimi.

Në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u morrën në konsideratë parimet e mëposhtme të auditimit financiar:

- Etika dhe pavarësia;
- Kontrolli i cilësisë;
- Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre
- Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

² Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Gjithashtu, në kryerjen dhe dokumentimin e auditimit, u kushtua një rëndësi e veçantë në lidhje me:

▪ **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim**

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Saktësia: Shumat dhe të dhënat e tjera në lidhje me transaksionet dhe ngjarjet e regjistruara janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

▪ **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet dhe detyrimet.

Plotësia: Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivet, pasivet dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

▪ **Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese**

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e paraqitura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.


Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe shprehet qartë në shënimet shpjeguese.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1. Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik Bashkia Vau Dejës:

Bashkia Vau i Dejës, ka një popullsi prej 30,438 banorësh, ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 48,966 banorë. Bashkia e re ka në një sipërfaqe prej 499.09 km² me një densitet prej 98.11 banorë/km². Kjo bashki përbëhet nga 6 njësi administrative, të cilat janë: Vau Dejës, Bushat, Vig-Mnele, Hajmel, Temal, Shllak. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Shkodrës dhe pjesë e po këtij qarku. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 47 fshatra.



Profili i Bashkisë

Veprimtaria e Bashkisë Vau Dejës bazohet në një bazë të gjerë ligjore, por ligji bazë për të është ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Parimet themelore të vetë qeverisjes vendore janë: të veprojnë në bazë të parimit të autonomisë vendore dhe të respektojnë kushtetutën.

Auditimi i këtij subjekti është auditim i radhës, sipas planit vjetorë të miratuar në fillim të vitit 2021, nga Kryetari i Kontrollit të lartë të Shtetit.

Bashkia e re e Vau Dejësit ka si aktivitet kryesor ekonomik bujqësinë dhe blegtorinë, si dhe tregtinë ndërkufitare me Greqinë. Maqedoninë etj.

Bujqësia është e përqendruar të agrumet, dhe vreshtat ndërsa zona është e famshme edhe për kullota dimërore për bagëtinë e imët.

Infrastruktura e zonës është sistemuar me ndërtimin e rrugëve lidhëse ndërmjet Njësive Administrative dhe autostradës me qëllim krijimin e lehtësirave për bizneset vendase që merren me tregtimin e fruta perimeve si dhe blegtorinë.

Sfidat me të cilat do të përballlet pushteti vendor pas ndarjes së re

Zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë duke u bazuar te praktikat e suksesshme të kooperativës është një sfidë që duhet të marrë parasysh nevojën për të krijuar kushte të mira jetese për popullsinë duke shmangur në këtë mënyrë emigrimin e mëtejshëm.

Krijimi i mundësive për zhvillimin e Agro turizmit në pajtim me natyrën, investime publike si dhe planifikim të mirë dhe transparent të zhvillimit.

IV. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT, SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT

1. Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Në drejtim të vlerësimit të implementimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Bashkinë Vau Dejës, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për të gjithë komponentët si: “Mjedisi i kontrollit”, “Menaxhimi i riskut”, “Aktivitetet e kontrollit”, “Informimi dhe Komunikimi” si dhe “Monitorimi”, në referim të nenit 19 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime”, ku titullari i njësisë në sektorin publik krijojnë dhe vlerësojnë sistemet e MFK-së nëpërmjet këtyre komponentëve të lidhur me njëri-tjetrin. Thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, procedurave të tenderimit dhe kontraktimit si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë.

Titulli i gjetjes: Në Bashkinë Vau Dejës ngritja dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, nuk është në nivelin e kërkuar sipas dispozitave ligjore.

Situata: Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Titullarët e njësisë të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.

1-Mjedisi i kontrollit.

Bashkia e Vau i Dejës me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Z. Mark Babani me shkresën **Nr.11/1 Prot., datë 13.01.2021, ka miratuar rregulloren** për nivelin menaxhues dhe për punonjësit e tjerë të njësisë.

Për vitin 2021 numri i punonjësve është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë Nr.71, Datë 23.12.2020 “Për miratimin e strukturës së administratës së bashkisë dhe të njësisë shpenzuese në varësi të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2021.

Konstatohet se struktura organizative ka pësuar ndryshime nga viti në vit, ndryshime të cilat janë miratuar me vendimet respektive të sipërcituara në të cilat janë krijuar shumë drejtori, sektorë dhe agjenci ku është punësuar një numër i lartë punonjësish në këto sektorë, por të panevojshëm pasi në asnjërën prej tyre nuk janë përcaktuar detyrat konkrete ligjore që do kryej dhe përcaktuar punën e secilës strukturë në veçanti.

Referuar shkresës **Nr.6703 Prot., Dt.25.11.2022** nga Bashkia Vau Dejës mbi lëndën kthim përgjigje Kontrollit të Lartë të Shtetit rezulton se numri i personelit në Bashkinë Vau Dejës referuar strukturave organizative, për vitin 2021 ka rritje të numrit të pozicioneve të punës krahasuar me vitin 2020. Numri i miratuar me VKB Nr.79 Dt.24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2021”. Numri total i miratuar i pozicioneve është 393 dhe situata me personelin për vitin 2021 sipas planit e faktit në Bashkinë Vau Dejës paraqitet në tabelën e mëposhtme:

STRUKTURA		2021	
		PLAN	FAKT
1.	ADMINISTRATA	149	132
2.	KONVIKTI I SHKOLLËS “NDRE MJEDA”	16	15
3.	QENDRA SOCIALE “BESA”	18	17
4.	PUNONJËS SHËRBIMI	48	32

5.	PUNËTOR GJELBËRIMI	12	11
6.	UJITJE DHE KULLIMI	12	12
7.	SANITARE SHKOLLE	30	30
8.	VROJTUES PYJESH	12	12
9.	PUNËTOR MIRËEMBAJTJE RRUGËSH	11	10
10.	PUNONJËS ARSIMI I MESËM	6	6
11.	QENDRA KULTURORE E FËMIJËVE	9	9
12.	EDUKATORE	42	41
13.	MZSH	20	16
14.	GJENDJA CIVILE	6	6
15.	QKB	2	1
VENDE VAKANTE PËR POZICION		(%)	
TOTALI		393	350
Numri i të punësuarve			


Sa me sipër rezulton se këto drejtori, sektorë dhe agjenci nga ana e tyre nuk kanë hartuar rregullore të veçantë të funksionimit të tyre çka bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 20, të ligjit Nr.10296, Datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, pasi rregullorja aktuale që qarkullon në bashki nuk i ka të përcaktuara detyrat për funksionet e reja që i janë deleguar nga qeverisja qendrore, njësite administrative të krijuar në zbatim të reformës territoriale, pavarësisht se në rregulloren aktuale që përdoret ka përsëritur të detyrave për disa nga drejtorit kryesore si Financën, Taksat, Burimet Njerëzore, Planifikim e Zhvillim Territorin, Shërbimet Publike, etj.

➤ Politikat menaxheriale dhe stili i Punës

Punësimi në Bashkinë e Vau Dejës bëhet në zbatim të Ligjit Nr.139/2015“Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Ligjit Nr.7961 /1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM Nr.243/2015 i ndryshuar me VKM Nr.746/2018 Kreu I pika 1,2. Kjo procedurë rregullohet nga vet Strukturat e Bashkisë së Vau Dejës:- Drejtoria e Burimeve Njerëzore [DBNJ] është përgjegjëse për zbatimin e hapave të procedurës së punësimit sipas nenit 10 pika 1 e Ligjit Nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM Nr.243/2015 i ndryshuar Kreu II;

- Komiteti i Përhershëm i Pranimit [KPP] në zbatim të përcaktimeve në Kreun III të VKM Nr.243/2015 i ndryshuar ;

- Kryetari i Bashkisë në zbatim të nenit 64 pikat “e,ë,f,g” të Ligjit Nr.139/2015“Per Vetëqeverisjen Vendore”.



Skema e procedurës së punësimit

Strukturat përgjegjëse të Bashkisë së Vau i Dejës hartojnë në fillim të çdo viti planin vjetor të pranimit në shërbimin civil konform Ligjit Nr.152/2015 “Për nëpunësin civil” neni 18, VKM Nr.108/2014 “Për plani vjetor të pranimit në shërbimin civil”, VKB “Mbi miratimin e numrit

maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave të tyre” si dhe Vendimeve të Kryetarit “Për miratimin e strukturave organizative të Bashkisë Vau Dejës” për çdo vit ushtrimor.

Planet vjetore janë miratuar me vendimet e sipërcituara dhe janë hartuar mbi nevojat e institucionit për vitin e ri ushtrimor, duke detajuar emërtimin e pozicionit dhe të njësisë përbërëse në strukturë. Publikimi i vendeve vakante nga ana e Bashkisë Vau Dejës bëhet në faqen zyrtare të saj, konform VKM Nr.243/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar Kreu II pika 6.

Përshkrimin e punës të çdo pozicioni si dhe kriteret që duhet të plotësohen nga kandidatët duhet të jenë të përshkruara në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë. DBNJ nga ana e saj pasi njihet me planin vjetor, ndjek procedurën nga shpallja e njoftimit deri në përfundimin e saj, duke zbatuar përcaktimet ligjore në fuqi, Ligjin Nr.152/2015 “Për nëpunësin civil”, VKM Nr.108/2014“Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, VKM Nr.243/2015“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” i ndryshuar.

-Referuar **Nr.11/1 Prot., datë 13.01.2021**, struktura e Bashkisë Vau Dejës është miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë **Nr.71, Datë 23.12.2020** “Për miratimin e strukturës së administratës së bashkisë dhe të njësisë shpenzuese në varësi të Bashkisë Vau Dejës për vitin 2021 “

Nga 113 vende pune me statusin e nëpunësit civil, nga të cilat:

- **0 (zero)** pozicione i kategorisë së lartë;
- **7 (shtatë)** pozicione të kategorisë së mesme drejtues;
- **24 (njëzet e katër)** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese;
- **78 (shtatëdhjetë e tetë)** pozicione të kategorive ekzekutive;

Nga këto pozicione janë të lira (të paplotësuara):

- **0 (zero)** pozicion i kategorisë së lartë;
- **3 (tre)** pozicione të kategorisë së mesme drejtues;
- **1 (një)** pozicione të kategorisë së ulët drejtuese;
- **7 (shtatë)** pozicione të kategorive ekzekutive;

Vërehet se disa pozicione pune të vlerësuara me status nëpunësi civil janë plotësuar me akte të përkohshme emërimi, për shkak se pavarësisht shpalljeve të vendeve të lira të punës, nuk ka patur aplikues ose mospermbushejs se kriterëve për emërimin sipas ligjit për shërbimin civil.

Nga vende pune të lira të paplotësuara me statusin e nëpunësit civil, si vijon;

- Nga auditimi rezulton se vendet vakante në Bashkinë e Vau Dejës janë krijuar jo vetëm si rezultat i ristrukturimeve, por edhe si rezultat i funksionimit të kontrolleve të brendshme. Një pasqyrim më i detajuar i numrit dhe arsyes së krijimit të vendeve vakante, si vijon;

Nr	Arsyeja e lirim të vendeve	2021
1	KMCAP	0
2	Pension	4
3	Largim me Deshire	12
4	Shkurtime	0
5	Kontrate	28
6	Largim per mosparaqitje ne pune	0
7	Nderruar jete	0
8	Mase disiplinore	0

9	Ngritje ne detyre	
10	Lirim pa motivacion (per funksionet me karakter politik)	0
TOTALI		

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Burimeve Njerëzore

Konstatohet se numri i personelit në Bashkinë e Vau Dejës referuar strukturave organizative, ka ardhur në rritje, por i paplotësuar sipas planit ndonëse edhe numri faktik i tyre ka ardhur në rritje. Në rregulloren e Bashkisë së Vau Dejës përshkrimet e punës së çdo pozicioni në strukturën organizative, nuk shoqërohen me përcaktimin e kriterëve të përgjithshme dhe atyre specifike të nevojshme/të domosdoshme, sipas përcaktimeve të ligjit nr.152/2013“Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Pavarësisht paralajmërimeve të bëra nga KMSHC ne raportin e tij përfundimtare për ndalimin e emërimeve te paligjshme ne shërbimin civil gjatë periudhës Tetor 2021 Shtator 2022, janë bërë përsëri emërimet pa procedura konkurrimi dhe në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil, duke filluar nga niveli ekzekutiv deri të niveli i lartë drejtues.

Struktura organike (organi grama) e miratuar nga organi epror Kryetar i Bashkisë është sipas pasqyrës si më poshtë:

EMERTIMI	Nr. Punonjësve
Kryetari	1
Zv/Kryetar	2
Sekretariati i Këshillit	3
Kabineti i Kryetarit	4
Zyra e marrëdhënieve me publikun dhe median	4
Administratorët	5
Auditi i Brendshëm	3
Drejtoria Ekonomike	16
Drejtoria e Mbrojtjes, Kujdesit dhe Përfshirjes Sociale	17
Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve Publike	13
Drejtoria Juridike, Prokurimeve dhe Integritit	13
Drejtoria e Shërbimeve Publike, Arsimit, Rinisë dhe Shëndetësisë	15
Drejtoria e Zhvillimit Rural, Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit	21
Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	15
IVMT	4
Policia Bashkiake	10
Spektori i Emergjencave Civile	3
Konvikti i Shkollës së Mesme Profesionale “Ndre Mjeda” Bushat	16
Qendra Sociale Multifunkionale Rezidenciale “Besa” Barbullush	18
Qendra Kulturore e Fëmijeve	9
Edukatore	42
MZSH	20
QKB	2
Gjendja civile	6
Punonjës Administrativ Mbështetës	131
TOTALI	393

Shënim: Pasqyra e mësipërme mund të ndryshojë sipas pozicioneve që Bashkia Vau Dejës ka.

Konstatim se në strukturën e Bashkisë së Vau Dejës nuk janë planifikuar pozicione me status “ekselent” në mos zbatim të Urdhrit të Kryeministrit **Nr.164 Datë 05.10.2017**; si dhe pozicione me status të “Grup i veçantë” ku përfshihen 17 (shtatëmbëdhjetë) nënkategori të ndryshme si: persona me aftësi të kufizuar, jetimë, komuniteteve të ndryshme (romë, egjiptianë etj) si personel administrativ, në kundërshtim kjo me Ligjin Nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar neni

5; Ligjin Nr.93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara” neni 1/a; neni 2 pika a/b; neni 4 pika a/ b/ ë; Ligjin Nr.15/2019 Dt.13.03.2019 “Për Nxitjen e Punësimit” neni 3 pika 4 “Grupe të veçanta” (17 kategori sociale); neni 20 pika 1/a e 1/b; pika 2; pika 3.

➤ **Mbi trajnimin e punonjësve në Bashkinë e Vau Dejës**

Stafi administrativ ka zhvilluar trajnime sipas programeve (të detyrueshëm dhe fakultativ) ofruar nga ASPA nëpërmjet Platformës ZOOM, për njohuritë e tyre në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, për Procedurat e Prokurimit Publik, Auditi i Brendshëm etj. Por nga Bashkia e Vau Dejës nuk rezulton të jenë hartuar Plane vjetore trajnimesh për punonjësit e saj, por përzgjedhja e personelit për trajnim është realizuar nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore ose nga vet punonjësit. Trajnimi i punonjësve është i nevojshëm për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe për të kuptuar se direktivat e dhëna prej menaxherëve të njësisë kuptohen dhe arrihen nga punonjësit.

Përgjegjësia e menaxhimit në garantimin e profesionalizmit të punonjësve të tij fillon me miratimin e politikave dhe praktikave të duhura që lidhen me burimet njerëzore dhe që reflektojnë angazhimin për: • Caktimin e nivelit të njohurive dhe aftësive që kërkohen për çdo pozicion pune; • Verifikimin e kualifikimeve të kandidatëve për vendet e punës; • Marrjen në punë dhe ngritjen në detyrë vetëm të atyre personave që kanë njohuritë dhe aftësitë në nivelet më të larta; • Futjen e programeve të trajnimit që ndihmojnë punonjësit të zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre. • Kryerjen e analizave periodike për njohuritë dhe aftësitë e kërkuara për çdo pozicion pune dhe mbështetur në këto analiza, hartimin e planeve periodike për trajnimin e punonjësve; • Zhvillimin e profesionalizmit menaxherial nëpërmjet trajnimeve dhe marrjes në konsideratë të aftësive menaxhuese gjatë procesit.

Konstatohet se Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkinë e Vau Dejës nuk ka hartuar plane / programe vjetore për trajnimin e detyrueshëm të punonjësve, të cilat ndihmojnë në zgjerimin e njohurive të tyre për proceset e punës dhe të aftësive për t'i kryer me efikasitet ato, në kundërshtim me Ligjin Nr.10296 Datë 8.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

2- Menaxhimi i riskut

(Në zbatim të kërkesave të nenin 21 të ligjit Nr.10296, datë 8.07.2010).

Nga Bashkia e Vau Dejës nuk janë hartuar dhe miratuar Regjistrat e Riskut, ku te identifikohen risqet që vijnë nga burime të brendshme dhe risqe që vijnë nga burime të jashtme:

Pra nuk kemi një Regjistër ku te jete paraqitur përshkrimi i risqeve për çdo drejtori, niveli i risqeve, kontrollet ekzistuese, veprimet e ndërmarra për të adresuar risqet, zotëruesi i riskut si dhe situatën e riskut pas detyrës së fundit.

Konstatojme se nuk kemi krijim të grupeve të menaxhimit strategjik GMS si dhe ekupe të menaxhimit të programeve EMP.

Pranohet fakti se bashkimi i të gjitha njësive shpenzuese, jo në të gjitha drejtimet ka qenë i mirë përgatitur i cili nuk ka mirë funksionuar, për faktin se nuk është përgatitur në kohe infrastruktura e nevojshme, duke u bërë me tepër bashkim mekanik, duke mos dhënë efektet e duhura në plotësimin e objektivave në shërbim të komunitetit dhe mos krijuar kushtet për një administratë të njësive administrative të manovrueshme dhe eficiente në shërbim të komunitet

Për rrjedhojë miratimi i gjurmës së auditimit sipas përcaktimeve në nenin 16, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, nuk është në nivelin e duhur.

Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit në pa pajtueshmëri me kërkesat e UMF Nr.2, Datë 6.02.2012 “Për procedurat standart të zbatimit të buxhetit” pika 40 dhe ligjit Nr. 10296, Datë 8.07.2010, neni 4 pika 19 “Gjurma e auditimit” përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve” dhe neni 16 pika 2.

-Konstatohet se urdhër shpenzimet nënshkruhen nga nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatuar si dhe nuk është deleguar e drejta e nënshkrimit të urdhër shpenzimeve për kryerje e transaksioneve, në referencë të nenit 21, pika 1,2 dhe 3, të ligjit Nr. 10296, Datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Nga Kryetari i Bashkisë, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues është punuar për të përmbushur qëllimet Bashkisë, siç janë parashtruar në raportin për menaxhimin financiar dhe Kontrollin, në pyetësonin e plotësuar “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, “Deklaratën e funksionimit të kontrollit brendshëm financiar publike”.

Bashkëpunimin e auditimit e Brendshëm, në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 10296, Datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, nëpërmjet veprimtarive efektive, eficientë dhe me ekonomi, pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat, informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

3-Veprimtaritë e kontrollit

(Në zbatim të kërkesave të nenin 22 të ligjit Nr. 10296, Datë 8.07.2010).

Nga dokumentacioni që u kërkua personave përgjegjës pranë Bashkisë Vau Dejës në lidhje me grupet e menaxhimit strategjik GMS për takimet e detyrueshme vjetore të GMS, që referuar Ligjit Nr.10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe “Manualit të Menaxhimit financiar dhe kontrollin” ku citon se “Grupi për Menaxhimin Strategjik duhet të mbledhet të paktën katër herë në vit. Vendimet e Grupit duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik dhe në përputhje me standardet etike të sektorit publik. Vendimet e Grupit duhet të pasqyrohen në dokumente dhe t’i vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë”.

Konstatohet se Bashkia Vau Dejës nuk ka miratuar një plan pune vjetor të GMS lidhur me aktivitetet dhe çështjet që do të analizohen, si dhe grafikun e takimeve që do të zhvillohen nga ana e këtij grupi si dhe referuar procesverbaleve vendimeve të takimeve nuk ka të dokumentuar takimet e GMS nuk ka asnjë dokument ku të vërtetoje mbi takimet e GMS për vitin 2021 në kundërshtim të Ligjit Nr.10296/2010 “Për Menaxhimin financiar dhe Kontrollin” dhe “Manualit të menaxhimit financiar dhe Kontrollin”.

Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre.

Duhet theksuar se në procesin e miratimit të planeve vjetore të punës, duhet të merren parasysh risqet më të rëndësishme që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara. Gjithashtu e rëndësishme është që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike.

Nga auditimi rezulton se në lidhje me identifikimi i riskut, vlerësimi i riskut, adresimi i riskut dhe shqyrtimi i riskut: Nuk është hartuar asnjë strategji për menaxhimin e riskut, në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ku citohet se; “Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut”

4- Informacioni dhe komunikimi

(Në zbatim të kërkesave të nenin 23 të ligjit Nr. 10296, Datë 8.07.2010).

Informimin dhe komunikimi, realizohet sipas shkallës së strukturave, bazuar edhe në rregulloren e funksionimit të brendshëm. Përveç kësaj mënyre, informimi realizohet edhe nëpërmjet publikimeve dhe njoftimeve të adresuara për publikun veçanërisht lidhur me vjeljen e detyrimeve për tatim taksat lokale, në zbatim të kërkesave të ligjit Nr.9920, Datë 19.04.2008“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

5-Monitorimi

(Në zbatim të kërkesave të nenin 24 të ligjit Nr. 10296, Datë 8.07.2010).

Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në përgjithësi, realizohet nëpërmjet organizimit të grupeve të punës ose komisionet përkatëse si për marrjen në dorëzim të punimeve të kontraktuara, në rastet e identifikimit të detyrimeve për tatim taksat lokale etj.

Një formë e monitorimit, është deklarata e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm si vijon:

Me shkresën **Nr.993 Prot.,Dt.28.02.2022** është dërguar dokumentacioni për funksionimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2021 nga Bashkia Vau Dejës, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Harmonizimit të Menaxhimit Financiar, Kontrollit dhe Kontabilitetit.

Me shkresë **Nr.2173/1Prot.,Dt.11.04.2022** nga Bashkia Vau Dejës është dërguar informacioni, Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm Tiranë mbi raportin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve për vitin 2021, si dhe pasqyrat nr.1 dhe nr.2.

Me shkresë **Nr.727 Prot.,Dt.15.02.2022** është dërguar nga Bashkia Vau Dejës raporti vjetor i veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2021, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, ku vërehet se gjate vitit 2021 sektori i auditimit ka vazhduar të ketë probleme me plotësimin e strukturës organizative për arsye të mos përmbushjes së kriterëve të vendit të punës.

Kriteri:

Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 20, 21.

Shkaku:

Neglizhencë e drejtorive/sectorëve për hartimin e regjistrit të riskut, hartimin e strategjisë së riskut si dhe miratimin e gjurmëve të auditimit.

Ndikimi/Efekti:

Mungon ndarja e qartë e detyrave sipas drejtorive/sectorëve, mos identifikim i shkallës së riskut, mos trajnim efektiv për rritjet profesionale të stafit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Vau Dejës, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, duhet të marrë masa të menjëhershme për:

- Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshkrimit të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësive dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.
- Grupi i Menaxhimit Strategjik, të hartoj strategjia e riskut, regjistri i riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.
- Rregullimin e pozicioneve të punës për punonjësit të cilët sipas ligjit, duhet të trajtohen si “Nëpunës Civilë”, bazuar në ligjin “Për statusin e nëpunësit Civil”, por që janë trajtuar si punonjës me “Kodin e Punës”, si dhe të njoftojë DAP për procedurat e konkurrimit, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në ligjin për Nëpunësin Civil.
- Sektori i Burimeve Njerëzore të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

1.3 Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditit të brendshëm publik;

Titulli i gjetjes: *KLSH ka konstatuar se sektori i Auditit të Brendshëm në punën e tyre pavarësisht dhënies se rekomandimeve nuk janë treguar këmgulës në auditimin e zbatimit të rekomandimeve, nuk ka audituar sektorët me risk të lartë si dhe nuk ka respektuar trajnimet e detyrueshme vjetore planifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në kundërshtim me Ligjin nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, “Manualin e Auditimit të Brendshëm të Sektorit Publik”.*

Situata: Nga auditimi i zbatimit të veprimtarisë së Njësisë së Auditit të Brendshëm në Bashkinë Vau Dejës, u konstatua se për vitet 2021

1.a Situata e strukturës së NJAB në Bashkinë e Vau Dejës nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021 paraqitet në tabelën si vijon:

Struktura e kësaj njësie auditimi, në formë tabelore për periudhën e audituar viti 2021, paraqitet si me poshtë:

Nr	Nga data e krijimit deri me 31.12.2021	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi ne pune	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime te vijueshme
	Për vitin 2021						
1	A.N.	Përgjegjës	I Lartë	25	6	2018	40 orë
2	A. P.	Specialiste	I Lartë	3	2	Në proces	
3	S.LI.	Specialiste	I Lartë	2	0	Në proces	

Burimi i të dhënave: *Njësisë e Auditimit të Brendshëm*

Nga auditimi u konstatua se struktura organizative e Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 është përcaktuar që NJAB të ketë në përbërjen e saj 3(tre) punonjës, por që për periudhën nën auditim rezulton se kjo njësi ka funksionuar me 3 (dy) punonjës 1 përgjegjës i njësisë i certifikuar dhe 2 specialist auditit të pa certifikuar si dhe 2 specialist auditit ne proces, në kundërshtim me ligjin nr.

114/2015, “Manualit të Auditimit të Brendshëm” miratuar nga Ministër i Financave nr.100/ 2016 dhe VKM nr.83/2016, përcaktohet qartë që në strukturën e [AB] mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si auditues të brendshëm dhe gjatë afatit 2 vjeçar zhvillon trajnimet e mjaftueshme për t’u certifikuar.[NJAB].

N r	Emri i audituesit	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT									
		Të planifikuar	Në fakt	Profesioni			Vitet e Punës në AB		Certifikimi		
				Ekonomist	Jurist	Të tjerë	deri në 5 vjet	Mbi 5 vjet	I pa certifikuar	Në proces certifikimi	I certifikuar
1	Ardiana Ndoci	1	1	x				x		x	x
2	Arta Paluku	1	1		x		x				
3	Sara Lleshi	1	1	x			x				

➤ **Trajnimet e [NjAB] dhe certifikimet**

Referuar ligjit Nr.10296/2010, Manualit të MFK miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave Nr.8980, Dt.15.07.2010, Manuali i Ri me Urdhrin e Ministrit të FE Nr.108/2016 të MFK, Ligjit nr.114/2015 “Mbi Auditimin e Brendshëm” dhe “Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, rëndësi i është kushtuar trajnimeve të audituesve të [NJAB] sipas planit të trajnimeve, përpiluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik. Për vitin 2021 trajnimet e audituesve të NJAB për Bashkinë Vau Dejës pasqyrohen në tabelën e mësipërme:

Konstatohet se [NJAB] në Bashkisë Vau Dejës, nuk ka respektuar trajnimet e detyrueshme vjetore planifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në kundërshtim me Ligjin nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, “Manualin e Auditimit të Brendshëm të Sektorit Publik”.

Mungesa e trajnimeve çdo vit në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka ndikim negative për njësinë pasi stafit i mungojnë njohuritë mbi mënyrën e funksionimit të këtij sistemi, përgjegjësitë, shkallën hierarkike etj. Mungesa e transparencës për publikun lidhur me njohjen dhe veprimtarinë e këtij institucioni, shkak për këtë është mosveprimi i titullarit të institucionit mbi hartimin e një program trajnimi mbi menaxhimin e riskut.

Bazuar si më sipër Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masë për punonjësit të kryejnë trajnimet mbi menaxhimin e riskut, element ky i rëndësishëm në veprimtarinë e një institucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.

➤ **Hartimi dhe zbatimi i planeve të Auditit të Brendshëm;**

Nga Sektori i Auditit të Brendshëm janë hartuar dhe miratuar për çdo vit në zbatim të ligjit nr. 114/2015 “Për Auditimin e brendshëm ne sektorin Publike”, Planet strategjike dhe vjetore sipas formateve të dërguar në Njësinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm (Ministria e Financave) dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë.

Nga auditimi rezultoi se : Për vitin 2021 NJAB ka planifikuar **12 (dymbëdhjetë)** fusha nga te cilat **4 (katër)** njësi vartëse, janë planifikuar **8 (tetë)** sektor për auditim përputhshmërie dhe **4 (katër)** sektor auditim i kombinuar, por në fakt janë realizuar **9 (nëntë)** auditime konfirmuar me shkresën **Nr.727 Prot, Datë 15.02.2022** i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme e Harmonizimit të

Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Ministrinë e Financave i është dërguar Raporti Vjetor i Veprimtarisë së Strukturës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 në Përputhje me kërkesat e nenit 14, të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “ Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Në mënyrë të përmbledhur auditimet e planifikuara dhe të realizuara paraqiten si vijon:

N r	Periudha	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit				
				Përputh	Financiar	Kombinuar	Performa	Tjera
1	Viti 2021	12	9	8	0	4	-	-

Burimi i të dhënave: *Njësia e Auditimit të Brendshëm*

➤ **Vlerësimi i procedurave dhe standarteve të kryerjes së auditimit të brendshëm**

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve u konstatua se:

–Përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik, ”Manuali i Auditimit të Brendshëm (MAB).

- Sektori i A.B në zbatim të planit vjetor nuk ka përfshirë në grup pune specialist të sektorëve të ndryshëm, për kryerjen e auditimit sipas programeve të miratuara nga Titullari i Bashkisë. Sektori i Auditimit të brendshëm edhe gjatë vitit 2021 ka vazhduar të ketë mangësi në certifikimin e specialistëve të auditimit të brendshëm.

Subjektet e audituara edhe pse i kanë pranuar rekomandimet e dhëna nga AB dhe në përgjithësi i kanë zbatuar ato, nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimit, në përputhje me ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, dhe me Kap. IV, pika 4.1.12, Hapi 11, të MAB.

Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, (Kapitulli VI, ” Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”), në përgjithësi programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me rrisqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e auditimit, drejtimit që do të ndiqen, si dhe grupin e auditimit. Vend të vecantë në program zënë edhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme. Në përgjithësi referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjorë në fuqi.

Nga auditimi konstatohet se mungesa e përgjegjësive të sektorit të auditimit cënon procesin e auditimit pasi reflektohet në performancën e këtij sektori, për rrjedhojë ka çuar në uljen e numrit të auditimeve dhe gjithashtu në mungesën e kontrollit të cilësisë nga struktura përgjegjëse të auditimit.

➤ **Sigurimi i cilësisë në auditimet e kryera dhe kontrolli i zbatimit të detyrave të lëna.**

Për veprimtarinë e Sektorit të AB për periudhën nga **Dt. 01.01.2021 deri në Dt.31.12.2021** është raportuar në mënyrë sistematike Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës.

Nga auditimi i raportimit vjetor për vitin 2021, konstatohet se janë dhënë **52** rekomandime gjithsej, nga të cilat janë në proces zbatimi **52** rekomandime, te cilat janë sipas klasifikimit të mëposhtëm:

- Rekomandime për përmirësimin e sistemeve **(29)**;
- Rekomandim të karakterit organizative **(16)**
- Rekomandime për arktetime **(0)**;
- Rekomandime të tjera **(7)**.

Auditimet e realizuar dhe rekomandimet e realizuara për vitin 2021 paraqiten ne tabelën nr. 2 si vijon;

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT							
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi)			
		Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej ne Leke	Zbatuar	Ne proces	Pa zbatuar
1	Viti 2021	52	-	52	0	-	-	-	-
TOTALI		52	-	52	0	-	-	-	-

Burimi i të dhënave: Njësisë e Auditimit të Brendshëm

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligji nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 10, germa “c” e VKM nr.83 datë 03.02.2016 “Për Miratimin e Krieteve të Krijimit të Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik si dhe neni 64, germa “a” të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”. Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me urdhrin e ministrit të financave nr.100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1),

Shkaku:

Mungesë e kapaciteteve për kryerjen e gjitha angazhimeve, neglizhenca e drejtuesit për plotësimin e Strukturës Organizative të Auditit të Brendshëm.

Ndikimi/Efekt:

Nuk jep garanci në mbështetje të menaxhimit të lartë për zbatimin e objektivave, në Bashkinë Vau Dejës.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi:

Përgjegjësi i Auditimit Brendshëm të marrë masa për hartimin e Kartës së Auditimit, çeljen e dosjes së përhershme të auditimit si dhe të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuara menaxhimit sipas Manualit AB.

- Në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkisë Vau Dejës

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse të marrë masë për punonjësit të kryejnë trajnimet mbi menaxhimin e riskut, element ky i rëndësishëm në veprimtarinë e një insitucioni bazuar në ligjin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit i cili citon se punonjësit duhet të kryejnë trajnime në fushën e përdorimit të metodikës së pranuar në identifikimin, analizën dhe menaxhimin e riskut.

2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor 2021;

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID -19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MFE, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.).

2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet :

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2021;

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2021-2023, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, është bërë ngritja e grupit të punës, është bërë marrja e kërkesave për nevojat për punë, mallë e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i taveve të shpenzimeve sipas programeve, etj.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitet administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë etj, gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

Nga ana e Titullarit të Institucionit nuk është ngritur urdhër i ri për ngritjen e Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022- 2024, por është vazhduar me urdhërin e 2020.

Planifikimi i programit buxhetor afatmesëm 2021- 2023 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, me nr. 52, datë 25.08.2020, konfirmuar nga Prefektura Shkodër nr. 647/1 datë 10.09.2020.

Miratimi i taveve të buxhetit afatmesëm 2021-2023 Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 80 datë 24.12.2020 konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Shkodër, me shkresën nr. 19/1 datë 18.01.2021.

Vendimi i Këshillit Bashkiak me nr. 80 datë 24.12.2020, “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Vau Dejës për vitet 2021-2023”, jo më vonë se 31 Janar, brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.

Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2021 kanë vlerën 186,854 mijë.lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 224,558 mijë lekë, transfertat specifikë ka vlerën 111,825 mijë lekë.

Në total të ardhurat kanë vlerën 90,970 mijë lekë, po ashtu edhe shpenzimet kanë vlerën 89,082 mijë lekë.

Me VKB nr 80 datë 24.12.2020, është marrë vendim nga këshilli bashkiak Vau Dejës për miratimin e buxhetit për alokimin e fondeve të trashëguara nga viti 2020, në vlerën 578,344 mijë lekë.

Gjatë vitit 2021, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të këshillit bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetor 2020). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

- Me VKB nr. 12 datë 26.02.2021, është marrë vendim nga këshilli bashkiak Vau Dejës për miratimin e buxhetit shtese për alokimin e fondeve për rritjen e pagave për funksionin e arsimit parashkollor për vitin 2021, në vlerën 3,448 mijë lekë

Të dhënat për PBA dhe projekt buxhetet për vitin 2021 sipas tabelave në vijim:

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2020	Faza e I PBA 2021	Faza e II PBA 2021	Projekt Buxhet 2021
600	Paga	206,891		188,863	249,236
601	Sigurime Shoqërore	34,529		36,581	42,175
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	98,383		117,256	166,342
605	Transferta Korente të Huaja				
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	301,727		284,683	288,666
I	Shpenzime Korrente	641,530		627,383	746,419
230	Kapitale të Patrupëzuara	9,960			
231	Kapitale të Trupëzuara	199,887		180,917	76,683
	Shp. Kapitale me financim te brendshem	209,847		180,917	76,683
230	Kapitale të Patrupëzuara				
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj				
II	Shpenzime Kapitale	209,847		180,917	76,683
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti				
	I+II +III Totali I Shpenzimeve	851,377		808,300	823,102

Burimi: Drejtoria e financës

Në formë table paraqitet planifikimi bazë i buxhetit për vitin 2021 dhe ndryshimet në tabelën vijuese:

Njesia		Bashkia Vau Dejës + Ndërmarjet e vartësisë Viti 2021						
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti i vitit paraardhes Viti 2020	PBA Plan Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2021	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2021	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	% e realizimit
600	Paga	206,891	249,236	358,465	368,876	224,025	144,851	61%
601	Sigurime Shoqërore	34,529	42,175	56,987	58,311	37,141	21,170	64%
600+601	Paga +Sigurime	241,420	291,411	415,452	427,187	261,166	166,021	61%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	89,264	166,342	213,454	220,229	96,433	123,796	44%
603	Subvencione	0	0	3,034	0	0	0	0
604	Transferta Korente të Brendshme	9,119	0	43,822	39,260	6,406	32,854	16%
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0	0	0	0
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individ	301,727	288,666	353	305,867	304,421	1,446	99%
609		0	0	8,649	8,649	0	8,649	0
602-609	Shpenzime operative	400,110	455,008	269,312	574,005	407,260	166,745	71%
	Shpenzime Korrente	641,530	746,419	684,764	1,001,192	668,426	332,766	67%
230	Kapitale të Patrupëzuara	9,960	0	16,046	16,046	0	16,046	0
231	Kapitale të Trupëzuara	199,887	76,683	400,770	439,478	84,516	354,962	19%
Totali	Shpenzime Kapitale	209,847	76,683	416,816	455,524	84,516	371,008	19%
	Totali (korrente + kapitale)	851,377	823,102	1,101,580	1,456,716	752,942	703,774	52%

Burimi: Drejtoria e financës

Për vitin 2021 bashkia Vau Dejës ka parashikuar investime të reja në buxhet në vlerën 76,682 mijë lekë dhe ka realizuar 18,728 mijë lekë. në mënyrë të detajuar lista e investimeve të reja parashikuar në buxhetin vjetor të vitit 2021 nga të ardhurat e veta dhe granti paraqitet në aneksin nr. 1 pika 2.1 bashkëlidhur raportit të auditimit.

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

-Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2021-2023 me planin buxhetor 2021, paraqitet në tabelën e më poshtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plan përfundimtar 2021	Sipas PBA 2021-2023	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakkush e spec)	418,900	284,961	133,939
2	Shpenzime (602.604.606.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	286,143	161,592	124,551
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant I pakushtez)	400,770	76,683	324,087
4	Investime nga FZSHH	0	0	0
	Total i planit fillestar	1,105,813	523,236	582,577
	Shtesat nga Pushteti Qendror			
5	Investime grant i kushtëzuar (230-231)	38,707	0	38,707
6	Shpenzime për pagat (600+601)	8,287	6,450	1,837
7	Shpenzime (602.604.606.609)	303,909	293,916	9,993
	<i>Total nga Pushteti Qendror</i>	350,903	300,366	50,537
	Gjithsej	1,456,716	823,602	633,114

Burimi: Nga përpunimi i të dhënave sipas planeve të paraqitura nga subjekti.

Nga auditimi konstatohet se ndryshimet midis planit buxhetor vjetor 2021 dhe planit vjetor 2021 në PBA vijnë si rezultat i;

1. Ndryshimi në shpenzimet për pagat (600+601) nga të ardhurat e veta, granti i pakushtëzuar dhe specifik midis planit përfundimtar dhe sipas PBA 2021-2023 janë në masën 133,939 mijë lekë, për arsye se në planin përfundimtar 2021 është përfshirë edhe plani i trashëguar ndër vite i bashkisë në masën 129,706 mijë lekë dhe 4,233 mijë leke nga një shtesë që është bërë gjatë vitit nga rritja e pagave të sektorit të arsimit parashkollor dhe qendrës kulturore të fëmijëve.
2. Ndryshimi në shpenzimet e atrikujve (602+604+606+609) nga të ardhurat e veta, granti i pakushtëzuar dhe specifik midis planit përfundimtar dhe sipas PBA 2021-2023 janë në masën 124,551 mijë lekë, për arsye se në planin përfundimtar 2021 është përfshirë edhe plani i trashëguar ndër vite i bashkisë në masën 123,766 mijë lekë, dhe kemi një shtesë për detyrime që është bërë gjatë vitit në masën prej 669 mijë lekë dhe një shtesë prej 116 mijë lekë që është bërë nga renta minerare gjatë vitit 2021.
3. Ndryshimi në shpenzimet për investime (230+231) nga të ardhurat e veta, granti i pakushtëzuar dhe specifik midis planit përfundimtar dhe sipas PBA 2021-2023 janë në masën 324,087 mijë lekë, për arsye se në planin përfundimtar 2021 është përfshirë edhe plani i trashëguar ndër vite i bashkisë në masën 324,087 mijë lekë. Kjo ka ardhur si rezultat i planifikimit të të ardhurave në nivel me të lartë në krahasim me realizimin e tyre dhe si pasojë kanë mbetur pa u realizuar një sërë investimesh përgjatë viteve.

Përsa i përket ndryshimeve midis planit buxhetor vjetor 2021 dhe planit vjetor 2021 në PBA me fonde te Pushtetit Qendror janë si më poshtë:

1.Ndryshimi në shpenzimet për investime (230+231), janë në vlerën 38,707 mijë lekë, kjo vjen si pasojë e disa projekteve që kanë qënë në vazhdim nga viti paraardhës dhe të projekteve që janë fituar nga viti aktual 2021.

2.Ndryshimi në shpenzimet për pagat (600+601), janë në vlerën 1,837 mijë lekë, që ka ardhur si rezultat i fondit të akorduar nga ministria e linjës për zgjedhjet parlamentare të vitit 2021.

3.Ndryshimi në shpenzimet e atrikujve (602+604+606+609) sipas planit përfundimtar të vitit 2021 dhe sipas PBA 2021-2023 janë në masën 50,537 mijë lekë, që vjen si rezultat i akordimit të fondeve për ndihmën ekonomike, shtesave që kanë marrë ose dyfishime si pagë lufte, dhe alokimet e fondeve që kanë ardhur nga ministria e linjës për bursat e nxënësve të shkollës profesionale “Ndre Mjeda” në Bushat që ndodhet në territor të bashkisë Vau Dejës.

Plani përfundimtar i buxhetit ka diferenca prej **633,114 mijë lekë** nga plani në PBA për shkak se në planin përfundimtar janë pasqyruar rritja e grantit të pakushtëzuar **324,087 mijë lekë** për llogarit e sipërcituar sipas tabelës së sipërcituar.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të grandeve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qënë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit.

Gjatë viteve janë kryer ndryshime në buxhet (shitesa/ pakësime). Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit në mbështetje të Udhëzimit nr.9 dt.20.03.2018”Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit” pika 100 germa “b” dhe “c” ndërmjet zërave të shpenzimeve kapitale, brenda të njëjtit program, miratohen nga Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

- Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nën artikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor veprime që tregojnë se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, Në mënyrë të

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Fondet e shpenzuara nga njësitë vendore për shkak të situatës Covid-19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit viti 2021, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në Aneksin nr. 3 pika 2.3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Konstatohet se plani i buxhetit i gjeneruar nga thesari ka vlerën **1,456,717 mijë lekë** e cila nuk përputhet me vlerën e planit të buxhetit të miratuar nga këshilli bashkiak që ka vlerën **1,101,580 mijë lekë**, ose **355,137 mijë lekë** më pak se plani buxheti i gjeneruar nga thesari.

Planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (të ardhurat e veta vendore, transferta e pa kushtëzuar, si dhe granti) ka vlerën **1,456,717 mijë lekë**, ndërsa realizimi **752,942 mijë lekë**, ose në masën 51.6%. Zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën **368,876 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **224,024 mijë lekë**, ose në masën 61%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 64%.

Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën **232,338 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **102,683 mijë lekë**, ose në masën 44%.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën **455,523 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **84,515 mijë lekë**, ose në masën 19 %.

Titulli gjetjes: Krijimi i diferencave të dukshme me vlerën e planifikuar dhe realizuar, i shpenzimeve buxhetore për vitin 2021 me të ardhurat e veta (pa transfertën e palushtëzuar).

Situata:

Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën **523,235 mijë lekë**, ndërsa realizimi **404,418 mijë lekë**, ose në masën 77% sipas aneksit nr. 4 pika 2.3 bashkëlidhur raportit të auditimit. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën **455,523 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **84,515 mijë lekë**, ose në masën 19 %.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Vau Dejës në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, referuar aneksit nr. 1 pika 2.1 bashkëlidhur raportit të auditimit, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe ngarkojnë me përgjegjësi kryetaren e Bashkisë Vau Dejës z. M. B., si dhe z. A. N., me detyrë Përgjegjës i Buxhetit dhe Financës.

Gjithashtu konstatohet se gjatë vitit 2021 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2021.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ku thuhet:

“Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vonë se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji”.

Kriteri: Pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Shkaku: Lidhja e kontratave në fund të vitit, si dhe për vlerën e plotë të projektit dhe jo për nivelin e fondeve të buxhetuara për vitin përkatës.

Efekti: Mos realizim i investimeve të planifikuara.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë, Sektori i Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrin masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani shpenzimeve publike, me qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurta për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë Kryetari i Bashkisë, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi, të kërkojë korrigjimin e buxhetit nga këshilli bashkiak, me qëllim që të mos ketë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencë

Konstatohet se Për vitin 2021 janë miratuar :“Mbrotjtjen civile” 10,956,440 lekë (programi 03280) nga transfertat e pakushtëzuar, Mbrotjtjen civile” 10,060,329 lekë (programi 03280) të trashëguara nga transfertat e pakushtëzuar “Mbrotjtjen civile” 6,000,000 lekë (programi 03280) nga të ardhurat e veta “Fond rezerve dhe kontigjence” 500 000 lekë (programi 04980) nga transfertat e pakushtëzuar. Mënyrën e llogaritjes të kësaj vlere, bazën ligjore për këtë; Ligjin nr.45/2019 “Për mbrotjtjen civile” Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë”. Vlera e përdorur në fakt nga Bashkia Vau Dejës gjatë vitit 2021 është 4,387,135 lekë duke mbetur pa u përdorur në total është 22,629,634 lekë.

2.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizimit të të ardhurave (faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike të detajuar me nr. fature, datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE)

Detyrimet e prapambetura viti 2021

Vlera e raportuar nga Bashkia Vau Dejës në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2021 është **31,877,150 lekë**, konfirmuar me shkresën nr. 562 Prot., datë 07.02.2022 dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; Drejtorisë së përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik dhe Drejtorisë së Financave Vendore, si dhe është paraqitur në këshillin bashkiak me shkresën nr. 1020 Prot. datë 28.02.2022, e cila kuadron me detyrimet e paraqitura në pasqyrat financiare dërguar degës së Thesarit Vau Dejës me shkresën 1641 datë 30.03.2022 të konfirmuara.

Në lekë

Kodi i detyrimit	Emerimi i detyrimit te prapambetur	Deyrimi i prapambetur	Planifikimi për likujdim në	Detyrime te prapambetura	Detyrime te prapambetura	Pagesa në fakt gjatë vitit 2021	Detyrimet e prapambetura
------------------	------------------------------------	-----------------------	-----------------------------	--------------------------	--------------------------	---------------------------------	--------------------------

te prapamb.		progresiv deri në datën e miratimit të buxhetit vjetor 2021	planin e buxhetit 2021 i vlerës së detyrimit të prapambetur	date 31.12.2020	rregjistruar gjate vitit 2021	e detyrimit të prapambetur të planifikuar në planin e buxhetit	date 31.12.2021
4864100	Detyrime të .p. per vend.gjyqesore	3,342,860		3,342,860			3,342,860
4864200	D.P.per sherbime				1,614,956	1,614,956	
4864300	D.P.per mirembajtje						
4864400	D.P.per investime	4,500,000		4,500,000	4,296,516	8,796,516	
4864400	D.P.per investime nga Ministrite e Linjes (specifiko FZHR etj...)	3,870,553		36,735,326	16,977,704	25,178,740	28,534,290
4865600	D.P per mallra				3,070,185	3,070,185	
4864900	D.P.te tjera						
	Totali	11,713,413		44,578,186	25,959,361	38,660,397	31,877,150

Burimi: Bashkia Vau Dejës

Stoku i detyrimit të mbetur rakordoon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon:

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua sftatgjatë	0		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	31,877,150		6.09%
a	Shpenzime korrente	0		
a,1	Mallra dhe shërbime			
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
b	Shenzime kapitale	28,534,290		
b,1	Insitucione buxhetore			
b,2	Subjekte private	28,534,290		
c	Vendime gjyqësore	3,342,860		
c,1	Marrëdhënie pune			
c,2	Mallra dhe shërbime			
c,3	Investime			
c,4	Të tjera	3,342,860		

III	Totali (I+II)	31,877,150	523,235,488	6.09%

Burimi: Bashkia Vau Dejës

Titulli i gjetjes: *Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura dhe raportimi i tij në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë si dhe marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion.*

Situata:

Bashkia Vau Dejës në datën 01.01.2021 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 44,578 mijë lekë, e cila ka si burim financimi të ardhurat e veta. Në planin e buxhetit vjetor 2021 nuk është planifikuar likuidim i detyrimeve të prapambetura në kundërshtim me ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. Pra, në datën 31.12.2021 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimor (01.01.2021), është ulur me 12,701 mijë lekë, ose në masën prej 28.4%, duke mbetur pa u likuiduar vlera 31,877 mijë lekë. Lista analitike e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2021 në mënyrë të detajuar paraqiten në aneksin nr. 5 pika 2.4 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Rezulton se gjatë vitit 2021 Bashkia Vau Dejës ka planifikuar investime nga të ardhurat e veta në vlerën 76,682 mijë dhe ka realizuar 18,728 mijë lekë.

Për sa më sipër rezulton Bashkia Vau Dejës ka ndërmarr angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

Për mos marrjen e masave të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimi i detyrimeve të reja për vitin 2021, ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Vau Dejës z. M. B., si dhe z. A. N., me detyrë Përgjegjës i Buxhetit dhe Financës.

Kriteri: Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

Shkak: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Efekti: Mos pasqyrimi real i stokut të detyrimeve të prapambetura.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Vau Dejës dhe Sektori i Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Gjithashtu të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme.

Titulli i gjetjes: Efektet negative në buxhet si rezultat i likuidimit të vendimeve gjyqësore

Situata:

Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura rezulton se Bashkia Vau Dejës për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2021 ka shpenzuar vlerën **639,100 lekë**, për 1 raste, *të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona*. Gjithashtu konstatohet se për likuidimet e subjekteve të mësipërme janë nxjerrë urdhrat përkatës nga titullari i institucionit, por nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Kriteri: Nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Pika 60 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrin rregullator të fushës.

Efekti: Krijimi i detyrimeve të prapambetura, të cilat ndikojnë negativisht në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë Vau Dejës të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

2.2.6. Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor;

➤ **Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore**

Në Bashkinë Vau Dejës, **Për vitin 2021** numri i punonjësve është miratuar me Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr. 29 datë 12.10.2020, me VKB nr. 80, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit 2021”. Miratuar në total numri 385+ 8 punonjës të QKB dhe Gjendjes Civile = 393 punonjës gjithsej, në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 366 punonjës, nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve, Referuar vendimit të sipërcituar Struktura e taksave dhe tarifave vendore është e ndarë në: Sektori i taksave dhe tarifave vendore i përbërë nga 8 punonjës, konkretisht 1 përgjegjës, 7 specialistë për Bashkinë Vau Dejës dhe Sektori i Kontrollit dhe Borxhit Tatimor i përbërë nga 3 punonjës, konkretisht 1 përgjegjës, 2 specialistë. Në mënyrë të detajuar struktura e taksave dhe tarifave vendore paraqitet në aneksin nr. 1 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

➤ **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve**

Titulli i gjetjes: *Performancë e dobët në planifikimin dhe realizimin e disa zërave të të ardhurave për periudhën objekt auditimi.*

Situata:

Për vitin 2021: Paketa Fiskale e taksave dhe tarifave vendore është miratuar me VKB nr. 71 datë 26.11.2020, e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër. Nga të dhënat e **pasqyrës aneks nr. 2pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.**

Për vitin 2021, është planifikuar si e ardhur vlera **186,854** mijë lekë dhe është realizuar në vlerën **90,970** mijë lekë, pra me një mosrealizim në shumën 95,884 mijë lekë. Tejkalimet dhe mosrealizimet janë argumentuar si më poshtë:

Të ardhurat tatimore dhe argumentet e dhëna nga sektori i taksave dhe tatimeve për tejkalimet dhe mosrealizimet, paraqiten si më poshtë:

- Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin, është në masën 110%, pasi kjo është e ardhur që vjen nga DRT Shkodër, ndërsa planifikimi është bërë duke u nisur nga realizimi i një viti më parë.
- Taksa mbi pasurinë e paluajtshme (ndërtese, tokë, truall), është në masën 46%,. Ky mosrealizim ka ardhur si rezultat i pagesës së ulet të taksapaguesve familjarë, pasi nuk ka pasur një regjistër të taksapaguesve apo adresa për t'i njoftuar, si dhe mungesë e dokumentacionit të pronësisë mbi ndërtesën dhe truallin.
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, është në masën 16%, pasi planifikimi është bërë duke u nisur nga të ardhurat e realizuara të një viti më parë, të cilat kanë qënë të konsiderueshme, por edhe nga mungesa e legalizimeve nga ana e ASHK-së.
- Taksa e mjeteve të përdorura është në masën 107%, ku ka ndikuar edhe kërkesa e Bashkisë për rakordime mujore me DRSHTRR Shkodër.
- Të ardhura nga taksa e rentës minerare, është në masën 2710%, për arsye të dërgimit nga qeverisja qendrore në muajin dhjetor 2021.
- Taksa e tabelës dhe reklamës, është në masën 57%, për shkak të çmimit shumë të lartë për m² dhe pamundësisë për të paguar.

Të ardhurat Jotatimore, paraqiten si më poshtë:

- Të ardhurat nga tarifat vendore, është në masën 66%, për shkak të mos likuidimit nga ana e familjarëve.
- Të ardhurat nga tarifat e ndriçim, janë në masën 40% kryesisht për shkak të mos likuidimit nga ana e familjarëve.
- Të ardhurat nga tarifat e gjelbërimit, janë në masën 59% kryesisht për shkak të mos likuidimit nga ana e familjarëve.
- Të ardhurat nga shërbimi administrativ, janë në masën 8%, ku ka ndikuar planifikimi duke marrë parasysh realizimin e një viti më parë, si dhe me objektivin e rritjes së numrit të shërbimeve nga ana e bashkisë, si dhe shërbimeve të MZSH, lejeve të ndërtimit etj., të cilat nuk janë realizuar.
- Të ardhurat e tjera, janë realizuar në masën 37%. Këtu përfshihen, gjobat, kontrata qeraje (toke bujqësore, trualli, ndërtese, dhe fondi pyjor), në pronësi të Bashkisë të dhëna më qera subjekteve dhe individëve. Në mos realizim ka ndikuar emigrimi i individëve të cilët kanë marrë me qera tokën bujqësore dhe braktisja e saj. Gjithashtu në mosrealizim ka ndikuar edhe mos çertifikimi i pronave të Bashkisë nga ana e ASHK-së, duke mos pasur mundësi për dhënien me qera të këtyre pronave.

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të theksohet për vëmendjen e menaxhimit të lartë të Bashkisë Vau i Dejës, që në procesin e planifikimit, menaxhimi nuk ka marrë në konsideratë mosrealizimet

apo tejkalimet e mëparshme, në mënyrë që planifikimi në të ardhmen të bëhet mbi baza sa më reale, për të mos shkaktuar defiçit në të ardhurat e arkëtuara dhe për pasojë mosrealizim të shpenzimeve, investimeve, mirëmbajtjeve, etj, në dëm të interesave të publikut.

Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë”; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 42, “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 1, 2 dhe 4; neni 54, “Raportimi financiar” nënpika c, UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

Z. M. B., me detyrë Kryetar i bashkisë Vau i Dejës;

Znj. M. G., me detyrë Përgjegjëse e sektorit të tatim-taksave vendore.

Kriteri:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, “Kompetencat dhe detyrat e kryetarit të bashkisë”; ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 42, “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 1, 2 dhe 4; neni 54, “Raportimi financiar” nënpika c, UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b; Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, ligji nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekt: Mos planifikim i saktë i treguesve në planin e të ardhurave shkakton mangësi dhe probleme në likuidimin e shpenzimeve të kryera nga institucioni, si dhe është shkak kryesor për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

Shkaku: Mos njohja e situatës nga strukturat përgjegjëse, neglizhenca dhe mosrespektimi i akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës dhe Sektori i taksave dhe tarifave vendore të marrin masa për një planifikim sa më realist të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e një plani të pa realizueshëm në fakt.

➤ **Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:**

Në rregulloren e brendshme të institucionit nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me ta.

Të ardhurat nga agjentët tatimorë (*Drejtoria Rajonale Tatimore, në lidhje me TFTH; Drejtoria e Përgjithshme të Buxhetit, Drejtoria e Menaxhimit të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me rentën minerare; AKSH-ja, në lidhje me taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe DRSHTRR Vau Dejës, në lidhje me taksën vjetore të mjeteve të përdorura*) derdhen automatikisht në fund të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Vau Dejës dhe konfirmohen nga Dega e thesarit Vau Dejës.

Ne lidhje me rakordimet me agjentët tatimorë gjate vitit 2021 Bashkia Vau Dejës me anë të shkresave zyrtare i është drejtuar agjentëve tatimorë, konkretisht;

- Drejtorisë Përgjithshme Doganave, dhe Drejtorisë Rajonale Tatimeve Shkodër, me shkresën Nr. 3146 prot, date 21.05.2021 “Kërkesë për rakordim”
- Drejtorisë Rajonale Tatimeve Durrës me shkresën nr. 4358prot, date 07.07.2021, “Kërkesë për rakordim”, ku në përgjigje të kërkesës së sipërcituar me shkresën Nr. 9259/prot datë 07.09.2021, është konfirmuar që nuk ka pagesa përkatëse.
- Drejtorisë Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë Tatimpaguesve të Mëdhenj Tirane, me shkresën Nr. 4356, date 07.07.2021, ”Kerkese për Rakordim” nga e cila nuk është kthyer asnjë përgjigje.
- Drejtorisë Rajonale Tatimeve Tirane me shkresën Nr. 4357, date 07.07.2021 “Kërkesë për Rakordim”, në përgjigje të shkresës së sipërcituar Drejtorisë Rajonale Tatimeve Tirane me shkresën nr. 15939/1, date 23.7.2021, ka cituar faktin që nuk ka pagesa për renten minerare.

Për TFTH:

- Për Tatim fitimin e thjeshtuar, rakordojme çdo muaj, nëpërmjet e-maileve zyrtare me DRT Shkodër, ku u dërgojnë listën dhe akt-rakordimet përkatëse.

Për taksën e kalimit të drejtës së pronësisë:

- ASHK Dega Shkodër, i është dërguar shkresa me Nr. 3147 prot, date 21.05.2021 “Kërkesë për rakordim”, ku në përgjigje të tyre Nr. 6265/1prot, date 18.06.2021, janë vëmë në dijeni me shkresë zyrtare në momentin e arkëtimit të kësaj të ardhure.

Për taksën e mjeteve të përdorura:

- DRTRR Shkodër, i është dërguar shkresa Nr. 671prot, date 01.02.2021 “Kërkesë për informacion”, për vendosjen në dispozicion të listës së subjekteve të transportit që paguajnë këtë taksë. Është shumë e rëndësishme të theksohet se vjelja e këtyre të ardhurave ka pasur përmirësime pas kontraktimit me Agjentin Tatimor, por ka një shumë të madhe debitorësh, e cila së pari duhet të përcaktohet nëse është mangësi e planifikimit apo problem në vjelje dhe më pas të vazhdohet me procedurat përkatëse. Sa më sipër rezulton se Sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk ka ndërmarr të gjitha procedurat ligjore për rakordimin e agjentëve pasi:

- -Për rentën minerare, e cila rrjedh nga eksportet nuk është bërë rakordimi periodik i rregullt mujor me Drejtorin e Doganave dhe mbahet korrespondencë me Ministrinë e Financave.
- Për rentën e cila rrjedh nga shitjet brenda vendit, mbahet korrespondenca me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit sipas përcaktimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 7 “Të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit” dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 15 “Parapagimi”, si dhe me UMF nr. 26, datë 04.09.2008 “Për taksat Kombëtare”

Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë gjatë periudhës së audituar janë paraqitur si vijon;

Agjenti Tatimor	Lloji I Taksës	2021	30.09.2022
DRTSH	TFTH	645.252	135.599
DRSHTRR	Taksa e mjeteve te perdorura te transportit	16.115.104	11.943.234
ASHK	Taksa e kalimit te drejtes se pronesise	0	444.095
DR.DOGANAVE	Renta minerare	271.630	14.247

Burimi: Bashkia Vau Dejës

Titulli gjetjes: *KLSH-ja konstaton se nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vau Dejës, nuk janë ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pa arkëtuara (borxhi), dhe për të gjithë subjektet.*

Situata: Sipas të dhënave për strukturën organike të Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Vau Dejës, konstatohet se nuk ka një të ngritur një strukturë përgjegjëse për menaxhimin e borxhit (debitorëve nga taksat/ tarifave vendore).

Referuar të dhënave të paraqitura nga kjo drejtori, detyrimet për taksat e tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentë familjare paraqitet si vijon:

➤ **Detyrimet e familjarëve:**

Mënyra e parashikimit të detyrimeve të familjarëve:

Tarifa e pastrimit parashikohet në bazë të numrit të familjeve rezidente aktive të bashkisë.

Taksa e ndërtesës parashikohet në bazë të regjistrimit të taksës që kanë njësitë, të përditësuar me numër njësi pronësie të reja, saktësim dhe shtim sipërfaqesh.

Nga auditimi u konstatua se sipas VKB nr. 71 datë 26.11.2020 “Për nivelin e taksave e tarifave vendore për vitin 2021” bashkia Vau Dejës nuk ka lidhur Akt Marrëveshje me Ndërmarrjen e Ujësjetës Kanalizimeve Vau Dejës për vjeljen e detyrimeve të familjarëve mbi bazën e kontratave të ujit të pijshëm që abonentët familjarë nuk kanë, evidentimit dhe regjistrimit të abonentëve të rinj duke plotësuar regjistrin e taksapaguesve familjarë, gjë e cila ka shkaktuar edhe mangësitë e mëdha dhe një numër të lartë debitorësh në lidhje me këto detyrime.

- Njoftimet e bëra për familjarët, masat e mara dhe masat shtrënguese

Për arkëtimin e detyrimit që rezulton nga bizneset për (taksën e ndërtesës, tarifës së pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit) janë ndjekur disa masa të mbledhjes me forcë të detyrimit.

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën **31.12.2021** për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë për abonentët familjarë në vlerën 167,067,869 lekë, ndërsa detyrimet e vitit ushtrimorë janë në vlerën 138,642,783 lekë sipas rakordimit me Drejtorinë e Financës. Sa më sipër vlera **167,067,869 lekë** përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Vau Dejës, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjarë deri në datën **31.12.2021**. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar. Në mënyrë të përmbledhura detyrimet e familjarëve për taksat dhe tarifave vendore të vitit ushtrimor 2021 janë si vijon;

Nr. debitorëve	Emertimi njesive	Gjendja fund 31.12.2020	Pakesime 2021	Shtesa gjate vitit 2021	Gjendja ne fund vitit 2021
13040	FAMILJARE	45,529,037	17,103,951	138,642,783	167,067,869
3542	Vau-Dejesi qender	14,870,391	1,325,014	34,456,734	48,002,111
5762	Nj.A Bushat	21,968,511	15,009,873	81,664,361	88,622,999
1659	Nj.a Hajmel	8,690,135	769,064	16,287,701	24,208,772
755	Nj.A. Temal			2,864,589	2,864,589
688	Nj.A. Vig-Mnele			2,772,901	2,772,901
634	Nj.A. Shllak			596,497	596,497

Burimi: Bashkia Vau Dejës.

➤ **Taksa e tokës:**

Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin e taksës së tokës bujqësore për vitin 2021, u konstatua se kishte rezerva në planifikim, pasi sipas të dhënave të marra nga zyra e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Vau i Dejës mbi ndarjen e tokës bujqësore për familje dhe boniteti, evidentohet mos planifikim në vlerën **15,254** mijë lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Vau Dejës, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjarë deri në datën **31.12.2021**. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar. konkretisht si vijon. **Aneksi i. Pritshmëria e taksës së tokës bujqësore për vitin 2021.**

Nr	Njesia Administrative	Toke bujq. gjithsej	Nr. Fam. Qe kan mar AMTP (Keto janë nr I familjeve)	Sipërfaqja e tokës ndar ne faket Ligji 7501	Kategoria e tokës ndar sipas ligjit 7501/ në hektar					Sipërfaqja e ndar sipas kategorive	Sipërfaqja e tokës se pandar	Sip. e tokës dhene me qira
		Ha ne 1991			III	IV	V	VI	VII - X			
1	Qender Vau Dejës	1141	1654	1019	7	293	503	57	159	1019	122	
2	Bushat	5783	4756	5783	2470	2876			437	5783	0	18.262
3	Hajmel	2232	1585	2232		1849	383			2232	0	94
4	Vig Mnel	530	974	530					530	530	0	
5	Temal	251	1144	111					111	111	140	
6	Shllak	114	482	114					114	114	0	
Shuma		10051	10595	9789	2477	5018	886	57	1351	9789	262	112.262
Çmimi sipas VKM					2800	2300	1900	1600	1400			
					6,935,600	11,541,400	1,683,400	91,200	1,891,400			

Shenim: Numeri I familjeve që në marrë AMTP nuk e kena si dokument, por kena numerin e familjeve qe kanë qenë 01.08.1991

Burimi: Bashkia Vau Dejës.

➤ **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Administrimi i taksave vendore nuk bëhet me program, nuk janë të pasqyruara regjistrat, sipas aktiviteteve, njoftim detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë. Nga të dhënat që kërkohen për auditim, konstatohet se informacionet që kërkohen të dhënat nuk dalin të analizuar për çdo zë tatimor që sektori i taksave dhe tarifave vendore Bashkia Vau Dejës aplikon.

Referuar të dhënave të marra nga Sektori i taksave dhe tarifave vendore Bashkia Vau Dejës, situata e lëvizjes së subjekteve paraqitet si më poshtë:

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja Në fillim	Regjistrime Reja	Mbyllur Aktivit	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	2020	475	27	28	474
		2021	474	36	6	503
		2022	503	35	31	507
2	Biznesi Madh	2020	104	6	1	109
		2021	109	8	1	116
		2022	116	10	1	125
(1+2)	Gjithsej	2020	579	33	29	583
		2021	583	44	7	620
		2022	632	45	32	645

Burimi: Bashkia Vau Dejës.

➤ **Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifat vendore.**

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2021 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh dhe subjekte shtetërore në vlerën **28,844,801 lekë, vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguara për buxhetin e Bashkisë Vau Dejës, ndërsa vlera 11,661,801 lekë i përket vitit ushtrimor 2021.**

Referuar të dhënave të vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se, gjendja e debitorëve paraqitet si vijon:

Nr. debitorëve	Emertimi njesive	Gjendja fund 31.12.2020	Pakesime 2021	Shtesa gjate vitit 2021	Gjendja ne fund vitit 2021
419	BIZNESE	22,932,161	5,748,717	11,661,357	28,844,801
112	Nj.A Vau-dejes gender	5,818,697	1,139,095	3,920,121	8,599,723
275	Nj.A Bushat	16,512,837	4,441,919	7,050,503	19,121,421
18	Nj.A Hajmel	524,065	165,736	237,040	595,369
10	Nj.A. Temal	66,110	1,967	412,344	476,487
2	Nj.A. Vig-Mnele	10,452		19,451	29,903
2	Nj.A. Shllak			21,898	21,898

Burimi: Bashkia Vau Dejës

Sa me sipër ariet në konkluzionin se nga strukturat tatimore të Bashkisë Vau Dejës, për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, **pasi** janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar **kallëzim penal** bazuar në nenin 181, “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime, ku përcaktohet se:

“Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.3., ku përcaktohet se:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: 1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës: a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre; b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.”

Neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi:

Z. Gj. D., me detyrë Përgjegjës Sektori i Kontrollit dhe Borxhit Tatimor;

Znj. M. G.i, me detyrë Përgjegjëse e sektorit të tatim-taksave vendore.

Kriteri: Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve³.

Ndikimi/Efekt: Mos ndjekja e plotë e procedura për arkëtimin e detyrimeve, rrit nivelin e detyrimeve të paarkëtuara në fund të periudhave ushtrimore, si një e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë, ku në fund të vitit 2021 ka një vlerë afërsisht sa plani vjetore i të ardhurave të Bashkisë Vau Dejës.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit ligjorë në fuqi, si dhe mungesa e një strukturë organizative të përshtatshme.

Rëndësia: i lartë

Rekomandimi:

Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pavjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të pa arkëtuara (debitor), në vlerën **196,638 mijë lekë**, nga e cila: subjekte fizik/juridik në vlerë 28,844 mijë lekë, si dhe abonentë familjarë në vlerë 167,067mijë lekë.

Bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat tatimore” me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

d. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

e. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” i ndryshuar.

f. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana Drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar dhe Drejtorisë Juridike të Bashkisë Vau i Dejës, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, “Mospagimi i taksave dhe tatimeve

➤ **Të ardhurat dhe vlerat debitorë nga taksat e ndikimit në infrastrukturë:**

Titulli gjetjes: KLSH konstatoj se Drejtorja e Planifikim Urban në bashkëpunim me Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Vau Dejës në lidhje me legalizimet dhe pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, nuk ka bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve në vlerën 496,796 lekë, shumë e cila përben të ardhur të munguar për Bashkinë

³ Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithëse mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjër në tre vjet.

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit që disponon Sektori i të Ardhurave, Bashkia Vau Dejës në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Shkodër janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Shkodër.

Konkretisht për periudhën deri më **01.01.2021-31.12.2021**, sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën **496,796 lekë** për 15 persona, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës, sipas aneksit nr. 3 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit. Rezulton se sektori i taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Vau i Dejës nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që jetë drejtuar ASHK-në Shkodër (ish ZVRPP), për shkëmbim informacioni mbi hipotekimin e ndërtimeve informale të pajisura me leje legalizimi dhe për t'i propozuar lidhjen e një aktmarrëveshjeje ndërmjet Bashkisë Vau i Dejës dhe ASHK Rajonale Shkodër. *Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 9482 datë 03.04.2006, "Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; VKB Vau i Dejës "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vau i Dejës", etj.*

Kriteri:

Ligji nr. 9482 datë 03.04.2006, "Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" i ndryshuar, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar; VKB Vau i Dejës "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vau i Dejës",

Ndikimi/Efekti: Mos arkëtimi i detyrimeve taksës së ndikimit në infrastrukturës nga ndërtimet pa leje, ka çuar në mungesë të ardhurash në vlerën **496,796 lekë**, për buxhetin e Bashkisë.

Shkaku: Mos kryerja e akt-rakordimeve nga Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe ASHK-në Shkodër.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:-

-Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje për vitin 2021 në vlerën **496,796 lekë** ndaj **15** personave si dhe t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore AShK Shkodër, vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë.

- Drejtoria e të Ardhurave të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijoje me masa shtrënguese deri në arkëtimin e kësaj takse në shumën **496,796 lekë**, nga të gjithë individët e listuar si debitorë bazuar në legjislacionin tatimor.

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Titulli gjetjes: *Lejimi i subjekteve që tregtojnë hidrokarbure me Licencë të bashkisë dhe papaguar tarifën në zbatim të VKM nr. 344, datë 19.04.2017.*

Situata:

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion nga Drejtoria e Shërbimeve dhe e licencave, në lidhje me subjektet e tregtimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Vau Dejës rezultojnë se : Në Bashkinë Vau Dejës gjatë vitit 2021 kanë ushtruar aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikantë dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë 21 subjekte, sipas aneksit 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se 1 subjekt (Vëllezërit Dodani), i cili vazhdon të ushtrojë aktivitetin e pajisur me autorizimin përkatës, për të cilin tarifa për pajisjen e mëparshme me licencë tregtimi është ndarë në afat 1 vjeçar. Për këtë rast, nga Bashkia Vau i Dejës është aplikuar në mënyrë të gabuar tarifimi, duke e trajtuar këtë subjekt me pagesë të pjesshme, në vlerën 200,000 lekë, pra me 20% të vlerës së kësaj pagese. Janë pajisur me autorizim 10 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte si dhe nuk është ndërmarr asnjë procedura ligjore për pajisjen me autorizim 5 vjeçar sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 11 subjekte, **në total vlera e munguar për bashkinë Vau Dejës është 19,300,000 lekë sipas tabelës së sipërcituar. Veprime dhe Mosveprime janë në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015** “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pikës 1 gurmës “b” ku cilësohet:

II. Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë

1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:

b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.

9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante është 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe 2,000,000 (dy milionë) lekë, për bashkitë e tjera.

- Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr.344, dt. 19.4.2017.

"9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera."

10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 1 000 000 (një milion) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë, për bashkitë e tjera.

- Pika 10 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr.344, dt. 19.4.2017.

"10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500 000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera."

"15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të

bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.

15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe vendndodhjen e pikave të depozitimit apo të tregtimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi."

-VKM nr. 344, datë 19.04.2017, për disa ndryshime ne VKM nr. 970, pika 15.1 *Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë.*

15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe vendndodhjen e pikave të depozitimit apo të tregtimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi."

Kriteri: Në kundërshtim me nenin 35 të ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, kapitulli II dhe kapitulli III, pika 4. e VKM nr. 170, datë 25.4.2002 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre", i ndryshuar si dhe kapitulli II, pika 1; germa "b", dhe pika 9, ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa "b" dhe pika 9 dhe 15 të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos ndjekja e procedurës për dhënien e Liçensë së tregtimit të karburanteve, çon në mungesë të ardhura për Bashkinë Vau Dejës me vlerë **19,300,000 lekë**.

Shkaku: Mungesa e bashkëpunimit dhe mos ndjekja e të gjitha rrugëve administrative e ligjore për mos lejimin e ushtrimit të aktivitet pa dokumentacion të rregullt.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tarifës së pataksuar prej **19,300,000 lekë** sipas pasqyrës Aneks nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

➤ **Të ardhurat nga gjobat e IMTV.**

Titulli i gjetjes: Krijimi i debitorëve nga mos arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) në vlerën 2,200,000 lekë

Situata:

Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të Bashkisë Vau Dejës rezulton se për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Vau Dejës janë vendosur 11 gjoba në vlerën 2,700,000 lekë sipas aneksit nr. 5 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Sa më sipër rezulton se për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Vau Dejës janë vendosur 11 gjoba në vlerën **2,700,000 lekë** nga të cilat është arkëtuar vlera **500,000**

lekë duke mbetur pa u arkëtuar vlera **2,200,000 lekë**, të cilat nuk janë shpallur titull ekzekutiv, por që nuk ka filluar procesi i kërimit të tyre. duke **sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën prej 2,200,000 lekë.**

Rezulton se për të gjitha praktikantët IMT-ja, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës, nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Vau Dejës në vlerën prej **2,200,000 lekë**, në kundërshtim me:

a-neni 16, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", me ndryshime, **përcaktohet se:** -Gjoha paguhet nga kundërvajtësi brenda 5 ditëve nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afat paguhet kamata 2 për qind për çdo ditë vonesë, **deri në një muaj.** Kur edhe pas këtij afati nuk kryhet pagesa, vendimi ekzekutohet në rrugë gjyqësore sipas ligjit.

-Neni 15-(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni 1)(Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2)(Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 324, datë 23.9.2010, neni 3);

b-nuk janë nisur procedurat e vënies në ekzekutim të aktit administrativ (vendimit të Gjyqësorit) të përcaktuara në nenet, 9,22 dhe 30, të ligjit nr. 10279,datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

Kriteri:

Neni 16, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", me ndryshime; **Neni 15-**(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni 1)(Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2)(Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10 324, datë 23.9.2010, neni 3); - **Nenet**, 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279,datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

Shkaku:

Mos vjelja e gjobave të vendosura nga IMT -ja si dhe mos zbatimi i procedurave për prishjen e objekteve pa leje.

Ndikimi/Efekti

Mungesë të ardhurash nga mos arkëtimi i penaliteve dhe prishje të planit urbanistik nga ndërtimet pa leje dhe në kundërshtim me lejet e ndërtimit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi:

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat dhe të kërkojnë në Gjykatë të marrin masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv duke llogaritur edhe kamata vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar në vlerën **2,200,000 lekë** sipas aneksit nr. 5 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

➤ **Të ardhurat nga kontratat e aseteve**

Nga auditimi rezulton se në Bashkinë Vau Dejës janë lidhur 83 kontrata dhënie me qera të aseteve, në përdorim apo në pronësi të Bashkisë dhe Njësive Administrative. Për vitin 2021 nga asetet në përdorim apo në pronësi të Bashkisë dhe Njësive Administrative janë lidhur 8 në vlerë kontrate 749,345 lekë ndërsa 75 kontrata janë vazhdim i kontratave të lidhura nga vitet e mëparshme të lidhura nga bashkia Vau Dejës me subjekte fizik dhe juridik nga të cilat 25 kontrata janë lidhur për dhënie me qira të tokave bujqësore, 4 kontrata për dhënie me qira të trojeve, 3 për dhënie

me qira të ndërtesave si dhe 51 kontrata dhënie me qera tokë të ngastrave në fondin pyjor dhe kullor në Bashkinë Vau Dejës.

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2021 Bashkia Vau Dejës mos pagesën e detyrimeve nga kontratat e aseteve e dhëna me qera është në vlerën **1,062,629 lekë vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguara për buxhetin e Bashkisë Vau Dejës**. Në mënyre të detajuar paraqitet në aneksin si vijon;

Nr.	Emertimi	Debitore deri me 31.12.2021	Pakesime debitorësh gjate 2022	Pakesime Gjore gjate 2022	Gjendja deri me 31.10.2022
25	Dhenie me qira Toke bujqësore	738,929	20,743	9,894	778,302
4	Dhenie me qira Truall				
3	Dhenie me qira Ndërtese	43,200	83,220		12,780
51	Dhenie me qira Fond Pyjor	280,500	62,500	328	440,770
83	Totali	1,062,629	166,463	10,222	1,231,852

Burimi: Bashkia Vau Dejës

Rezultoi se në territorin e Bashkisë Vau Dejës ushtrojnë aktivitet 2 Shoqëri Koncesionare sipas tabelës vijuese;

Nr.	Qarku	HEC-i	" Shoqeria Koncesionare	Kontratrat koncesionare
1	Shkoder	Ashta 1, 2	"E.A." sh.p.k	2
2	Shkoder	Gjader 1/1, 1/2, 2, 3, 4, 6	"S.P.E GJ." shpk	6

Burimi: AKBN dhe Bashkia Vau Dejës

Sa më sipër grupi i auditimit auditoj 1 subjektë nga 2 subjektet pasi për Hec-it Ashta 1,2 me shoqërinë koncesionare "E.A." sh.p.k, Bashkia Vau Dejës rezulton se me VKM nr. 823 datë 26.11.2014 “ Për heqjen nga fondi pyjor dhe kullor të sipërfaqeve pyjore në ekonominë pyjore “Drin-Gjadër-Kir” në Qarkun e Shkodrës për ndërtimin e Hidrocentralit të Ashtës. Sipas VKM së sipërcituar sipërfaqja e hequr nga fondi pyjor dhe kullor është 98.62 ha në ngastrat pyjore 4, 10, 11, 12, 13, 14, të ekonomisë pyjore “Drin-Gjadër-Kir” Në mënyre të detajuar problematikat e konstatuara janë si vijon;

Titulli i Gjetjes: *Keqadministrimi i të ardhurave nga kontratat e qiradhënies së pasurive të paluajtshme.*

Situata:

Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Vau Dejës me palët e treta, u konstatua se nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe Drejtoria e Bujqësisë, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mostarifim të subjekteve për përdorimin e pronave të Bashkisë Vau Dejës, përlllogaritje e gabuar e tarifave, mos aplikim i kamatëvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e qirave, etj), veprime dhe mosveprime të cilat kanë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vau Dejës në vlerën 4,226,414 lekë si vijon:

1. SPE Gjader Sh.P.K Gjader. Për periudhën 2018 dhe 2021, i shtrijnë efektet 1 kontrata, si më poshtë vijon:

-Kontratë qiraje nr.6255 prot, datë 18.09.2018 nënshkruar nga përfaqësuesi me autorizim Zv/Kryetari i Bashkisë Vau Dejës z. Admirn Hasmegaj dhe qiramarrësi shoqëria "SPE Gj. " shpk me nr. 265 prot, datë 18.09.2018, përfaqësuar nga administratori z. V. K.

-VKB nr.44, datë 21.06.2018 "Për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullor për ndërtimin e HEC-it Gjadër nga subjekti " SPE Gj. "shpk" me afat 1 vite. Konfirmuar nga prefekti me shkresën nr. 891/1 datë 16.07.2018.

-Me shkresën nr. 1574 prot, datë 19.09.2018 Bashkia Vau Dejës i ka dërguar Ministrisë së Mjedisit, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Mjedisit dhe jetësimi i Prioriteteve e Mbrojtjes dhe Trajtimit të Pyjeve, Raportin Tekniko-Ekonomik sipas Urdhrit nr. 50, datë 20.03.2018 përpiluar nga grupi i punës z. M.S., z. L.Ll., dhe z. Z. U. miratuar nga zv/Kryetari i Bashkisë Vau Dejës z. A. H.

Afati i kontratës : 19.09.2018-18.09.2019 (1 vite).

-Vlera e kontratës është 1,662,075 lekë, nga të cilat 108,050 lekë i përket lëndëve drusore, që paguhet vetëm në vitin e parë të kontratës, vlerë e cila është likuajduar sipas faturës nr. 3540 datë 18.09.2018.

Përlllogaritjet e Bashkisë Vau Dejës sipas raportit teknik:

-Trungishte 0.005 ha*120,000 lekë = 600 lekë

-Induktive, etj... 0.05 ha * 76,800 = 3840 lekë

-Shtrirje tubacionesh 3.429 km trungishte * 240,000 lekë/km/1 vit = 822,960 lekë;

-Shtrirje tubacionesh 0.871 km induktive * 150,000 lekë/km/1 vit = 130,650 lekë;

-Linjë elektrike trungishte 4.302 km x 60,000 lekë /km/1vit=258,120 lekë

-Linjë elektrike 0.43 km induktive * 25,000 lekë/km/1 vit = 10,750 lekë;

-Linjë elektrike 2.103 km Pyll/djerr * 25,000 lekë/km/1 vit = 52,575 lekë;

-Linjë elektrike 0.509 km Kullot * 25,000 lekë/km/1 vit = 12,725 lekë;

Përdorim Rruge

Trungishte 3.429 km * 70,000 lekë = 240,030 lekë

Inkuktive 0.871 km * 25,000 lekë = 21,775 lekë

Total qira = **1,554,025 lekë qira për sipërfaqe të dhënë në përdorim.**

-Sa më sipër rezulton se tarifat e aplikuara nga grupi i punës janë në kundërshtim me VKM nr. 391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", i ndryshuar, si dhe afatin e dhënies në përdorim përcaktuar në VKB nr.44, datë 21.03.2018.

Problematikat e konstatuara nga grupi i auditimit:

Së pari: -Kontratë qiraje nr.6255 prot, datë 18.09.2018 nënshkruar nga përfaqësuesi me autorizim Zv/Kryetari i Bashkisë Vau Dejës z. A. H.dhe qiramarrësi shoqëria "SPE Gj. " shpk me nr. 265 prot, datë 18.09.2018, përfaqësuar nga administratori z. V.K.

-Nga shqyrtimi i kontratave të lidhura dhe sipërfaqes së përfshirë në përlllogaritje sipas qeverisjes pyjore në ngastrat, në të cilat shtrihet gjurma e projektit, konstatohet se referuar VKB nr.44, datë 21.03.2018 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 891/1 datë 16.07.2018. Në pikën nr. 2 të VKB citohet fakti objekt për dhënien me qira janë dhe ngastrat nr. 2c, 4b,4c, 41b,56b,96c, Mnelë dhe ngastra nr. 30 Vig tokë bujqësore me sipërfaqe prej 6.22 ha për ndërtimin e Hec Gjadër nga shoqëria "S.P.E. Gj. Sh.p.k. për të cilën Bashkia Vau Dejës nuk ka lidhur kontratë me subjektin S.P.E. Gjadër Sh.p.k, në kundërshtim me VKB nr.44, datë 21.03.2018 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 891/1 datë 16.07.2018.

Së dyti:- Nga shqyrtimi i kontratë qiraje nr. 6255 prot, datë 18.09.2018 nënshkruar nga përfaqësuesi me autorizim Zv/Kryetari i Bashkisë Vau Dejës z. A.H.dhe qiramarrësi shoqëria "SPE Gjadër "

shpk me nr. 265 prot, datë 18.09.2018, përfaqësuar nga administratori z. V. K. Rezulton se periudha 19.09.2019 – 31.12.2021, ose 2 vite e 2 muaj është e pa mbuluar me kontratë qiraje dhe për pasojë ndaj subjektit nuk është lidhur kontratë qiraje, për të cilën mbanë përgjegjësi z. Z. U., me detyrë Përgjegjës i Menaxhimit të Pyjeve Bashkia Vau Dejës, pasi prej tij duhet të ishin marrë masat e nevojshme që subjekti mos të përdorte sipërfaqen pyjor/kullosor pa kontratë qiraje dhe nuk duhet të ishte mjaftuar vetëm me njoftimin e subjektit S.P.E. Gj. Sh.p.k.

Sa më sipër kemi:

(**1,554,025** lekë * 2 vite në vlerë 3,108,050 + 2 muaj në vlerë 259,004) = 3,367,054 lekë.

-Gjithsej diferencë e krijuar **3,367,054 lekë**, të cilat përbëjnë ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës.

Së treti Referuar korrespondencës të zhvilluar midis Bashkisë Vau Dejës dhe shoqëria "SPE Gj." shpk ku në përgjigje të shkresës nr. 1695/1 datë 02.04.2019 të dërguar nga bashkia subjekti "SPE Gj." shpk me shkresën nr. 296 prot datë 05.04.2019, protokolluar në bashki me shkresën nr. 1851 prot datë 09.05.2019 i ka vendosur në dispozicion "Hartën me parcelat pyjore dhe gjurmët e rrugëve ndihmëse si dhe tabelën e detajuar me parcelat dhe gjatësinë e rrugëve. Në vijim të korrespondencës së sipërcituar është nënshkruar Aneksi i Kontratës së qirasë nr.6894 prot, datë 06.12.2021 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Vau Dejës z. M. B. dhe qiramarrësi shoqëria "SPE Gj." shpk me nr. 435 prot, datë 26.11.2021, përfaqësuar nga administratori z. V. K.

Afati i kontratës : 06.12.2021-05.12.2022 (1 vite).

-Vlera e kontratës është 322,260 lekë, vlerë e cila është likuiduar sipas faturës të datë 29.12.2021.

Përlllogaritjet e Bashkisë Vau Dejës sipas raportit teknik:

Përdorim Rruge

Trungishte 3.618 km * 70,000 lekë = 253,260 lekë

Cungishte 0.409 km * 50,000 lekë = 19,555 lekë

Inkuktive 0.409 km * 25,000 lekë = 10,225 lekë

Tok me bimësi pyjore djerr 1.294 km * 30,000 lekë = 38,820 lekë

Total qira = **322,260 lekë qira për sipërfaqe të dhënë në përdorim.**

Rezulton se periudha 05.04.2019 – 06.12.2021, ose 2 vite e 8 muaj është e pa mbuluar me kontratë qiraje dhe për pasojë ndaj subjektit nuk është lidhur kontratë qiraje, për të cilën mbanë përgjegjësi z. Z. U., me detyrë Përgjegjës i Menaxhimit të Pyjeve Bashkia Vau Dejës, pasi prej tij duhet të ishin marrë masat e nevojshme që subjekti mos të përdorte sipërfaqen pyjor/kullosor pa kontratë qiraje dhe nuk duhet të ishte mjaftuar vetëm me njoftimin e subjektit S.P.E. Gj. Sh.p.k.

Sa më sipër kemi:

(**322,260** lekë * 2 vite në vlerë 644,520 + 8 muaj në vlerë 214,840) = 859,360 lekë.

-Gjithsej diferencë e krijuar **859,360 lekë**, të cilat përbëjnë ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës.

Së katërti Aneksi i Kontratës së qirasë nr.6894 prot, datë 06.12.2021 nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Vau Dejës z. M. B. dhe qiramarrësi shoqëria "SPE Gj." shpk me nr. 435 prot, datë 26.11.2021, përfaqësuar nga administratori z. V. K. i është referuar VKB nr.44, datë 21.03.2018 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 891/1 datë 16.07.2018. Nga analiza e aneksit të kontratës së qirasë rezulton se objekt i kësaj kontrate janë dhe ngastrat nr. 20, 22, 24 33,a 35, të cilat nuk janë miratuar nga Këshilli bashkiak për dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjor e kullosor.

Së pesti Referuar korrespondencës të zhvilluar midis Bashkisë Vau Dejës dhe shoqëria "SPE Gj." shpk ku në përgjigje të shkresës nr. 1695/1 datë 02.04.2019 të dërguar nga bashkia subjekti "SPE

Gj." shpk me shkresën nr. 296 prot datë 05.04.2019, protokolluar në bashki me shkresën nr. 1851 prot datë 09.05.2019 i ka vendosur në dispozicion “Hartën me parcelat pyjore dhe gjurmët e rrugëve ndihmëse si dhe tabelën e detajuar me parcelat dhe gjatësinë e rrugëve ndihmëse për ndërtimin e linjës 110 kv të “HIDROCENTRALEVE NË LUMIN GJADËR” nuk është lidhur kontratë për dhënien me qira të ngastra nr. 30 Vig tokë bujqësore me sipërfaqe prej 5.832 ha për ndërtimin e Hec Gjadër nga shoqëria “S.P.E. në kundërshtim me VKB nr.44, datë 21.03.2018 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 891/1 datë 16.07.2018. Në mënyrë të detajuar sipërfaqja për të cilën nuk është lidhur kontratë nga bashkia sipas kontratës aneks paraqitet në formë tabelle si vijon;

Ekonomia pyjore	Parcela	Emertimi i punimeve	Gjatësia	Gjerësia	Sip.(m2)	Sip/parcelë(ha)	Gjatesia lineare (km)	Fondi Pyjor km
			(ml)	(m)				
"VIG"	30	Rruges ndihmese nr. 1	313	4	1,252	0.125	0.313	Bujq.
		Rruges ndihmese nr. 2	80	4	320	0.032	0.080	Bujq.
		Rruges ndihmese nr. 3	60	4	240	0.024	0.060	Bujq.
		Rruges ndihmese nr. 4	35	4	140	0.014	0.035	Bujq.
		Rruges ndihmese nr. 5	45	4	180	0.018	0.045	Bujq.
		Rruges ndihmese nr. 6	113	4	452	0.045	0.113	Bujq.
	97b	Rruges ndihmese nr. 6	215	4	860	0.086	0.215	Bujq.
	96c	Rruges ndihmese nr. 6	67	4	268	0.027	0.067	Bujq.
	75	Rruges ndihmese nr. 7	128	4	512	0.051	0.128	Bujq.
	56b	Rruges ndihmese nr. 14	50	4	200	0.020	0.050	Bujq.
	41b	Rruges ndihmese nr. 16	260	4	1,040	0.104	0.260	Bujq.
	19a	Rruges ndihmese nr. 18	92	4	368	0.037	0.092	Bujq.
Shuma			1,458	48	5,832	0.5832	1.458	0

Burimi Bashkia Vau Dejës.

Sa më sipër veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenet 154, 296 801 e vijues të Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010.

-Mbështetur në kuadrin rregullator të cituar në krye të herës, detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendshme të Bashkisë Vau Dejës, hartimin dhe miratimin e raporteve teknike, llojin e mangësive të identifikuar si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve, ngarkohen me përgjegjësi: z. M. S. me detyrë Specialist Menaxhimi në Sektorin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave; z. Z.U. me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave; z. Rr. F. me detyrë Drejtor Drejtorie në Drejtorin e Zhvillimit Rural, Turizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit; . z. J.P. me detyrë Përgjegjës Sektori i Bujqësisë , Ujitjes dhe Kullimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit.

Kriteri:

Nenet 83, 154, 296, 663 dhe 678 në Ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Neni 35 në Ligjin nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Pika 11 në nenin 2 në Kreun I në Ligjin nr.8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010;

Ndikimi/efekti: Të ardhura të munguara në vlerën **4,262,414** lekë.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës të analizojë sitatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës **4,262,414** lekë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës të analizojë sitatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa për lidhjen e kontratës me shoqëria “S.P.E. Gj. Sh.p.k për ngastrat nr. 2c, 4b,4c, 41b,56b,96c, Mnelë dhe ngastra nr. 30 Vig tokë bujqësore me sipërfaqe prej 6.22 ha për të cilën Bashkia Vau Dejës nuk ka lidhur kontratë sipas VKB nr.44, datë 21.03.2018.

Për sa është trajtuar në Projektraport, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 39. datë 05.01.2022, nga z. Z. U. me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave ,z. J.P. me detyrë Përgjegjës Sektori i Bujqësisë , Ujitjes dhe Kullimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit dhe z. M.S. me detyrë Specialist Menaxhimi në Sektorin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, protokolluar në KLSH me nr.1021/2 datë 16.01.2023, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Observacion nga Subjekti i audituar: Sektori i Menaxhimit të pyjeve dhe Kullotave, bazuar në shkresën nr. 7229 prot, datë 23.12.2022, lidhur me konstatimet e lëna nga KLSH për periudhën e kontrollit për vitin 2021 sqaron faktin se:

1.Kontrata e qirasë nr.6255 prot datë 18.09.2018 nënshkruar nga përfaqësuesi me autorizim z/v.kryetari i Bashkisë Vau Dejës z.A.H. dhe qiramarrësi shoqëria SPE Gj. përfaqësuar nga administratori z. V. K. sipas V KB 44 dt 21 .06.2018 për dhënie në përdorim të fondit pyjor /kullor për ndërtim hec Gjadër nga subjekti SPE Gj.shpk me afat I vit konfirmuar nga prefekti me shkresën nr. 891/1datë 16.07.2018 u konstatuan:

2.Tarifat e aplikuara nga grupi i punës janë në kundërshtim me V KM nr. 391,datë 21.06.2006 për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave i ndryshuar me vkm 1064 22.12.2010,si dhe afatin e dhënies në përdorim përcaktuar me vkb 44 datë 21 .03 2018.

Përsa i përket këtij konstatimi sqarojmë se grupi i punës ka vepruar sipas V KM nr. 391,datë 21.06.2006 për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave i ndryshuar me vkm 1064 datë 22.12.2010 me përjashtim të pikës 15 ndërtim linjë të tensionit të lartë ku zëri inproduktive nuk është në këtë vendim dhe është tarifuar sipas pikës 1 5/3 shkurre pasi nuk përbën fitim të munguar.

3.Ngastrat 2c,4b,4c,41b,56b,96c në ekonominë pyjore Gjadër Mnelë dhe 30 në ekonominë pyjore vig për të cilat nuk është lidhur kontratë nuk janë në administrim të sektorit të pyjeve, lidhur harta. Nga verifikimi i bërë nga sektori i bujqësisë sipas librit të ngastrave parcel me nr. 30 nuk rezulton të jetë në fondin e tokës bujqësore të fshatit Vig, Njësia Administrative Vig - Mnel. Dhe si e tillë nuk ka qenë subjekt i ligjit 7501. Si rezultat nuk është ndarë nga ana e komisionit të ndarjes së tokës. Lidhur libri i ngastrave.

4.Për Periudhën 19.09.20 19-31. 12.2021 e Cila është e pa mbuluar me kontratë sqarojmë:

Kontrata e qirasë është lidhur për një vit sipas kërkesës së subjektit dhe me përfundimin e afatit nga ana jonë është kërkuar rinovimi i kontratës sipas shkresës nr. 4783 prot datë 28.08.2019, shkresës nr. 4390 prot 24.07.2020 është njoftuar Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit pranë bashkisë ku është mbajtur akti i konstatimit nr. 72/6 dhe njoftimi për subjektin SPE Gjadër nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit nr. 72/2.

5.Aneksi i kontratës së qirasë nr. 6894 prot datë 06. 12.2021 nënshkruar nga përfaqësuesi i bashkisë Vau Dejes z. M. B. dhe qiramarrësi shoqëria SPE Gjadër përfaqësuar nga administratori z. V. K. sipas VKB 44 datë 21 .06.2018 konfirmuar nga prefekti me shkresën nr. 891/1datë 16.07.2018 ku konstatohen se ngastrat nr. 20,22,24,33a,35 nuk janë miratuar nga këshilli bashkiak sqarojmë:

Ngastra nr. 24 është e miratuar në parim me vendim të këshillit bashkiak nr. 03.datë 26.01.2021 e për ngastrat e tjera nuk ishte përcaktuar pozicioni ku do të kalojnë rrugët ndihmëse pasi ishte proces që do kryhej më vonë.

Pas paraqitjes së kërkesës nr. 296 prot datë 05.04.2019 nga subjekti për lidhje kontrate për rrugët ndihmëse është konstatuar mungesë dokumentacioni ku i është kërkuar për plotësim dokumentacioni nëpërmjet shkresës nr. 4390 datë 24.07.2020, dhe pas dërgimit të dokumentacionit të kërkuar është lidhur aneks kontrata si pjesë e kontratës një vjeçare nr.6255 prot. datë 18.09.2018, duke vazhduar ti kërkojmë rinovimin e plotë të kontratës për periudhën e munguar dhe në vazhdim por nga ana e palës qiramarrëse pretendohet se nuk është e nevojshme rinovimi i kontratës pasi nuk ju nevojitet më përdorimi i territorit nëpërmjet shkresës nr. 296 prot datë 05.04.2019. Lidhur shkresat.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sa me sipër observacionet e paraqitura nga ana juaj nuk do të merren në konsideratë pasi:

Së pari referuar VKB nr.44, datë 21.03.2018 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 891/1 datë 16.07.2018. Në pikën nr. 2 të VKB citohet fakti objekt për dhënien me qira janë dhe ngastrat nr. 2c, 4b,4c, 41b,56b,96c, Mnelë dhe ngastra nr. 30 Vig tokë bujqësore me sipërfaqe prej 6.22 ha për ndërtimin e Hec Gjadër nga shoqëria “S.P.E. Gj. Sh.p.k.

Së dyti Referuar korrespondencës të zhvilluar midis Bashkisë Vau Dejës dhe shoqëria "SPE Gj." shpk ku në përgjigje të shkresës nr. 1695/1 datë 02.04.2019 të dërguar nga bashkia subjekti "SPE Gjadër" shpk me shkresën nr. 296 prot datë 05.04.2019, protokolluar në bashki me shkresën nr. 1851 prot datë 09.05.2019 i ka vendosur në dispozicion “Hartën me parcelat pyjore dhe gjurmët e rrugëve ndihmëse si dhe tabelën e detajuar me parcelat dhe gjatësinë e rrugëve. ndihmëse për ndërtimin e linjës 110 kv të “HIDROCENTRALEVE NË LUMIN GJADËR” nuk është lidhur kontratë për dhënien me qira të ngastra nr. 30 Vig tokë bujqësore me sipërfaqe prej 5.832 ha për ndërtimin e Hec Gjadër nga shoqëria “S.P.E.

Së treti këshilli bashkiak nuk është shprehur për lidhjen e kontratave me ngastrat nr. 20, 22, 24 33,a 35, të sipërfaqes pyjor e kullosor.

➤ **Subjektet që ushtrojnë aktivitetet në Fond Pyjor dhe kullorosor të cilët janë pajisur me leje minerare.**

Titulli i gjetjes: Bashkia Vau Dejës nuk ka vepruar, për të lidhur kontratë qiraje me subjektet private të cilat janë pajisur me leje minerare (**për aktivitetet shfrytëzim Bakri, Kromi etj..**) dhe leje koncesionare të miratuara nga Ministria e Energjetikës dhe Industrisë si dhe nga Ministria e Mjedisit, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullorosore ku ushtrojnë aktivitetin e tyre për qëllime biznesi.

Situata: Nga të dhënat e siguruar nga grupi i auditimit për subjekte të pajisura me leje minerare sipas regjistrimit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, si dhe sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Vau Dejës sipas korrespondencës me AKBN, rezulton se përgjatë periudhës deri me 31.12.2021, në territorin e Bashkisë Vau Dejës, kanë ushtuar aktivitetet në sektorin e kërkimit, zbulimit, prodhimit të minerareve 5 subjekte me sipërfaqe 2.6398 Km², për të cilat SMP Bashkia Vau Dejës nuk administron dosje të tyre (raporti teknik, kontratë qiraje, etj), sipas tabelës vijuese Veprime dhe mosveprime bien në kundërshtim me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin kullorosor”, pikat 3, 7, 9,10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10.2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullorosor”

Nr.	Nr. Leje	Datë	Emri i subjektit	Nipt	Emertimi i vendburimit	Lloji i Mineralit	S=km ²
447	1800	10.05.2016	A.- B.07 shpk	K.....J	Objekti Kosmaçi, Shkodër	Zhure	0.041
159	1040/3	16.07.2007	A. T. shpk	J.....C	Stakaj	Zhavorre të vjetra	0.257
179	1139/1	28.01.2008	S. shpk	K....D	Talle	Krom	0.0098
208	1248/1	13.10.2008	S. G.shpk	K.....V	Fshat i Ri	Gur Gëlqeror	2.281
123	897/1	08.08.2005	XH. shpk	J.....O	Karme	Shiste argjilore	0.051
							2.6398

Burimi: Faqe zyrtare e AKBN

Kriteri: Nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, pika 6 e nenit 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin kullorosor”, pikat 3, 7, 9,10,11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, i ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2015, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10.2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullorosor”.

Impakti: Nuk jep siguri të mjaftueshme për përmbushjen dhe zbatimin e ligjit për funksionin dhe detyrat që ka.

Shkaku: Nga neglizhenca dhe nga mos këmbëngulja në zbatimin e ligjit, për mos mbledhjen dhe arkëtimin e kësaj tarife.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtorisë së shërbimit Pyjor t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kulloror këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorore të mbetura.

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme

Për sa është trajtuar në Projektraport, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 39. datë 05.01.2022, nga z. Zeqir Ujka me detyrë Përgjegjës në Sektorin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, z. J. P. me detyrë Përgjegjës Sektori i Bujqësisë, Ujitjes dhe Kullimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe z. M. S. me detyrë Specialist Menaxhimi në Sektorin e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave, protokolluar në KLSH me nr.1021/2 datë 16.01.2023, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Observacion nga Subjekti i audituar: Sektori i Menaxhimit të pyjeve dhe Kullotave, bazuar në shkresën nr. 7229 prot, datë 23.12.2022, lidhur me konstatimet e lëna nga KLSH për periudhën e kontrollit për vitin 2021 sqaron faktin se:

1.Kontrata e qirasë nr.6255 prot datë 18.09.2018 nënshkruar nga përfaqësuesi me autorizim z/v.kryetari i Bashkisë Vau Dejës z.A. H.dhe qiramarrësi shoqëria SPE Gj. përfaqësuar nga administratori z. V. K. sipas V KB 44 datë 21 .06.2018 për dhënien në përdorim të fondit pyjor /kulloror për ndërtim hec Gjadër nga subjekti SPE Gj. shpk me afat I vit konfirmuar nga prefekti me shkresën nr. 891/1datë 16.07.2018 u konstatuan:

2.Tarifat e aplikuara nga grupi i punës janë në kundërshtim me V KM nr. 391,datë 21.06.2006 për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave i ndryshuar me VKM 1064 22.12.2010,si dhe afatin e dhënies në përdorim përcaktuar me VKB 44 datë 21 .03 2018.

Përsa i përket këtij konstatimi sqarojmë se grupi i punës ka vepruar sipas V KM nr. 391,datë 21.06.2006 për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave i ndryshuar me VKM 1064 datë 22.12.2010 me përjashtim të pikës 15 ndërtim linjë të tensionit të lartë ku zëri inproduktive nuk është në këtë vendim dhe është tarifuar sipas pikës 1 5/3 shkurre pasi nuk përbën fitim të munguar.

3.Ngastrat 2c,4b,4c,41b,56b,96c në ekonominë pyjore Gjadër Mnelë dhe 30 në ekonominë pyjore vig për të cilat nuk është lidhur kontratë nuk janë në administrim të sektorit të pyjeve, lidhur harta. Nga verifikimi i bërë nga sektori i bujqësisë sipas librit të ngastrave parcel me nr. 30 nuk rezulton të jetë në fondin e tokës bujqësore të fshatit Vig, Njësia Administrative Vig - Mnel. Dhe si e tillë nuk ka qenë subjekt i ligjit 7501. Si rezultat nuk është ndarë nga ana e komisionit të ndarjes së tokës. Lidhur libri i ngastrave.

4.Për Periudhën 19.09.20 19-31. 12.2021 e Cila është e pa mbuluar me kontratë sqarojmë:

Kontrata e qirasë është lidhur për një vit sipas kërkesës së subjektit dhe me përfundimin e afatit nga ana jonë është kërkuar rinovimi i kontratës sipas shkresës nr. 4783 prot datë 28.08.2019, shkresës nr. 4390 prot 24.07.2020 është njoftuar Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë bashkisë ku është mbajtur akti i konstatimit nr. 72/6 dhe njoftimi për subjektin SPE Gjadër nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit nr. 72/2.

5.Aneksi i kontratës së qirasë nr. 6894 prot datë 06. 12.2021 nënshkruar nga përfaqësuesi i bashkisë Vau Dejes z. M. B.dhe qiramarrësi shoqëria SPE Gjadër përfaqësuar nga administratori z. V. K.sipas V KB 44 datë 21 .06.201 8 konfirmuar nga prefekti me shkresën nr. 891/1datë 16.07.2018 ku konstatohen se ngastrat nr. 20,22,24,33a,35 nuk janë miratuar nga këshilli bashkiak sqarojmë:

Ngastra nr. 24 është e miratuar në parim me vendim të këshillit bashkiak nr. 03.datë 26.01.2021 e për ngastrat e tjera nuk ishte përcaktuar pozicioni ku do të kalojnë rrugët ndihmëse pasi ishte proces që do kryhej më vonë.

Pas paraqitjes së kërkesës nr. 296 prot datë 05.04.2019 nga subjekti për lidhje kontrate për rrugët ndihmëse është konstatuar mungesë dokumentacioni ku i është kërkuar për plotësim dokumentacioni nëpërmjet shkresës nr. 4390 datë 24.07.2020, dhe pas dërgimit të dokumentacionit të kërkuar është lidhur aneks kontrata si pjesë e kontratës një vjeçare nr.6255 prot. datë 18.09.2018, duke vazhduar ti kërkojmë rinovimin e plotë të kontratës për periudhën e munguar dhe në vazhdim por nga ana e palës qiramarrëse pretendohet se nuk është e nevojshme rinovimi i kontratës pasi nuk ju nevojitet më përdorimi i territorit nëpërmjet shkresës nr. 296 prot datë 05.04.2019. Lidhur shkresat.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Sa më sipër observacionet e paraqitura nga ana juaj do të merren në konsideratë dhe do të reflektohen në Projekt raportin e Auditimit si dhe në raportin përfundimtar të auditimit.

3. Vlerësimi Raportimit Financiar për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2021 japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë.

Për vitin 2021, Në përputhje me kërkesat e UMF nr. 8 datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Shkodër me shkresën Nr. 1641 prot., datë 30.03.2022, të përbëra si vijon:

Format nr. 1 –Pasqyra e pozicionit financiar.

Format nr. 2 –Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

Format nr. 3 – Pasqyra e flukseve monetare (Caush-Flou).

Format nr. 4 –Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

Format nr. 5 –Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.

Format nr. 6 –Investimet dhe burimet e financimit.

Format nr. 7/a –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (kosto historike).

Format nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (vlera neto).

Format nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave. (*Bashkëngjitur Pasqyra Nr. 1 e Pozicionit Financiar bilanci i v. 2021*)

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

• Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:

Për vitin 2021 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Vau Dejës” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, VKM nr.248, datë 10.04.1998 pika 3, ndryshuar me VKM nr.25, datë 20.01.2001, UMF nr.26, datë 27.12.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në UMF nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore 2007, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe të njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj”, VKM Nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”. Lidhur me operacionet

buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Shkodër si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestime.

• **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2021 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrate banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve në kartelat e llogarive të librit të madh.

➤ ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

➤ ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti nuk është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në programe kompjuterike “Alfa”.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike nuk janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, magazinës, të pagave etj si dhe janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitorë. Përsa i përket sistemeve janë evidentuar në kartelat kontabël të llogarive përkatëse dhe artikujve kontabël të prerë për veprime të ndryshme janë evidentuar në librin e veprimeve të ndryshme. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

-Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu : Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësive, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

➤ ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiarë të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2021 deri më datën 31.12.2021.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të reregjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar, përveç rastit të kontratave të investimeve në vlerë të plotë dhe vlerës së faturave të palikujduara për investime në fund të vitit ushtrimor 2021.

Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet nuk janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël, përveç disa rasteve të shpenzimeve të kryera për investime, të cilat nuk janë regjistruar në momentin e çeljes së fondeve dhe mbërritjes së faturës.

Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet nuk janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë regjistruar, ndërsa detyrimet nuk janë regjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, pra nuk janë të paraqitura të plota në bilanc.

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitet, pasivitet dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare nuk janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të deri diku të përshtatshme dhe të përshkruara, ndërsa mungojnë shënimet që të shprehin paqartësitë e ndodhura

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë, por jo në sasinë e duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria Ekonomike. **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2021, rakordon me tepricat në mbyllje të vitit 2020.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2021 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Totali i Aktivit për vitin 2021 është 4,570,170,802 lekë dhe për vitin 2020 është 4,475,363,374 lekë, i paraqitur në aneksin nr. 1 pika 3 dhe i zërthyer në llogari si më poshtë:

A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

Rakordimi i llogarive me Degën e Thesarit llogaria 520, 466 dhe llogaritë e të Ardhurave. V, 2021

Llogaritë kryesore të rakordueshme me degën e Thesarit; llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”, në pasqyrat financiare është për vlerën për vlerën **216,585,008 lekë**. Referuar aktit të rakordimit me Degën e Thesarit Shkodër kjo llogari është për vlerën **216,585,008 lekë**. Konstatohet se “Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor e pasqyruar në formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte” të paraqitur është e rakorduar me shumën e “Mjeteve monetare dhe ekujvalente të tyre” në vlerën 217,559,358 lekë e rakorduar me pasqyruar në formatin nr. 1. “Mjete monetare dhe ekujvalent të tyre”

Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor e pasqyruar në formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte”. është si vijon:

Nr. Reshti	Nr Rubrike	PËRMBAJTJA	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi parardhës
(a)	(b)	(c)	(1)	(2)
1	I	VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT	75,589,228	73,148,293
2	1	Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime korrente (+)	312,241,524	305,433,093
3	2	Arketime e te hyra (Cash), gjate vitit ushtrimor	438,842,903	423,224,660
4		Te Hyra nga Tatimet e Doganat tatimore e Doganore(+)		
5		Te hyra nga Kontributet e Sig. shoq. e shendets(+)		
6		Te hyra nga ardhurat jotatimore (+)	90,939,410	85,427,465
7		Te hyra, Sponsorizime nga te trete,(+)		
8		Te hyra, nga kredi e huamarrje afatshkurter(+)		
9		Te hyra nga Mjetet ne ruajtje(+)	5,685,077	11,086,960
10		Te tjera, arketuar(+)		

10.1		Te tjera, arketuar(+) buxhet Min.00	340,417,416	324,793,235
10.2		Te tjera, arketuar(+) te hyra letra me vlere	1,801,000	1,917,000
11	3	Pagesa per Detyrime e Shpenzime korrente	675,495,199	655,509,460
12		Per detyrime e Shpenzime nga vitet e kaluara(-)		
13		Per detyrime e Shpenzime te vitit ushtrimor(-)	668,426,716	641,530,704
14		Pagesat per mjetet ne ruajtje(-)	-4,810,083	-12,415,256
15		Interesi I paguar(-)		
16		Tatime te paguara(-)		
17		Te tjera te paguara (-) Letra me vlere	-2,258,400	-1,563,500
18	II	VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE	-45,808,345	-63,871,490
19		Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime Kapitale (+)	38,707,462	145,975,265
20		Te hyra nga Kredi dhe e huamarrje afatgjata(+)		
21		Te hyra nga shitja e Aktiveve Afatgjata (+)		
22		Te hyra nga interesat e huadhenies dhe nenhuadhenies(+)		
23		Pagesa per detyrime e Investime nga vitet e kaluara(-)	-24,500,000	
24		Per detyrime e Investime te vitit ushtrimor(-)	-60,015,807	209,846,755
25		Huadhenie e Nenhuadhenie(-)		
26		Pjesemarrje ne kapitalin e vet(-)		
27		Dividente te paguar(-)		
28	III	TRANSFERTA TE TJERA	-2,431,579	-4,406,820
29		Derdhje e Transferime te te Ardhurave ne Buxhet(-)		
30		Transferime ne buxhet te Fondeve te paperdorura(-)	-2,431,579	-4,406,820
31		Levizje e brendshme e transferata te tjera(++)		
32	IV	Rritja /Renia neto e Mjeteve monetare	27,349,304	4,869,983
33	V	Teprica ne fillim te vitit ushtrimor	190,210,054	185,340,071
34	VI	Teprica ne fund te vitit ushtrimor	217,559,358	190,210,054

Në këtë rast, llogaria 520 “Disponilitete në Thesar” e rakorduar me të dhënat e Degës së Thesarit, 4në pasqyrat financiare, pasqyron saktë vlerën e saj në fund të vitit ushtrimor, sipas kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50.

2.Nënrubrika, gjendje e inventarit qarkullues, gjendja e llogarisë 31 “Materiale”, në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2010 paraqitet në vlerën 9,801,725 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 6,899,100 lekë. Vlerat e kësaj llogarie janë të barabarta me vlerën e dokumentuar në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës.

-Gjendja e llogarisë 32 “Inventar i imët” në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2020 paraqitet në vlerën 5,431,662 lekë, ndërsa në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2021 paraqitet në vlerën 5,872,050 lekë. Vlerat e kësaj llogarie janë të barabarta me vlerën e dokumentuar në aktin e rakordimit në fund të çdo viti të mbajtur midis magazinierit, përgjegjësit të financës dhe drejtorit të financës.

➤ **Titulli gjetjes:** Mbi kontabilizimin i gjobave të IMTV në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe llogarinë që kreditohet në pasqyrën e performancës financiare “7115 “Gjoha kamatvonesa,

sekuestrime dhe zhdëmtime” si dhe nuk janë pasqyruar debitorët e subjekteve private për mos pagimin e taksave dhe tarifave vendore në vlerën prej 196,638,412 lekë

Situata:

Llogaria **468 “Debitorë të ndryshëm”** për vitin 2021, paraqitet në vlerën **1,550,494** lekë e cila përfaqësojnë detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë.

Vlera **1,550,494** lekë janë detyrime përpara vitit 2015 të trashëguara nga ish komunat. i cili është detyrim i pa definuar, pa dokumentacionin përkatës për t`u paraqitur si detyrim ndaj furnitorëve për mallra shërbime dhe punime të kryera, i mbartur, të cilat konsistojnë me kontrata pa vlerë, pa faturë të thjeshtë tatimore apo faturë tatimore me TVSH apo dhe pa procedurë të mbyllur, *në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6.*

Sipas akt rakordimit të mbajtura midis “Sektorit të ardhurave dhe tarifave vendore” dhe “Sektorit të Financës” sipas shkresës nr. 660 prot., datë 11.02.2022, gjendja debitore e subjekteve taksapagues privat dhe familjar, janë në vlerën 195,912,670 lekë dhe për 36 kontrata në vlerën 725,742 lekë. Nga analiza e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” konstatohet se vlera 196,638,412 lekë nuk është kontabilizuar në llogarinë e sipërcituar çka ka sjell një nënvlerësim të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 196,638,412 lekë. *Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, aneksi 1, pika 3.3, ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 “Të ardhurat”, pika 8 e standartit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës.*

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë;

Ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Urdhri nr.64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 “Të ardhurat”, pika 8 e standartit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës. UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6.

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2021 i llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” për debitorët e subjekteve private dhe tarifave vendore në vlerën prej **196,638,412** lekë

Shkaku:

Mos zbatim i kuadrit të përgjithshëm të përgatitjes së pasqyrave financiare

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

-Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin e të Ardhurave të merren masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore në fund të vitit ushtrimor në vlerën **196,638,412 lekë** sipas evidencave të Drejtorisë të Ardhurave Vendore.

--Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë.

Titulli i Gjetjes :Mbi kontabilizimin e kontratave të investimit dhe njohjes së të drejtës për financimet e pritshme nga buxheti i shtetit për këto investime publike për vitin 2021.

Situata:

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor datë 31.12.2021)” në aktiv të pasqyrave financiare (Formati nr.1), paraqitet në vlerën 430,343 lekë pozicionimi i kësaj llogarie është bërë në mënyrë të gabuar. Pasi kjo llogari përbëhet nga detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2021 të cilat trashëgohen në vitin 2022, e cila në analizë përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën 39,766,988 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 14,719,865 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 947,426 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 4,379,413 lekë, llog. 436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 601,918 lekë, çka ka sjell një nënvlerësim të llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin” në vlerë 59,985,267 lekë, veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, neni 10 dhe 11, Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 32 e tij

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë: ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, neni 10 dhe 11, Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 32 e tij ku citohet:

“Të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre, ndërsa si të ardhura të njihen dhe evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e arkëtimit të tyre në llogarit financiare, duke mbajtur nën kontroll evidentimin e të ardhurave me baza rritëse (llogaria 7206 “Financim i pritshme nga buxheti”), të cilat evidentojnë të drejta të njëjste të qeverisjes së përgjithshme në marrëdhënie me shtetin (llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”), subjektit i lind e drejta e regjistrimit të pjesës së mbetur të kontratës në vitin përkatës, pasi i ka zbritur likuidimet e vitit, të regjistroj te drejtën në 4342 Operacione me shtetin me kundërparti të ardhurën 7206 “Financim i pritshme nga buxheti”.

Impakti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar, për sa i përket gjendjes kontabël të të drejtave që i lindin subjektit Bashkia Vau Dejës ndaj shtetit për angazhimet e ndërmarra me fondet nga buxheti i shtetit, të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2021 si dhe në Pasqyrën e Performancës Financiare.

Shkaku:

Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 6, neni 10 dhe 11; të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i shfuqizuar, ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Rëndësia:- E Lartë.

Rekomandime:

Nga Bashkia Vau Dejës, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshme nga buxheti” Veprimet e sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022.

4.Nënrubrika, të tjera aktive afatshkurtra, gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, më 31.12.2020 paraqitet në vlerën 44,578,186 lekë, kurse më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 3,342,860 lekë, të cilat përfaqësojnë detyrimet e prapambetura të pa likuiduara ndaj të tretëve. Nga analiza e kësaj llogarie rezulton se vlera debitorë e kësaj llogarie, është e kuadruar me shumën e llogarisë kreditore të pasivit të bilancit, respektivisht llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në shumën totale 44,578,186 lekë në përputhje të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kap. III, pika 42 dhe Aneksi –1, Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik. Në mënyrë analitike paraqitet në aneksin si vijon;

Fatura te palikujduara që i përkasin llogarisë (467) “kreditorë të ndryshëm”, viti 2020

Nr	Subjekti	Faturat e palikujduara në fund të vitit 2020	Vlera
1	M.- 1	NDERTIM I VENDEPOZITIMIT Bushat (FII)	3,870,553
3	L. B.	kërkesë padi nr. 115 dt 19.11.2015(L.B.)Vendim nr. 5324 dt 01.10.2014(GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES PARË Tirane),VENDIM NR, 1110(4781) DT 12/10/2018	1,230,000
4	Dh. P.	Vendim nr., 9723 rep 1731 kol 30.05.2013,DHIMITER PAPA	2,112,860
5	A.	rikonstruksion rruga Barbullush QENDER-DEDAJ-VARREZA-KARRAMETAJ-KELMEND-BARDHANJOR,FAT nr. 72666637, DT 19.08.2011	4,500,000
6	A.	ujësjellësi Vau Dejës, ft pjesor nr38259530 dt 30.09.2020	17,528,773
7	A.	ujësjellësi Vau Dejes, ft pjesor nr38259530 dt30.09.2020	15,336,000
	Totali		44,578,186

II. AKTIVET AFATGJATA

Në formatin nr. 1 “Aktivet Afatgjata” në vlerën neto paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,231,430,672 lekë.

Klasa 20 “ Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

- Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 61,220,902 lekë. sipas akt rakordimit me degën e thesarit Shkodër.

Konkluzion: Sipas të dhënave kontabël të paraqitura sipas kostos historike, dhe sipas inventarizimit fizik kjo llogari është e analizuar në 40 raste në vlerën 61,220,902 lekë, sipas inventarit kontabël. Në analizë të llog. 202 llogari “Studime dhe Kërkime” konstatohet se vlera e mbetur në fund të vitit 2021 prej 61,220,902 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për 40 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: “Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivitetit, si dhe vlerësimin e mëpasshëm:

a) Njohja fillestare - AAGJM-ja, duhet të plotësojnë kriteret e njohjes në pasqyrën e pozicioni financiar, pra, duhet të vlerësohen me kosto që janë:

- Kostoja e blerjes së bashku me taksat e importit;

- Kosto të tjera të drejtpërdrejta deri në sjelljen e aktivitetit në vendndodhje apo dhe kosto të tjera që i shtohen nga prodhimi i elementeve të aktivitetit (**kosto projektimi**, paga dhe kontribute për prodhimin e elementeve të aktivitetit, materiale të përdorura për këto elemente, kosto transporti, kosto instalimi, kosto testimi etj.).

Aktivet afatgjata jo materiale përcaktohen dhe klasifikohen të tilla si: programet kompjuterike, markat, patentat, licencat, të drejtat e përdoruesit etj. Mund të ketë aktive me karakteristika si të AAGJM-së ashtu edhe të AAGJ/JM-së. Në këto raste, ato klasifikohen në varësi të karakteristikave dominuese. Shembull, një program kompjuterik (soft) përfshihet në AAGJM, nëse është pjesë përbërëse e pajisjeve kompjuterike, në të kundërt (pra, kur nuk është pjesë), trajtohet si AAGJ/JM”

Kreu II. “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” **Pika 16/b. d** të cilat përcaktojnë: “Për regjistrimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit, ndiqet procedura e mëposhtme:

b) Për shpenzimet e njohura të investimeve bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

- Debitohet llogaria përkatëse e investimeve (të grupit 23); dhe

- Kreditohet llogaria përkatëse e detyrimeve (klasa 4).

d) Në rastin e kapitalizimit të aktiveve afatgjata, të përfituara nëpërmjet shpenzimeve të investimeve (të regjistruar sipas pikës “b” më sipër), bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

- Debitohet llogaria përkatëse e grupit 20 ose 21 të aktiveve afatgjata; dhe - Kreditohet llogaria përkatëse e investimeve (grupi 23).

Tiulli i gjetjes: Për vitin ushtrimore 2021 llogaria 202 “Studime dhe Kërkime” është mbivlerësuar në vlerën 61,220,902 lekë, për 41 projekt-studimeve nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme.

Situata:

- Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 61,220,902 lekë. sipas akt rakordimit me degën e thesarit Shkodër e analizuar sipas të dhënave kontabël në aneksin nr. 2 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Rezulton: Sipas të dhënave kontabël të paraqitura sipas koston historike, dhe sipas inventarizimit kontabël kjo llogari është e analizuar në 40 raste në vlerën 61,220,902 lekë Në analizë të llog. 202 llogari “Studime dhe Kërkime” konstatohet se vlera e mbetur në fund të vitit 2021 prej 61,220,902 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për 40 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë.

Kriteri

Përsa trajtuar më sipër, këto veprime janë në kundërshtim me **Udhëzim e MFE nr. 8**, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar **Aneksi 1** “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 2. Klasa 2**, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), me **VKM nr. 783**, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” **Pika 1/b** “Klasifikimi kontabël” e cila

ndër të tjera përcakton se: “Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimit - **Llogaria 202**” “Studime dhe Kërkime”.

Impakti:- Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata materiale dhe pozicionimit të pasaktë në llogari të shpenzimeve të studim-projektimit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku:

Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për saktësimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit në lidhje me procesin e kapitalizimit të aktiveve.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi

Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Vau Dejës të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e aktiveve afatgjata financiare në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2021

Situata:

Nga auditimi i pasqyrave financiare dërguar në degën e thesarit Shkodër me shkresën nr. 1641 prot., datë 30.03.2022 si dhe akt rikoridimet me degën e thesarit konstatohet se vlera e paraqitur në llogaritë e poshtëpërmendura është e njëjtë me vlerën e rakorduar me degën e thesarit. Nga analiza e llogarive konstatohet se:

-Llogaria **210 “Toka, Troje, Terrene”** në datën 31.12.2020, paraqitet në vlerën 6,208,378 lekë, në 31.12.2021 paraqitet po në vlerën 6,208,378 lekë e pa ndryshuar.

-Llogaria 211 “*Pyje kullota plantacione*” më 31.12.2020 paraqitet për vlerën kontabël historike 113,039,105 **lekë** dhe më 31.12.2021 paraqitet po në vlerën 113,039,105 lekë e pa ndryshuar.

-Llogaria **212 “Ndërtime e konstruksione”** më 31.12.2021, paraqitet në vlerën 1,787,556,508, lekë,

-Llogaria **213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”** më 31.12.2020, paraqitet në vlerën 2,082,261,462 lekë, më 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie rezulton 2,123,426,367 lekë, e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat gjatë periudhës raportuese.

-Llogaria . **214 “ Instalime teknike, makineri e pajisje ”**, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Vau Dejës dhe ish Komunat, në fund të vitit 2020 rezulton për vlerën 46,937,264 lekë dhe në fund të vitit 2021 për vlerën 52,920,775 lekë.

-Llogaria. **215 “Mjete transporti”**, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Vau Dejës dhe ish Komunat, në fund të vitit 2020 rezulton për vlerën 35,829,016 lekë dhe në fund të vitit 2021 për vlerën 42,732,433 lekë.

-Llogaria **218 “Inventar ekonomik”** e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Vau Dejës dhe ish Komunat, në fund të vitit 2020 rezulton për vlerën 105,773,478 lekë dhe në fund të vitit 2021 për vlerën 105,773,478 lekë e pa ndryshuar

Vlera e këtyre zërave në pasqyrën e pozicionit financiar 2021, është marrë bruto nga pasqyrat financiare. Nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka

informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Duke qenë se nuk ka një regjistër kontabël, nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur behet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet.

Sektori i financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar, të vitit 2021, Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata materiale" dhe pika 33.

Kapitulli II. Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Pika 6. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme mbajnë kontabilitetin e tyre mbështetur në dokumentet kontabël bazë dhe justifikues,

Pika 11. Përmbledhja e llogarive në klasa është mbështetur në analizën funksionale të veprimeve që ato përshkruajnë. Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik është paraqitur në aneksin 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi. Aneksi 1, "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik", Pika 2.Klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël). Nënpika 2.1 Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2, Paragrafi - Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata jo materiale".

Pika 33. Llogaritë përkatëse në klasën 2 funksionojnë si më poshtë vijon:

a) Për shtesat nga rivlerësimi:

Do të debitohen llogaritë e klasës 2 të aktiveve afatgjata; dhe

Do të kreditohet llogaria 109 "Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve"

Kriteri:

UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata materiale" dhe pika 33.

Impakti: Mungesa e regjistrimit të AAGJ si dhe mos pasqyrim i saktë i vlerës neto të aktiveve afatgjata materiale nga përlllogaritja e gabuar e amortizimit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të AAGJ, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Nga Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masat e nevojshme për inventarizimin e disa prej AAGJ e evidentimin e tyre me të gjitha të dhënat në regjistrin e aktiveve si dhe llogaritjen e pasaktë të amortizimit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Vau Dejës të marrë masa për kryerjen e inventarizimit të AAGJM, të krijojë dhe të mbajë regjistrin analitik aktiveve, ku të përmbajë të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vendodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Të kryejë veprimet për përlllogaritjen e saktë të amortizimit aktiv për aktiv sipas të dhënave regjistrit të aktiveve, duke aplikuar normat e amortizimit të miratuara me qëllim saktësimin e vlerës së mbetur të AAGJ dhe reflektimi i të gjithë ndryshimeve në kontabilitet nëpërmjet sistemimeve kontabël, duke pasqyruar saktë dhe realisht gjendjet e AAGJ në llogaritë përkatëse të klasës 20 dhe 21 në pasqyrat financiare.

- Testi substancial i amortizimit

Qëllimi: Ripërdorimi i amortizimit duke u bazuar në udhëzimin nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” për të parë diferencat ndërmjet amortizimit të ripërfunduar sipas udhëzimit dhe atij faktikut të gjendur në regjistrat e aktiveve përkatëse dhe në kontabilitet. Gjendja e aktiveve afatgjata në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet nga viti 2021 paraqiten në Formatin nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF në aneksin nr. 3 pika 3 bashkëlidhur project raportit të auditimit.

-Gjendja e llogarisë 230 “Aktive afatgjata jo materiale”, më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 398,800, e cila përfaqëson, vlerën e studimeve e projekteve për investimet në proces, të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimor dhe do të kenë financime të tjera deri në përfundimin e tyre kur ato të bëhen aktive dhe të kalojnë te llogaritë e klasës 2 “Aktive afat gjata materiale”.

- Gjendja e llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 41,466,223 lekë,

3.Nënrubrika, aktive afatgjata financiare, ku bëjnë pjesë referencat e llogarive 25 “Huadhënie e nën huadhënie” dhe 6 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, nuk janë kryer veprime të tilla, për rrjedhojë gjendja e tyre në pasqyrat e pozicionit financiar paraqitet me zero.

Titulli gjetjes: Mbi llogarinë 26 “Aktive afatgjata financiare”

Situata:

Llogaria 26 “Aktive afatgjata Financiare”, sipas pasqyrës financiare paraqitet me vlerë zero lekë për periudhën objekt auditimi. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Bashkia Vau Dejës, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31/12/2021 paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Vau Dejës SHA me NUIS “L...M” e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemimeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre”. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjisllacioni në fuqi”. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 350,812 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 350,812,349 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Vau Dejës në “Ujësjellës Kanalizime Vau Dejës SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2021, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në kundërshtim me Urdhrin e Ministrisë

nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”.

Kriteri:

Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Urdhri e MF nr. 64, datë 22.7.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara”, me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet afatgjata Materiale dhe Aktivet afatgjata Jo materiale”, pika 55,56 dhe 57.

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar mbi gjendjen kontabël të paraqitur në pasqyrat e pozicionit financiar viti 2021, të llog 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, gjendje kjo e nën vlerësuar me vlerë 350,812,349 lekë.

Shkaku:

Mos zbatim i kuadrit ligjorë në fuqi.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

-Bashkia Vau Dejës, nëpërmjet Nënpunësit Zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësjellës Kanalizime Vau Dejës Sh.a me vlerë 350,812,349 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

II. Rubrika, pasivet afat shkurtra.

1.Nënrubrika, llogari të pagueshme, gjendja e llogarive të 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, të 42 “Personeli e llogari të lidhura me to”, -të 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa”, të 435 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore”, të 436 “Detyrime ndaj shtetit për sigurime shoqërore”, nuk është e barabartë me gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin” në vlerën 60,415,610 lekë për vitin 2021. E analizuar për vitin 2021 për vlerën 60,415,610 **lekë përbëhet** dhe është e njëjtë me shumën e llogarive si vijon:

NR.	EMERTIMI	Gjendje 31.12.2021
1	Paga Personeli llogaria 42	14,719,865
2	Tatim page tatim ne burim llogaria 431	947,426
3	Sigurimet Shoqërore llogaria 435	4,379,413
4	Sigurime Shëndetësore llogaria 436	601,918
5	Furnitorëllogaria.401-408	39,766,988
	TOTALI	60,415,610

Rezulton diferencë midis vlerës pasqyruar në llogarinë **4342 “Operacione me shtetin, të drejta” dhe vlerës të pasqyruara pasive**, pra në vitin 2021 është, e njëjtë me vlerën e pasqyruar në aktivin e pasqyrave të pozicionit financiar.

Gjendja e llogarisë 42 “**Detyrime ndaj personelit**” në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 14,719,865 lekë e cila paraqet detyrimet për pagat e punonjësve për muajin dhjetor 2022.

-Gjendja e llogarisë 431 “**Detyrime ndaj shtetit tatim taksa**” në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 947,426 lekë detyrimet për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi për muajin dhjetor 2022.

-Gjendja e llogarisë 435 “**Sigurime shoqërore**” në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 4,379,413 lekë detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore për muajin dhjetor 2021.

-Gjendja e llogarisë 436 **“Sigurime shëndetësore”** në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 601,918 lekë detyrimet për kontributin e sigurimeve shëndetësore për muajin dhjetor 2022.

Krahasuar me listë pagesat e muajit dhjetor të vitit 2021 dhe me evidencën e shpenzimeve të muajit janar të vitit 2022, vlerat e llogarive 42, 431, 435, 436 rakordojnë dhe janë të njëjta me përmbledhësen e listë pagesave dhe evidencën e shpenzimeve.

Titulli gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

Situata:

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” më 31.12.2020, paraqitet në vlerën **39,862,041 lekë**, ndërsa më 31.12.2021 paraqitet në vlerën **40,737,035 lekë**. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: Drejtoria e Financës nuk disponon listën analitike për sa janë kontabilizuar në debi të llogarisë 466 “Kreditor për mjete në ruajtje” Mungesa e këtij afati, nuk jep mundësi për ndjekjen e grafikut të kthimit të garancisë për investimet e marra në dorëzim në mënyrë përfundimtare dhe evidentimin e investimeve të pa përfunduara ende, të cilat konsistojnë me kontrata pa vlerë, pa faturë të thjeshtë tatimore apo faturë tatimore me TVSH apo dhe pa procedurë të mbyllur. *Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshur, Kap. III, pikat 30, 50.*

Pika 30. “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konform kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet”,

Pika 50. “Tepriçat e llogarisë 520, "Disponibilitete në thesar" dhe të llogarisë 466, "Kreditorë për mjete në ruajtje" duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëngjitet llogarisë vjetore. Në akt rakordim, tepriçat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të paçelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grantit që trashëgohet)”,

UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

Pika 10. Në përfundim të periudhës së garancisë, investitori, kolaudatori, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve bëjnë kontrollin përfundimtar të veprës. Për defektet që nuk janë ndrequr gjatë periudhës së garancisë së punimeve të ndërtim-montimit, investitori llogarit koston e ndreqjes së tyre dhe bën ndalesën nga vlera e garancisë së punimeve.

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë: *UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap. III, pikat 30, 50.*

Ndikimi/Efekt:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2020 të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

Shkaku:

Mos zbatim i udhëzimit nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi:

-- Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të marrë masa për të bërë sistemimin e llogarisë 466 “*Kreditorë për mjete nën ruajtje*”, duke rakorduar drejtoritë njëra me tjetrën çdo muaj mbi balancat e llogarisë 466, si dhe duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Titulli gjetjes: *Mungesa e regjistrit analitik të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Vau Dejës*

Situata:

Rezultoni se në strukturën aktuale organizative të Bashkisë Vau Dejës është krijuar Sektori i Menaxhimit dhe Administrimit të Aseteve, nuk janë ngritur grupet e punës ku është përcaktuar në misionin dhe detyrat e saj administrimi i asetëve, si dhe struktura e ngarkuar për ndjekjen e tyre. *Nga auditimi sipas dokumentacionit që na u vu në dispozicion dhe deklaratime verbale të punonjësve dhe administratorëve të njësive administrative, konstatohet se:*

Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Vau Dejës dhe Njësive Administrative që përmbledh kjo bashki nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale. Dokumentacioni dhe të dhënat përkatëse në lidhje me asetet e Bashkisë janë vënë në dispozicion me shkresa zyrtare nga AITPP-ja, nëpërmjet VKM-ve përkatëse, si më poshtë:

Bashkinë Vau Dejës është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vau Dejës, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet VKM Nr. 1423, datë 10.10.2008 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Vau Dejës, të Qarkut të Shkodër” Lista përbëhet nga 128 (njëqind e njëzet e tetë) fletë fillon me nr. 1 dhe mbaron me nr. 924 (nëntëqind e njëzet e katër). Me VKM nr. 14 datë 20.01.2021 përbëhet nga 1 (një) fletë dhe përfundon me numrin rendor 1 (një).

Njësine Administrative Bushat është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të ish Komunës Bushat, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet VKM Nr. 68, datë 28.01.2008 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njësine Administrative Bushat, të Qarkut të Shkodër” Lista përbëhet nga 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) fletë fillon me nr. 1 dhe mbaron me nr. 516 (pesëqind e gjashtëmbëdhjetë) dhe me VKM nr. 246 datë 20.01.2021 e cila fillon me nr. 517 dhe mbaron me nr. 2312 (dymijë e treqind e dymbëdhjetë).

Njësine Administrative Hajmel është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Komunës Hajmel, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet VKM Nr. 566, datë 22.08.2012 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njësine Administrative Hajmel, të Qarkut të Shkodër”, përbëhet nga 65 (gjashtëdhjetë e pesë) fletë fillon me nr. 1 dhe mbaron me nr. 451 (katërqind e pesëdhjetë e një).

Njësine Administrative Vig Mnelë është miratuar lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bazë të VKM Nr. 10, datë 07.01.2005 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Njësine Administrative Vig Mnelë” përbëhet nga 74 (shtatëdhjetë e katër) fletë fillon me nr. 1 dhe mbaron me nr. 527 (pesëqind e njëzet e shtatë).

Njësine Administrative Temal është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim në bazë të VKM Nr. .409, date 08.04.2008 “ *Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Njësine Administrative Temal të Qarkut të Shkodër*”, fillon me nr. 1 dhe mbaron me nr. 417 (katërqind e shtatëmbëdhjetë). **Njësine Administrative Shllak** është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim në bazë të VKM Nr. .255, date 12.03.2009” *Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Njësine Administrative Shllak të Qarkut të Shkodër*”, përbëhet nga 56 (pesëdhjetë e gjashtë) fletë fillon me nr. 1 dhe mbaron me nr. 417 (katërqind e shtatëmbëdhjetë).

Përsa i përket pronave të Kaluara me VKM në Bashkinë Vau Dejës dhe Njësit Administrative (**Shllak, Temal, Vig Mnelë, Hajmel dhe Bushat**) për periudhën objekt auditimi (2018-30.09.2021) Sektori i Menaxhimit të Aseteve ka certifikuar në total 21 prona nga 5044 prona, Sektori i Menaxhimit të Aseteve nuk ka kryer veprime për regjistrimin e të gjitha pronave dhe pasqyrimin në inventar dhe kontabilitet; nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të asetëve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK) Shkodër; nuk ka rakordim me ZVRPP (ASHK) Shkodër, për asetet pronë e Komunës, pasi nuk është marrë në dorëzim harta treguese e objekteve pronë e Komunave; nuk ka të dhëna dhe rakordim për objektet e privatizuar dhe evidencë të pronarëve që nuk kanë shlyer troje; nuk kanë filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike dhe marrjen në dorëzim të asetëve, si dhe nuk është aplikuar në ASHK për regjistrimin e tyre. Mosveprimet e mësipërme janë në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 33-2012 “*Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme*”, dhe UMF-së nr. 30, datë **27.12.2011** “**Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik**”, kap. III, pika 30 ku citohet: “*Formati i regjistrimit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose të marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritjen të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.*” dhe pika 35/a ku citohet: “*Dokumentet vërtetues- vërtetojnë kryerjen në fakt dhe në mënyrë kronologjike, të veprimeve ekonomike. Të tilla janë fletëhyrjet, faturat, situacionet e shpenzimeve, fletëdaljet mandate arkëtimet, mandate pagesat, procesverbalet dhe të tjera akte me natyrë verifikues shpenzimi.*”

Për sa me sipër, ngarkohet me përgjegjësi:

I- z. N. B., në cilësinë e Përgjegjës të Sektorit të Aseteve.

Në mënyrë të përmbledhur pronat e kaluara me VKM dhe të regjistruara në ASHK paraqiten si më poshtë:

Nr.	Bashkia/ Njesite	Nr. Pronave në Inventar	Nr. i Praktikave të Certifikuara Deri Dhjetor 2017	Nr. Praktikave të Certifikuara 2020-2021	Prona të Rregjistruara
1	Bashkia V. Dejës	925	2	15	908
2	Nj Adm Bushat	2312	150	13	2149
3	Nj Adm Hajmel	451	1		450
4	Nj Ad Vig Mnele	527		3	524
5	Nj Adm Temal	412			412
6	Nj Adm Shllak	417			417
7	Totali	5044	153	21	4860

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë; ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, në mënyrë që kjo njësi vendore të mund të realizonte të ardhura nga vënia në funksion e këtyre aseteve, si dhe të VKM nr. 500, datë 14.08.2001“Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”.

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar.

Shkaku:

Mungesa e regjistrimit analitik të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrimi i tyre në pronësi të Bashkisë Vau Dejës.

Rëndësia: E lartë**Rekomandimi**

- Kryetari i Bashkisë, të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, regjistrimin e pronave në pronësi të vet si dhe për krijimin e regjistrimit të pronave, në zbatim të kërkesave të UMF.

Titulli gjetjes: *Mos kontabilizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale të cilat janë certifikuar në ASHK nga sektori i menaxhimit të aseteve në Bashkin Vau Dejës.*

Situata:

Nga auditimi rezultoi se, për periudhën objekt auditimi janë certifikuar në total 10 prona sipas tabelës së sipërcituar si dhe për vitin 2020 janë certifikuar 35 prona objekte inventari në ndërtesa e konstruksione të administruara llog.(212) pasuri e paluajtshme (*sasi e vlerë*) pjesa e konsiderueshme e tyre prej 4860 prona (*trajtuar analitikisht*) nuk janë të regjistruara në kontabilitet dhe pasqyrat financiare në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, pasi 153 objekte janë të trashëguara nga (*ish/komunat*).

Konstatohet se sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga sektori i aseteve, u konstatua se një pjesë e pronave janë regjistruar nga Bashkia Vau Dejës në Drejtorinë rajoneve të ASHK Vau Dejës, por pa vlerë. Kështu gjithsej janë regjistruar 45 prona por pa vlerë, gjë e cila vështirëson procesin e kontabilizimit në pasqyrat financiare si asetet të Bashkisë Vau Dejës. Për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur. Në mënyrë të detajuar pronat e certifikuar nga Bashkia Vau Dejës pasqyrohen në Aneksin nr. 4 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit. *Veprime dhe mosveprime e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16).*

Për sa me sipër, ngarkohet me përgjegjësi:

1- z. N. B., në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Aseteve.

2- z. A.N., në cilësinë e Drejtorit të Financës për periudhën 2021

Kriteri:

VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16).

Ndikimi/Efekti:

Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar.

Shkaku:

Mos rakordimi ndërmjet Sektorit të Financës dhe Sektorit të Menaxhimit të Aseteve në Bashkinë Vau Dejës.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi

- Sektori i Financës në cilësinë e Nënpunësit Zbatues, të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin 45 prona të certifikuara në ASHK Shkodër, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Vau Dejës sipas aneksit nr. 4 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Për sa është trajtuar në Projektraport, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 39, datë 05.01.2022, nga z N. B. me detyrë përgjegjës Sektori i Aseteve dhe z. A. F. me detyrë Specialist i Sektorit të Aseteve, protokolluar në KLSH me nr.1021/2 datë 16.01.2023, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Observacion nga Subjekti i audituar: Sektori i Aseteve pranë Bashkisë Vau Dejës, bazuar ne shkresën nr. 7231 prot, date 23.12.2022, "Akt Konstatimi nr. 6", pasi u njoh me konstatimet e lëna nga Grupi i Auditimit te KLSH-së, për periudhën e kontrollit viti 2021, ju sqarojmë si me poshtë: Për sa i takon dokumentacionit në lidhje me asetet e ish komunave, është vene ne dispozicion me shkresa zyrtare nga AITPP-ja, nëpërmjet VKM-ve përkatëse. Inventarizimi i pronave nga komunit është bere pas daljes se ligjit nr. 8744, date 22.01.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", dhe në atë kohe nuk janë bere harta treguese, por është bere thjesht me plan rievime, duke lëne të hapur mundësin e pajisjes me harta treguese, në momentin e certifikimit të këtyre pronave pas miratimit dhe transferimit me VKM-të përkatëse. Me urdhrin nr. 346, date 30.08.2022 të kryetarit të Bashkisë, është ngritur grupi i punës "Për evidentimin e të gjitha aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (AQT), sipas rekomandimit nr. I l. I B të KLSH", grup i cili ka filluar punën për këtë qellim, por ne kushtet kur grupi përbehet prej vetëm 3 vetash, me është dukur gati e pamundur te realizohet një volum të tille pune, prandaj kam kërkuar që të rishikohet urdhri i kryetarit që të behet një grup pune tjetër me 10-15 specialiste (jo me 3 specialiste siç është sot), të jenë të fushave të ndryshme, si financier, ing topografë, juristë etj, me qëllim finalizimin e këtij procesi në një afat sa me të shpejte. Sa i përket kontabilizimit në pasqyrat financiare, ne si sektor asetesh, jemi në kushte moskompetence për një gjë të tillë, prandaj mbetet në kompetencën e sektorit të financës pranë Bashkisë, për realizimin e këtij veprimi.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit: Lidhur me argumentin e z. N.B., në cilësinë e përgjegjës të zyrës së aseteve sqarojmë faktin se observacionet tuaja nuk merren në konsideratë pasi: Së pari është detyra juaj funksionale në bazë të rregullores së brendshme që ti propozoni titullarit grupin e punës për regjistrimin e aseteve në pronësi të Bashkisë Vau Dejës. Së dyti për pasurit e regjistruara është detyra juaj që në fund të çdo procesi të regjistrimit të njoftoni zyrtarisht zyrën e financës për regjistrim të aseteve të certifikuara. Ne të dy rastet e sipërcituar nuk na u paraqit ndonjë dokument ku të vërtetohet një procedurë e tillë.

Auditimi mbi inventarizimin e llogarive të Aktiveve Afatgjata Materiale; Jo materiale dhe Oarkulluese, sipas klasifikimit të tyre e mbajtjes së kartelave, raportimi i shtesave, apo përmirësimeve të kryera për gjatë periudhës raportuese në aktivin e duhur, për periudhën ushtrimore raportuese 2021

Titulli i Gjetjes: *Nuk janë marrë masat e nevojshme për mirë administrimin e të gjitha Aktiveve afatgjatë materiale dhe jo materiale. Konkretisht për llogaritë e Aktiveve me vlerat neto sipas të dhënave të Pasqyrave Financiare të vitit 2021.*

Situata:

Referuar kërkesave të dërguara nga grupi i auditimit rezulton se për vitin 2021 Bashkia Vau Dejës nuk ka kryer procesin e inventarizimit çka do të thotë që llogaritë analitike janë mbyllur sipas ditarit kontabël pa rakorduar me gjendjen fizike. Konstatohet se nga nëpunësi zbatues nuk janë marrë masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e s' kadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia si dhe nuk janë marrë masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot respektivisht; për llogaritë 32- "Inventar i imet", 202- "Studime dhe kërkime", 210- "Toka, Troje, Terrene", 211 – "Pyje, Plantacione" llog 212- "Ndërtesa e Konstruksione", 213- "Ruge, Rrjete dhe Vepra. Ujore", 214 – "Instalime teknike, makineri e pajisje", 215- "Mjete Transporti". *Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" të ndryshuar, Kreu II, neni 7, pika 2, neni 9, neni 10; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël", pjesa e parë, "Rregulla të përgjithshme" kapitulli i parë "Mbajtja e kontabilitetit"; UMF nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësisve që varen prej tyre", ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj"; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 2, neni 4, pika 9 "përgjegjshmëria menaxheriale", Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014, pika 36, pika 52, pika 73, pika 85.*

Përsa me sipër, ngarkohet me përgjegjësi:

1- z. A. N., në cilësinë e Drejtorit të Financës për periudhën 2021

Kriteri:

Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi janë;

-ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 - Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë; Kap. VII, neni 23, pika 14 –Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj , UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”. Kap III

Impakti

Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata materiale dhe pozicionimit të pasaktë të llogarive, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku

Nga Sektori i Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për saktësimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit në lidhje me procesin e kapitalizmit të aktiveve.

Rëndësia:- E Lartë.

Rekomandimi:

Kryetari i Bashkisë, të marrë masat që me specialistë të fushës, të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit.

B - Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime etj, për Bashkinë Vau Dejës).

Nr.	Emërtimi	Viti 2021			
		Plan 01.01.2021		Fakt 01.01.2021	
		31.12.2021		31.12.2021	
		P	F	P	F
1	Aparati 01110	139	126	174,520,230	97,609,963
2	Drejt e zhvillimit te buqesise 4240,4260	24	23	20,681,584	10,421,355
3	Drejtoria e Shërbimeve Sociale 10430	18	17	18,303,210	8,236,206
4	Pastrimi 5100	24	17	19,678,724	7,049,578
5	Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi 3280	20	16	14,878,834	11,034,300
6	Policia 3140	10	10	7,402,384	6,104,172
7	Drejtoria e Shërbimeve Komunitare, Utilitare 6260,4520	47	47	30,547,372	20,674,533
8	Drejtoria e Arsimit 9120, 9230	103	102	68,877,308	56,258,551
9	Qkb/Qkr 04130	2	2	1,376,000	949,780
10	Gjendja Civile 01170	6	6	4,026,000	3,692,820
11	KQZ shperblime per komisioneret e zgjedhjeve 1620			2,055,000	2,055,000

Tabela e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës

-Testimi i llogarisë 600 “Pagat dhe shpërblime”

Për vitin 2021 numri i punonjësve është miratuar me Vendim i Kryetarit të Bashkisë nr. 29 datë 12.10.2020, me VKB nr. 80, datë 24.12.2020 “Për miratimin e buxhetit 2021”. Miratuar në total numri 385+ 8 punonjësit të QKB dhe Gjendjes Civile = 393 punonjës gjithsej, në fakt janë paguar sipas listë pagesave gjithsej 366 punonjës, nuk ka tejkallim të numrit të punonjësve.

Urdhër nr.31,datë 14.12.2020 i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore” Për ngritjen e Konisionit të Ristrukturimit dhe Sistemimit të Nëpunësve/Punonjësve të Bashkisë Vau Dejës dhe Njësive Administrative në varësi në përputhje me strukturuarën e re Organizative dhe Raport nr. 324 Prot Vau Dejës, me 29.12.2020, i Komisionit të Ristrukturimit mbi Zhvillimin dhe Realizimin e Procedurës së Ristrukturimit dhe Sistemimit të Nëpunësve Civil në Administratën e Bashkisë Vau Dejës dhe Njësive Administrative në varësi, bazuar në Strukturën e re Organizative të vitit 2021. Listë pagesat janë të firmosura nga Përgjegjësi i Financës z. A.N. nga Kryetari i Bashkisë Vau Dejës z. M. B.

Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Përgjegjësi i Financës z. A. N.dhe nga Kryetari Bashkisë z. M. B.

Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Drejtori i Burimeve Njerëzore z. B. M. dhe nga Kryetari Bashkisë z. M. B.

B. 2 - Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2021

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Mars 2021,Prill 2021 dhe Shtator 2021) dhe konstatohet se ato plotësohen konform rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore të nënshkruara nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995,” Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Vau Dejës, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 "Për tatimin mbi të ardhurat", me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”.

Sipas listë pagesave të muajve Mars 2021, Prill 2021 dhe Shtator 2021, konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Përgjegjësi i Financës z. A.N. nga Specialistet e pagave.

Paraqitja në formë tabele e burimit të Financimit.

lekë

Periudha	Plan	Fakt	%	Burimi i financimit			
				Trans. e Pakush.	Të ardhura	Trans. e Kushtëzuar	Transferte specifike
Viti 2021	419,492,654	261,241,374	62%	165,363,606	3,873,992	7,445,722	84,558,054

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë lekë

Nr.	Emërtimi	VITI 2021		
		Plani	Fakti	%
1	F. Pagave	360,291,646	222,031,272	62%
2	F. Sig. Shoq	57,146,008	37,155,102	65%
3	F. Veçantë (Shperblim per komisioneret e zgjedhjeve)	2,055,000	2,055,000	100%

MALLRA DHE SHËRBIME (Ilogaria 602)

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesat, deklaramet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël. Në mënyrë të detajuar pagesa sipas llog. 602 janë sipas listës që disponon Drejtoria e Financës.

Titulli i gjetjes: *Bashkia Vau Dejës është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.*

Situata:

Për sa më poshtë në mbështetje të shkronjave (a) dhe (b) e nenit 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit”, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 1112/18 prot., datë 09.03.2022 i ka dërguar Bashkinë Vau Dejës Vendimin **nr. 39, datë 08.03.2022**, për përmirësimin e gjendjes, janë rekomandojmë zbatimin e masave të mëposhtme:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 19 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 3 masë organizative, në proces zbatimi 5 masa organizative dhe nuk janë zbatuar 11 masa organizative.

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 3 masa me vlerë 7,298,450 lekë, deri me datë 23.12.2022, është arkëtuar vlera 319,950 lekë është në proces vlera 658,500 lekë dhe nuk është zbatuar vlera 6,320,000 lekë.

c.2. Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të arkëtohet vlera 83,662,327 lekë. vlerë e cila nuk është zbatuar të cilat janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual me qëllim arkëtimin e vlerës në buxhetin e bashkisë.

*d.1. 1 Masë Administrative, 1 është rekomanduar **Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, ti kërkoj Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin Autoritetit*

Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) ndaj **8 punonjësve**, anëtarë të njësisë së prokurimit (hartues të dokumenteve standarde të tenderit), për shkeljet në procedurat e prokurimit. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 128, datë 04.04.2022, ka urdhëruar Sektorin e Asistencës Ligjore, për hartimin e shkresave për APP, për vlerësimin e shkeljeve të konstatuara nga raporti i KLSH-së. Urdhri është nxjerrë brenda afatit 20 ditor për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së. Në vazhdim, nga strukturat e ngarkuara sipas urdhrit të Kryetarit të Bashkisë, është dërguar pranë APP, shkresa me nr. 2630 Prot., datë 09.05.2022, pjesa atakuuese e raportit përfundimtar të auditimit të KLSH-së, ku i është propozuar APP të vlerësojë shkeljet e konstatuara nga auditimi i Bashkisë Vau Dejës. Në vazhdim, APP, ka dërguar pranë Bashkisë Vau Dejës, vendimin nr. 139, datë 09.12.2022, hyrë në Bashki me shkresën me nr. 6975 Prot., datë 12.12.2022. Në këtë vendim janë propozuar 12 masa administrative nga të cilat 11 masa me gjobë në vlerën **1,090,000 lekë** dhe 1 masë administrative. **Sa më sipër KLSH i kërkon nga Bashkia Vau Dejës** ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës **1,090,000 lekë** ndaj 11 punonjësve dhe ndjekjen e procedurave disiplinore për 1 punonjes si vijon.

d.2. Masë Administrative, I është rekomanduar, Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës t'i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Vau i Dejës, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të bëjë propozimin për fillimin e procedurës disiplinore për: 1 mbikëqyrës dhe 1 kolaudator. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 283, datë 04.04.2022, ka urdhëruar IMT, për ekzekutimin e rekomandimeve të mësipërme. Në vazhdim, IMT ka gjobitur përkatësisht Znj. S.K. dhe Znj. G. K., për shkeljet e konstatuara nga auditimi.. Pas vendimeve të IMT me nr. 14 dhe nr. 15, datë 12.07.2022, nuk ka asnjë dokument të dorëzuar pranë grupit të auditimit për të vërtetuar realizimin e rekomandimit.

e. Masa Disiplinore i është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për 2 punonjës. Nga verifikimi rezultoi se kryetari i Bashkisë nuk ka nxjerrë urdhrat për vazhdimin e procedurave për dhënie masë disiplinore për znj. M. Gj. dhe z. A. N.

DREJTIMIT E AUDITIMIT:

1.Hartimi i programit (Plan veprimt) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Vau Dejës, rekomandimet e auditimit me shkresën me nr. 1112/18 Prot., datë 09.03.2022, ndërsa nga Bashkia Vau Dejës, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH është kthyer përgjigje me shkresën nr. 1407/1 Prot., datë 04.04.2022. Bashkia Vau Dejës është vënë në dijeni për rekomandimet e KLSH-së, në datën 11.03.2022 sipas protokollit të Bashkisë Vau Dejës ku është protokolluar shkresa përcjellëse e dërgimit të raportit të auditimit me nr. 1407 Prot., datë 11.03.2022. Përgjigjia drejtuar KLSH-së për planin e masave, është dërguar brenda afatit 20 ditor. Plani i masave është paraqitur në një tabelë përmbledhëse por

që nuk evidentohet të ketë datë ose numër protokolli duke e bërë të pamundur verifikimin e hartimit të këtij plani.

Zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit

Nga verifikimi rezulton se përfundimet e auditimit i janë dërguar subjektit të audituar, me shkresën e Kryetarit të KLSH-së nr. 1112/18 Prot., datë 09.03.2022, dhe subjekti duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 09.09.2022.

Nga ana e Bashkisë Vau Dejës, nuk është kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së. Pra nuk është zbatuar afati për raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda 6 muajve nga data e njoftimit të Raportit përfundimtar të auditimit në KLSH duke mos zbatuar në këtë mënyrë, kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit, pika 2, *ku përcaktohet se*: Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna. **Për të cilën mban përgjegjësi Kryetari i Barki.**

Pa zbatuar

3-Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 -Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Titulli i gjetjes 35: *Mos raportim në KB mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.*

Situata: Nga verifikimi rezulton se Bashkia Vau Dejës, ka dërguar në KLSH, planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve me shkresën nr. 1407/1 Prot., datë 04.04.2022, **dhe nuk ka raportuar** rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë.

Kriteri: Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5.

Ndikimi: Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit sjell që disa aktivitete në Bashkinë Vau Dejës të kryhen në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe të kenë ndikime financiare në vijimësi.

Shkaku: Mos angazhim sa duhet i strukturave të Bashkisë Vau Dejës me qëllim zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Bashkia Vau Dejës të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

4. Realizimi i rekomandimeve për masa me karakter organizativ, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar, duke pasqyruar punën e bërë të analizuar për rekomandimet e realizuara plotësisht, pjesërisht, në proces realizimi dhe sa nga rekomandimet nuk janë pranuar.

A. MASA ORGANIZATIVE:

Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Vau Dejës 19 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 3 masë organizative, në proces zbatimi 5 masa organizative dhe nuk janë zbatuar 11 masa organizative. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatuan diferenca midis treguesve të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera. Niveli i realizimit të treguesve të buxhetit varion në masën 38% deri 94,9%, gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Vau i Dejës dhe realizimi faktik nuk i përgjigjet zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara.

Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit për vitin 2020 e zënë shpenzimet e PAKU-t me 94.92%, e ndjekur nga pagat me 64.15% dhe shpenzimet operative me 49%.

Të ardhurat e Bashkisë Vau i Dejës për vitin 2020 janë realizuar në masën 46.91%, konkretisht nga 180,000 mijë lekë të ardhura të planifikuara, janë realizuar 84,429 mijë lekë. Totali i planifikuar i të hyrave për vitin 2020 është 1,052,838 mijë lekë nga të cilat janë realizuar 38.4%, pra 404,375 mijë lekë.

Për vitin 2020, nga transfertat e pakushtëzuar treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 220,570 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 213,119 mijë lekë ose në masën 96.62.

Nga transfertat specifike treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 104,222 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 104,222 mijë lekë ose në masën 100.

Nga të ardhurat e veta treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 180,000 mijë lekë për vitin 2020 dhe të trashëguara nga viti 2019 janë 368,094 mijë lekë, të cilat janë realizuar në vlerën 87,033 mijë lekë ose në masën 15.9%.

Nga fondet e deleguara treguesit e buxhetit janë planifikuar për vlerën 296,059 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 292,196 mijë lekë ose në masën 98.7%.

Gjatë periudhës objekt auditimi, Fonde nga FZHR dhe financime të huaja nuk ka pasur.

Ka diferenca të dukshme midis treguesve të planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, kryesisht përse i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe rrjedhimisht shpenzimeve të tyre, konkretisht, nga 1,433,644 mijë lekë shpenzime të planifikuara, janë realizuar 851,373 mijë lekë, me një diferencë prej 582,271 mijë lekë, pra pothuajse 41% të planifikimit.

Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa “c” dhe “ç”; ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMF nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”;

UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1., faqe 22-45 të Raportit të Auditimit)

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau Dejës të merren masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

1.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 132, datë 04.04.2022, ka urdhëruar marrjen e masave për hartimin e një buxheti real, sipas rekomandimit të lënë nga KLSH. Urdhri është nxjerrë brenda afatit 20 ditor për marrjen e masave për zbatimin e rekomanimeve të KLSH-së. Në vazhdim, nga strukturat e ngarkuara sipas urdhrin të Kryetarit të Bashkisë, nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Pa Zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se realizimi i investimeve të planifikuara paraqitet në nivele të ulëta, ku për vitin 2020 është realizuar në një nivel prej 34.1%, ku nga vlera e planifikuar prej 188,748 mijë lekë është realizuar vlera 64,379 mijë lekë me një diferencë prej 124,369 mijë lekë.

Sa më sipër, bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016, nenet 2, 3, 6, 9, 10, 15, 27 dhe 32; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 9.2.2006; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa “c” dhe “ç”; ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenet 2 dhe 3 pika 3; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, nenet 79, 80 dhe 81; UMF nr. 10, datë 28.02.2017, “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”; UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, UMFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”; UMFE nr. 23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1., faqe 22-45 të Raportit të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Vau Dejës të merren masa që planifikimi i procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (faturave të palikujduara), në fund të periudhës, duke planifikuar shpenzimet më të domosdoshme për nevojat e bashkisë Vau i Dejës.

2.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 134, datë 04.04.2022, ka urdhëruar marrjen e masave që planifikimi i procedurave për investime dhe shërbime të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave. Urdhri është nxjerrë brenda afatit 20 ditor për marrjen e masave për zbatimin e rekomanimeve të KLSH-së.

Në vazhdim, nga strukturat e ngarkuara sipas urdhrorit të Kryetarit të Bashkisë, nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Pa Zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se për vitin 2020, të ardhurat nga 180,000,000 lekë të planifikuara, janë realizuar në shumën 85,427,465 lekë ose 47.46%, pra me një mosrealizim në shumën 94,572,535 lekë. Nga struktura e taksave dhe tarifave vendore, cilësohet se ky mosrealizim thelluar kryesisht për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia Covid-19.

Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, neni 5, “Parime dhe rregulla të disiplinës fiskale dhe të financimit të funksioneve vendore”, neni 54, “Raportimi financiar” nënpika c, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar, ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; UMFE nr. 9 datë 20.03.2018, Kreu IV “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” pika 200, UMFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, pika 32, Kreu II pika 2/a, b.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1., faqe 22-45 të Raportit të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Bashkia Vau Dejës, gjatë hartimit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë. Gjithashtu të monitorohet ecuria e të ardhurave, duke vlerësuar rrisqet që mund të ndikojnë në mosrealizimin e vlerës së planifikuar dhe mbi bazën e tyre.

3.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 136, datë 04.04.2022, ka urdhëruar Sektorin e Taksave dhe Sektorin e Financës, për zbatimin e rekomandimit të mësipërm. Në vazhdim, nuk ka asnjë veprim të mëtejshëm pas urdhrorit të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës.

Në proces zbatimi

4. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” për vitin 2020 paraqitet në vlerën **1,550,494 lekë** dhe përfaqëson detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se

- Vlera **1,550,494 lekë** janë detyrime përpara vitit 2015 të trashëguara nga ish komunat. i cili është detyrim i pa dokumentacionin përkatës për t`u paraqitur si detyrim ndaj furnitorëve për mallra shërbime dhe punime të kryera, i mbartur, të cilat konsistojnë me kontrata pa vlerë, pa faturë të thjeshtë tatimore pa faturë tatimore me TVSH, apo dhe pa procedurë të mbyllur.

-Sipas rakordimit me sektorin e taksave dhe tarifave vendore rezulton se në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm” nuk janë përfshirë gjobat e vendosura nga IMTV-ja, në fund të vitit ushtrimor 2020 në vlerën **5,720,000 lekë**, vlerë e cila nuk rezulton e regjistruar në kontabilitet në llogarinë që debitohet në bilancin kontabël 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe llogarinë që kreditohet në pasqyrën e performancës financiare “7115 “Gjoha kamatëvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime”. Pra kemi një nënvlerësim të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe llogarisë “7115 “Gjoha kamatëvonesa, sekuestrime dhe zhdëmtime” me **2,120,000 lekë** për vitin 2018, me **2,500,000 lekë** për vitin 2019 , me **1,100,000** për vitin 2020 Në mënyrë të detajuar paraqitet në

aneksin nr.3/pika 2 “Vendimet e gjobave të IMTV për periudhën 2018-31.12.2021”, bashkëlidhur Raportit të auditimit.

-Sipas akt rakordimit të mbajtura midis “Sektorit të ardhurave dhe tarifave vendore” dhe “Sektorit të Financës”, sipas shkresës nr. 02 prot., datë 26.01.2021, gjendja debitorë më 31.12.2020 e subjekteve taksapagues privat dhe familjar, është në vlerën 69,523,827 lekë. Nga analiza e llogarisë 468 “**Debitorë të ndryshëm**” konstatohet se vlera 69,523,827 lekë është kontabilizuar në llogarinë 475 “Të ardhura për t’u regjistruar në vitet pasardhëse”. Kontabilizimi i vlerës debitorë të taksapaguesve privat dhe familjar në llogarinë 475 “Të ardhura për t’u regjistruar në vitet pasardhëse” është bërë në mënyrë të gabuar, pasi sipas klasifikimit buxhetor çdo debitor regjistrohet në llogarinë 468 “Debitor të ndryshëm” në aktiv të bilancit.

Pra kemi një nënvlerësim të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 69,523,827 lekë dhe një mbivlerësim të llogarisë 475 “Të ardhura për t’u regjistruar vitet pasardhëse” në vlerën 69,523,827 lekë. *Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, aneksi 1, pika 3.3, ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Urdhërit nr.64 datë 22.07.2014 “ Për shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe Standartit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 “Të ardhurat”, pika 8 e standartit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 46-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4.1. Rekomandimi: Sektori i Financës në bashkëpunim me Sektorin e të Ardhurave të merren masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore në fund të vitit ushtrimor 2020 në vlerën 69,523,827 lekë.

4.2.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Sektorin Juridike , të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e vlerave debitorë të krijuar gjatë periudhës 2018-2020, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme ligjore si dhe kontabilizimin e gjobave të vendosura nga IMTV-ja në fund të vitit 2020 në vlerën **5,720,000 lekë**.

4.3. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Sektorin Juridike të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e tyre.

4.4.Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 138, 139, datë 04.04.2022, ka urdhëruar Sektorin e Taksave dhe Tarifave si dhe Sektorin e Financës, për të marrë masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të prapambetura. Në vazhdim, nuk ka asnjë veprim të mëtejshëm pas urdhrin të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës. Gjithashtu nuk ka asnjë masë të marrë nga Kryetari i Bashkisë Vau Dejës për punonjësin e ngarkuar për zbatimin e urdhrin.

Pa Zbatuar

5. Gjetje nga auditimi: *Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor datë 31.12.2020)”, në aktiv të pasqyrave financiare (Formati nr.1), paraqitet në vlerën 456,309 lekë pozicionimi i kësaj llogarie është bërë në mënyrë të gabuar. Pasi kjo llogari përbëhet nga detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2019 të cilat trashëgohen në vitin 2020, e cila në analizë përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën 0 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 14,726,956 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 891,906 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 4,355,094 lekë, llog. 436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 599,449 lekë, çka ka sjell një nënvlerësim të llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin” në vlerë 20,573,405 lekë, veprimet*

dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, neni 10 dhe 11, Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 32 e tij

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 46-65 të Raportit të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Nga nëpunësi zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” ,veprimet e sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021.

Menjëherë

5.2.Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 140, datë 04.04.2022, ka urdhëruar Sektorin e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme. Në vazhdim, nuk ka asnjë veprim të mëtjetshëm pas urdhrin të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës. Gjithashtu nuk ka asnjë masë të marrë nga Kryetari i Bashkisë Vau Dejës për punonjësin e ngarkuar për zbatimin e urdhrin.

Në proces

6. Gjetje nga auditimi: Llogaria 202 “*Studime dhe Kërkime*”, sipas akt rakordimit me degën e thesarit Shkodër në mbyllje të vitit 2020 paraqitet në vlerën 61,220,902 lekë. Nga analiza e llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*” e kësaj llogarie konstatohet se vlera prej **50,049,802 lekë** i përket 17 projekt-studime për investime të përfunduara. Vlera e mësipërme e projekteve duhet të ishte shtuar në vlerën e secilit aktiv përkatës për të cilin është hartuar projekti. Ky veprim ka qenë lehtësisht i realizueshëm pasi ekziston inventar kontabël dhe fizikë, pasi ruajtja e projekteve është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer Në mënyrë të detajuar paraqitet në aneksin nr. 4 pika 2 bashkëlidhur projekt raportit. *Veprime dhe mos veprimet janë në kundërshtim të Udhëzimit e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi I “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël), me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabël”, Seksioni II “Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar” Pika 1/b “Klasifikimi kontabël” e cila ndër të tjera përcakton se: “Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimit.*

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 46-65 të Raportit të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektmeve prej **50,049,802 lekë**, sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij. Për këtë të kreditohet llog. 202 “*Studime dhe Kërkime*” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

6.2.Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 140, datë 04.04.2022, ka urdhëruar Sektorin e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme. Në vazhdim, nuk ka asnjë veprim të mëtjetshëm pas urdhrin të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës. Gjithashtu nuk ka asnjë masë të marrë nga Kryetari i Bashkisë Vau Dejës për punonjësin e ngarkuar për zbatimin e urdhrin.

Pa zbatuar

7. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e llogarive kreditore konstatohet se: **-Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene”** në datën 31.12.2019, paraqitet në vlerën 6,208,378 lekë, në 31.12.2020 paraqitet po në vlerën 6,208,378 lekë e pa ndryshuar. **-Llogaria 211 “Pyje kullota plantacione”** për vlerën kontabël historike 113,039,105 lekë, më 31.12.2020 paraqitet po në vlerën 113,039,105 lekë e pa ndryshuar. **-Llogaria 212 “Ndërtime e konstruksione”** më 31.12.2019, paraqitet në vlerën 1,669,876,122 lekë, më 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie rezulton 1,769,967,304 lekë me një rritje në vlerë 100,091,182 lekë e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera gjatë vitit 2020. **-Llogaria 213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”** më 31.12.2019, paraqitet në vlerën 1,973,442,943 lekë, më 31.12.2020 gjendja e kësaj llogarie rezulton 2,082,261,462 lekë, e cilat përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat gjatë periudhës raportuese. **-Llogaria . 214 “ Instalime teknike, makineri e pajisje”**, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Vau Dejës dhe ish Komunat, në fund të vitit 2019 rezulton për vlerën 44,373,862 lekë dhe në fund të vitit 2020 për vlerën 46,937,264 lekë ose me rritje në vlerën neto 2,563,402 lekë. **-Llogaria. 215 “Mjete transporti”**, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Vau Dejës dhe ish Komunat, në fund të vitit 2019 rezulton për vlerën 35,829,016 lekë dhe në fund të vitit 2020 për vlerën 35,829,016 lekë e pa ndryshuar.

-Llogaria 218 “Inventar ekonomik” e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Vau Dejës dhe ish Komunat, në fund të vitit 2019 rezulton për vlerën 101,115,558 lekë dhe në fund të vitit 2020 për vlerën 105,773,478 lekë ose me rritje në vlerën neto 4,657,920 lekë. Nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia. Duke qenë se nuk ka një regjistër kontabël, nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet. Sektori i financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar, të vitit 2020, *Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata materiale" dhe pika 33.*

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 46-65 të Raportit të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për kryerjen e inventarizimit të AAGJM, të krijojë dhe të mbajë regjistrin analitik aktiveve, ku të përmbajë të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vendndodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

7.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për përlllogaritjen e saktë të amortizimit, aktiv për aktiv sipas të dhënave regjistrat të aktiveve, duke aplikuar normat e amortizimit të miratuara me qëllim saktësimin e vlerës së mbetur të AAGJ dhe reflektimi i të gjithë ndryshimeve në kontabilitet nëpërmjet sistemimeve kontabël, duke pasqyruar saktë dhe realisht gjendjet e AAGJ në llogaritë përkatëse të klasës 20 dhe 21 në pasqyrat financiare.

7.3.Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 141, datë 04.04.2022, ka urdhëruar Sektorin e Financës dhe të Buxhetit, për zbatimin e këtyre rekomandimeve. Në vazhdim, nuk ka asnjë veprim të mëtejshëm pas urdhrin të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës. Gjithashtu nuk ka asnjë masë të marrë nga Kryetari i Bashkisë Vau Dejës për punonjësin e ngarkuar për zbatimin e urdhrin.

Pa zbatuar

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se gjendja e llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, në mbyllje të vitit ushtrimor 2018 - 2020 paraqitet në vlerën 1,699,235 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve rezulton se ka kontrata që kanë përfunduar si punime dhe likuidim për një hark kohor më shumë se një vit, për të cilat janë kryer pagesa pjesore sipas punimeve të kryera dhe fondeve në dispozicion. Nga auditimi i kontabilizimeve të veprimeve ekonomike për blerje të aktiveve afatgjata dhe për rastet e investimeve të kryera nga firma sipërmarrëse punimesh, pas kryerjes së testeve në ditarët e bankës, magazinës dhe partitarin e investimeve, kontabilizimet kanë filluar në momentin e pagesave të faturave dhe situacioneve pjesore dhe jo në momentin e mbërritjes së tyre në institucion. Për kontratat e investimeve me shtrirje kohore më të gjatë rezulton se llogaria. 231 “Shpenzime për investime në proces” është debituar dhe kredituar për vlera pjesore të paguara, duke u mbyllur kjo llogari në mënyrë të gabuar pa u kapitalizuar aktivet deri në vlerë të plotë. Gjendja e kësaj llogarie nuk duhet të ishte në vlerën 162,907,742 lekë, kur ka investime në proces, kështu për kontrata të lidhura në vitet 2018-2019-2020 janë paguar pjesërisht deri me datë 31.12.2020 në vlerën 162,907,742 lekë, vlerë e cila në fakt i përket gjendjes debitorë prej të llog. 231 “Shpenzime për Aktive Afatgjata materiale (investime në proces)”. Në mënyrë të detajuar paraqiten në aneksin nr. 6 pika 2 i kontratave të investimeve bashkëlidhur raportit të auditimit. *Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Klasa 23. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 46-65 të Raportit të Auditimit)*

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Vau Dejës të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet ti evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave ti kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

8.2.Nga verifikimi rezultoi se: Bashkia Vau Dejës me shkresën Nr. 1641 prot., datë 30.03.2022 i ka dërguar pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Shkodër nga ku rezulton se Gjendja e llog. 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 paraqitet në vlerën 1,699,235 lekë, dhe mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 41,466,223 lekë e cila i përket investimeve në proces të cilat nuk janë mbyllur brenda vitit ushtrimor.

Zbatuar

9. Gjetje nga auditimi: Llogaria 26 “Aktive afatgjata Financiare”, sipas pasqyrës financiare paraqitet me vlerë zero lekë për periudhën objekt auditimi. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Bashkia Vau Dejës, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 17/12/2021 paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Vau Dejës Sha me NUIS

“L.....M” e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 350,812 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 350,812,349 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Vau Dejës në “Ujësjellës Kanalizime Sha, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2018-2020, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata jo materiale”, pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 46-65 të Raportit të Auditimit)

9.1. Rekomandimi: Nga nëpunësi zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësjellës Kanalizime Vau Dejës Sh.a me vlerë 350,812,349 lekë, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

9.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 142, datë 04.04.2022, ka urdhëruar Sektorin e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij rekomandimi. Në vazhdim, nuk ka asnjë veprim të mëtjshëm pas urdhrin të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës. Gjithashtu nuk ka asnjë masë të marrë nga Kryetari i Bashkisë Vau Dejës për punonjësin e ngarkuar për zbatimin e urdhrin.

Pa Zbatuar.

10. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” më 31.12.2019, paraqitet në vlerën **41,190,337 lekë**, ndërsa më 31.12.2020 paraqitet në vlerën **39,862,041 lekë**, Gjatë vitit 2020 shtesat janë në vlerën **11,086,960 lekë** dhe likuidimet e kryera në vlerën **12,415,256 lekë**. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: Drejtorja e Financës nuk disponon listën analitike për sa janë kontabilizuar në debi të llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”

Nga auditimi u konstatua se lista analitike e llogarisë 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje”, nuk jep informacion të plotë, pasi mungon afati i fillimit dhe mbarimit të garancisë së vlerës 5% të punimeve për subjektet private. Mungesa e këtij afati, nuk jep mundësi për ndjekjen e grafikut të kthimit të garancisë për investimet e marra në dorëzim në mënyrë përfundimtare dhe evidentimin e investimeve të pa përfunduara ende, të cilat konsistojnë me kontrata pa vlerë, pa faturë të thjeshtë tatimore apo faturë tatimore me TVSH apo dhe pa procedurë të mbyllur, në kundërshtim me UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6, pika 10.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 46-65 të Raportit të Auditimit)

10.1. Rekomandimi: Drejtorja Ekonomike në Bashkëpunim me Sektorin e Urbanistikës të evidentojë subjektet të cilat kanë shlyer detyrimin për të cilin ju është ngurtësuar vlera 5% e garancisë së punimeve dhe të bëjë likuidimin e kësaj vlere për subjektet.

10.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 143, datë 04.04.2022, ka urdhëruar Sektorin e Financës dhe Buxhetit, për zbatimin e këtij rekomandimi. Në vazhdim, nuk ka asnjë veprim të mëtjshëm pas urdhrin të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës. Gjithashtu nuk ka asnjë masë të marrë nga Kryetari i Bashkisë Vau Dejës për punonjësin e ngarkuar për zbatimin e urdhrin.

Ne proces zbatimi

11. Gjetje nga auditimi. Nga auditimi u konstatua se nuk janë të regjistruar a në kontabilitet një numër i konsiderueshëm pronash të Bashkisë Vau Dejës, të cilat kanë kaluar në pronësi të saj nëpërmjet VKM-në nr. 500 datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, në Bashkinë Vau Dejës dhe Njësit Administrative (Shllak, Temal, Vig Mnelë, Hajmel dhe Bushat), për periudhën objekt auditimi (2018-30.09.2021), Sektori i Menaxhimit të Aseteve ka certifikuar në total 21 prona nga 5044 prona. Gjithashtu nga ana e nëpunësit zbatues nuk janë krijuar regjistrat e asetëve si dhe nuk janë kryer veprime për regjistrimin e të gjitha pronave dhe pasqyrimin në inventar dhe kontabilitet; nuk është ngritur grup pune për përgatitjen e dokumentacionit teknik të asetëve në pronësi dhe në përdorim, për të realizuar regjistrimin e pronave pranë ZVRPP (ASHK) Shkodër; nuk ka rakordim me ZVRPP (ASHK) Shkodër, për asetet pronë e Komunës, pasi nuk është marrë në dorëzim harta treguese e objekteve pronë e Komunave; nuk ka të dhëna dhe rakordim për objektet e privatizuar dhe evidencë të pronarëve që nuk kanë shlyer troje; nuk kanë filluar procedurat për përgatitjen e dokumentacionit ligjor për verifikimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike dhe marrjen në dorëzim të asetëve. Mosveprimet e mësipërme janë në shkelje të kërkesave të ligjit nr. 33-2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, dhe UMF-së nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III, pika 30.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2., faqe 46-65 të Raportit të Auditimit)

11.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të ngrijë grup pune me specialist të fushës për evidentimin e të gjitha aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (AQT) të cilat janë pasuri e Bashkisë, duke evidentuar statusin dhe gjendjen e tyre faktike në teren.

11.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me strukturat e tjera të bashkisë të plotësojë regjistrin e të gjitha aktiveve sipas llogarive përkatëse, i cili të jetë elektronikë dhe shkresor dhe të marrë masa për regjistrimin e pronave në ASHK dhe kontabilitet

11.3. Nga verifikimi rezultoi se: Nuk ka urdhër të ngritur për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të gjetjes nr. 11.

Pa zbatuar

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik rezultoi se operatorët ekonomikë janë shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” ndryshuar dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij, duke sjellë shpalljen e fituesit të procedurës së prokurimit në mënyrë të paligjshme. Kjo anomali është konstatuar në 8 procedura prokurimi, të cilat së bashku kanë vlerë të fondit limit 382,481,138 lekë pa tvsh dhe vlerë të kontratës 373,624,343 lekë pa TVSh. Kjo anomali e ndarë sipas viteve është konstatuar: për vitin 2018 në 3 raste në vlerën e fondit limit 205,277,194 lekë, për vitin 2019 në 3 raste në vlerën e fondit limit 138,499,999 lekë dhe në vitin 2020 në 2 raste në vlerën e fondit limit 38,703,945 lekë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1., faqe 66-111 të Raportit të Auditimit)*

12.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST.

12.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 126, datë 04.04.2022, ka urdhëruar Sektorin e Prokurimeve për zbatimin e këtij

rekomandimi.. Sipas urdhrorit të Kryetarit të Bashkisë, është dërguar pranë APP, shkresa me nr. 2630 Prot., datë 09.05.2022, pjesa atakuese e raportit përfundimtar të auditimit të KLSH-së, ku i është propozuar APP të vlerësojë shkeljet e konstatuara nga auditimi i Bashkisë Vau Dejës.

Zbatuar

13. Gjetje nga auditimi: Referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën 01.01.2018 – 30.09.2021, u konstatua se nga 17 procedura prokurimi të audituara, me vlerë të kontratës 649,258,266 lekë, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP, 14 procedura prokurimi me vlerë kontrate 590,883,825 lekë ose 91% e vlerës së audituar. Këto shkelje e mangësi rezultojnë në drejtim të mos argumentimit të përcaktimit të kriterëve të veçanta për kualifikim, vendosjen e tyre jo në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit si dhe grafikun e punimeve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 1 “Objekti dhe qëllimi”, pika 2 e nenit 2 “Parimet e përzgjedhjes”, pika 1, e nenit 46, të ligjit nr. 9643, datë 20.01.2006, ndryshuar si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Seksioni II, “Informacione të veçanta për kontratat”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 7 dhe Kreu VII, “Zyrtarët e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave”, neni 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, paragrafi 2, si dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore të trajtuara sipas rastit në çdo procedurë prokurimi të audituar. Vendosja e kriterëve në mënyrë të tillë ka sjellë një pjesëmarrje të ulët të OE në procedurat e prokurimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1., faqe 66-111 të Raportit të Auditimit)

13.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vau i Dejës, të analizojë situatën e konstatuar, të nxjerrë përgjegjësitë për përcaktimet e gabuara të kriterëve të veçanta për kualifikim dhe të marrë masa që përcaktimi e kriterëve për kualifikim të jetë në lidhje të ngushtë me objektin e procedurës së prokurimit.

13.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 126, datë 04.04.2022, ka urdhëruar Sektorin e Prokurimeve për zbatimin e këtij rekomandimi.. Sipas urdhrorit të Kryetarit të Bashkisë, është dërguar pranë APP, shkresa me nr. 2630 Prot., datë 09.05.2022, pjesa atakuese e raportit përfundimtar të auditimit të KLSH-së, ku i është propozuar APP të vlerësojë shkeljet e konstatuara nga auditimi i Bashkisë Vau Dejës.

Zbatuar

14. Gjetje nga auditimi : Nga auditimi i procedurave të prokurimit, u konstatua se në një rast, në procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtim trotuari dhe vendosje e barrierave mbrojtëse qendër fshati Barbullush”, me vlerë oferte në shumën prej 19,368,720 lekë pa TVSH është lidhur kontratë për zhvillim punimesh në të cilën operatori ekonomik nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës në vlerën 10% të saj. Nga Kryetari i Bashkisë Vau i Dejës nuk është bërë konfiskimi i sigurimit të ofertës në vlerën 1,936,872 lekë, në kundërshtim me pikën 1 dhe 3 të nenit 24 të VKM nr.914, datë 29.12.2014.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1., faqe 66-111 të Raportit të Auditimit)

14.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa që në të ardhmen të lidhë kontrata pasi të jetë bërë sigurimi i kontratës, si kusht i kërkuar në DST, me qëllim realizimin e kontratës në kohë dhe me cilësi.

14.2. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të 126, datë 04.04.2022, “Për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të auditimit të KLSH- së”, Njësia e Prokurimit ka marë

masa që në procedurat e prokurimit të lidhura janë bërë pasi është bërë sigurimi i kontratës“ Njësia e prokurimit ka marrë parasysh të gjitha rekomandimet e bëra nga KLSH-ja, duke i pasqyruar në DST e publikuara në SPE gjatë vitit 2022.

Në proces zbatimi

15. Gjetje nga auditimi : Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik u konstatua se në 2 procedura operatorët ekonomikë të cilët kanë paraqitur oferta me vlerë më të leverdishme për Autoritetin Kontraktor, janë tërhequr nga procedurat e prokurimit, por edhe pse nga AK pretendohet se kjo tërheqje është bërë duke njoftuar me shkresa përkatëse, një dokument i tillë nuk iu paraqit grupit të auditimit dhe më konkretisht për këto procedura si më poshtë:

1- Procedura me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës “Qendër Hajmel – Naraç”, me fond limit 31,666,666 lekë pa tvsh. Është tërhequr OE “C. R. 2008” shpk me vlerën më të ulët të ofertës në shumën prej 22,692,742 lekë pa tvsh;

2- Procedura me objekt “Rikonstruksion + Shtesë e shkollës së Bashkuar, Hajmel – Vau i Dejës”, me fond limit 74,996,610 lekë. Është tërhequr BOE “A. K.” shpk & “K.” shpk me vlerën më të ulët të ofertës në shumën prej 49,779,964 lekë pa tvsh.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1., faqe 66-111 të Raportit të Auditimit)

15.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa që në të ardhmen të mos përsëriten situata si në 2 rastet e mësipërme ku pretendohet se janë tërhequr nga procedurat sipas raportit përmbledhës këta operatorë ekonomikë, të cilët kanë paraqitur oferta me vlerë më të favorshme ekonomike, pasi tërheqja rezultoi në dokumentuar vetëm në raportin përmbledhës dhe çdo dokumentacion apo procedurë mbetet vetëm në nivel deklarami.

15.2.Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të 126, datë 04.04.2022, “Për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të auditimit të KLSH- së”, Njësia e Prokurimit ka marrë masa që në procedurat e prokurimit ku OE që tërhiqen nga procedura e prokurimit “ Të arshivohen dokumentacionet e tërheqës nga procedura”. Njësia e prokurimit ka marrë parasysh të gjitha rekomandimet e bëra nga KLSH-ja, duke i pasqyruar në DST e publikuara në SPE gjatë vitit 2022.

Në proces zbatimi

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike (Bashkia Vau Dejës), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, si dhe nga Nëpunësi zbatues të ndiqet procesi me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **7,298,450 lekë** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Bashkinë Vau i Dejës ushtrojnë aktivitet për tregtimin me pakicë të hidrokarbureve dhe derivateve të tyre për përdorim nga konsumatorët

fundorë, 9 subjekte të cilat janë të pa licencuara. Subjekte të licencuar për tregtimin e lëndëve djegëse nuk ka.

Subjekti “V. D.i”, vazhdon të ushtrojë aktivitetin e papajisur me autorizimin përkatës, për të cilin tarifa për pajisjen e mëparshme me licencë tregtimi është ndarë në afat 1 vjeçar. Për këtë rast, nga Bashkia Vau i Dejës është aplikuar në mënyrë të gabuar tarifimi, duke e trajtuar këtë subjekt me pagesë të pjesshme, në vlerën 200,000 lekë, pra me 20% të vlerës së kësaj pagese. Gjithashtu, në të njëjtën mënyrë janë trajtuar edhe subjektet A.E. Ll. dhe Ç., të cilët kanë paguar nga 200,000 lekë, ndërkohë që duhet të paguanin nga 2,200,000 lekë.

Nga verifikimi i ekstrakteve të biznesit u konstatua se subjektet të cilat ushtrojnë veprimtari biznesi në Bashkinë Vau i Dejës e kanë si objekt të veprimtarisë edhe tregtimin e lëndës djegëse gaz i lëngshëm, për të cilën nuk është aplikuar pjesa përkatëse e pagesës për autorizim tregtimi.

Nga diferencat ndërmjet detyrimit që duhet paguar dhe pagesave të kryera rezulton një diferencë prej **6,320,000 lekë**, e cila **përbën dëm ekonomik** për buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës, si rezultat i tregtimit të hidrokarbureve dhe derivateve të tyre nga subjekte të pa pajisura me autorizimin e tregtimit ose për shkak të mënyrës së gabuar të llogaritjes së kësaj tarife.

Sa më sipër është në kundërshtim me VKM-në nr. 344, datë 19.04.2017, i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1., faqe 22-45 të Raportit të Auditimit)

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës, të merren masa për të pajisur subjektet me licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojnë tarifat e plota për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për paisje me autorizime, për shumën debitore prej **6,320,000 lekë** sipas aneksit nr. A28 bashkëlidhur raportit të auditimit. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

1.1.Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhërin nr. 127, datë 04.04.2022, ka urdhëruar marrjen e masave për paisjen e subjekteve me licensa sipas rekomandimit të lënë nga KLSH. Urdhri është nxjerrë brenda afatit 20 ditor për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

Më gjerësisht ky rekomandim është praftuar në akt konstatimin nr. 5 datë 23.12.2022.

Pa Zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Ujësjiellësi i Vau i Dejës”, Bashkia Vau i Dejës**, me vlerë të kontratës (me tvsh) 163,865,728 lekë, fituar nga OE “A.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 319,950 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 47/10 prot datë 29.07.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Vau i Dejës dhe OE “A.” SHPK

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1., faqe 66-111 të Raportit të Auditimit)

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **319,950 lekë pa TVSH** nga OE “A.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 47/10 prot datë 29.07.2019, me objekt “Ujësjiellësi i Vau i Dejës”, Bashkia Vau i Dejës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

2.2.Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 131, datë 04.04.2022, ka urdhëruar marrjen e masave për arkëtimin e vlerës 319,950 lekë nga OE "A." SHPK. Urdhri është nxjerrë brenda afatit 20 ditor për marrjen e masave për zbatimin e rekomanimeve të KLSH-së.

Në vazhdim, nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, është bërë njoftimi i OE "A." SHPK me vendimin nr. 16, datë 15.07.2022, për arkëtimin e vlerës së dëmit të konstatuar nga KLSH. Nuk konstatohet asnjë veprim i mëvonshëm nga Bashkia Vau Dejës për arkëtimin e vlerës së dëmit të konstatuar. Në datën 22.12.2022, në dispozicion të grupit të auditimit u vendos një dokument fotokopje me anë të së cilës vërtetohet se OE ka rikthyer vlerën prej 319,950 leka në degën e thesarit Shkodër.

Zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **"Rikonstruksion + shtesë e Shkollës së Bashkuar Hajmel"**, Bashkia Vau i Dejës, me vlerë të kontratës (me tvsh) 84,245,750 lekë, fituar nga OE "Junik" SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 658,500 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 46/10 prot datë 19.10.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Vau i Dejës dhe OE "J." SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1., faqe 66-111 të Raportit të Auditimit)

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **658,500 lekë pa TVSH** nga OE "J." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 46/10 prot datë 19.10.2018, me objekt "Rikonstruksion + shtesë e Shkollës së Bashkuar Hajmel", Bashkia Vau i Dejës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

3.2.Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 130, datë 04.04.2022, ka urdhëruar marrjen e masave për arkëtimin e vlerës 658,500 lekë nga OE "J." SHPK. Urdhri është nxjerrë brenda afatit 20 ditor për marrjen e masave për zbatimin e rekomanimeve të KLSH-së.

Në vazhdim, nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, është bërë njoftimi i OE "J." SHPK me vendimin nr. 17, datë 14.07.2022, për arkëtimin e vlerës së dëmit të konstatuar nga KLSH. Në vazhdim nga IMT, me shkresën nr. 5288 Prot., datë 06.12.2022, OE është paditur në Gjykatën Administrative të Shkollës së Parë Shkodër për mos dëmshpërblim të Bashkisë Vau Dejës në vlerën e dëmit të konstatuar nga KLSH. Pas padisë së bërë, edhe OE ka bërë kundërpadi për IMT. Çështja është në proces.

Zbatuar realizimi në proces

C.1. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE. (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të disponueshëm në zyrën e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Vau i Dejës, u konstatua se për vitin 2020 ka pasur gjithsej 24 kontrata

për dhënie tokë bujqësore me qera, 1 kontratë për dhënie trualli me qera, 3 kontrata për dhënie ndërtesash me qera dhe 50 kontrata për dhënie sipërfaqe pyjore me qera. Në datën 31.12.2020 ka rezultuar një vlerë totale debitore prej **984,790 lekë**, e cila përbën mungesë të ardhurash për Bashkinë Vau i Dejës.

Sa më sipër, është në kundërshtim me: ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; ligjin nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”; ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, i ndryshuar; ligjin nr. 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, VKM nr. 531, datë 21.08.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, i ndryshuar me VKM-në nr. 176, datë 30.03.2001, VKM nr. 373, datë 20.06.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, ku përcaktohet edhe Kontrata tip për t’u lidhur me qeramarrësit, përfshirë sanksionet, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”; UKM nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1., faqe 22-45 të Raportit të Auditimit)

1.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Sektorin e taksave dhe tarifave vendore të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **984,790 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të paarkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhërin nr. 133, datë 04.04.2022, ka urdhëruar marrjen e masave për të kontabilizuar detyrimin dhe për të ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej 984,790 lekë, sipas rekomandimit të lënë nga KLSH. Urdhri është nxjerrë brenda afatit 20 ditor për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së. Në vazhdim, nga strukturat e ngarkuara sipas urdhrat të Kryetarit të Bashkisë, nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Pa Zbatuar

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se taksa e ndikimit në Infrastrukturë, për vitin 2020 është realizuar në shumën 5,849,690 lekë nga 23,600,000 lekë të planifikuara ose në masën 25%. Para vitit 2019 janë 44 debitorë, në vlerën 1,784,622 lekë, për vitin 2019 janë 33 debitorë, për vlerën 1,031,456 lekë dhe për vitin 2020 janë 56 debitorë, për vlerën 1,528,902 lekë. Për periudhën para vitit 2019, nuk disponohen të dhëna të hollësishme në lidhje me sipërfaqet e legalizuara dhe emrat e debitorëve.

Për vitin 2020, nga Bashkia Vau i Dejës janë faturuar 164 individë dhe subjekte private posedues të lejeve të legalizimit të paraqitur pranë Bashkisë Vau i Dejës me një detyrim prej 4,734,512 lekë, nga këto është likuiduar vlera prej 3,205,610 lekë, duke mbetur pa shlyer 56 posedues të lejeve të legalizimit për një sipërfaqe prej 9,367.7 m² me vlerë 1,528,902 lekë.

Deri në datën 31.12.2020, në Bashkinë Vau i Dejës janë debitorë për taksën e ndikimit në infrastrukturë gjithsej 134 persona, për një sipërfaqe ndërtimore prej 13,687 m², në vlerën **4,344,980 lekë**, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës.

Sektorin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Vau i Dejës nuk ka pasur komunikim të rregullt me ASHK-në Shkodër (ish ZVRPP), për shkëmbim informacioni mbi hipotekimin e ndërtimeve informale të pajisura me leje legalizimi dhe për t’i propozuar lidhjen e një aktmarrëveshjeje

ndërmjet Bashkisë Vau i Dejës dhe ASHK Rajonale Shkodër, me qëllim që ky institucion të bëhet barrikadë për mosdhënien e lejeve të legalizimeve dhe certifikatave të pronësisë subjekteve private pa paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9482 datë 03.04.20106, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; VKB Vau i Dejës “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vau i Dejës”, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1., faqe 22-45 të Raportit të Auditimit)

2.1. Rekomandim: Bashkia Vau i Dejës nëpërmjet bashkëpunimit institucional t’i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Shkodër, që të mos lëshojë dhe të mos pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Vau i Dejës. Drejtoria ekonomike dhe Drejtoria e planifikimit të territorit dhe investimeve publike, të ndjekin procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijojë me masa shtrënguese deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët e listuar si debitorë në **Pasqyrën A7**, bazuar në legjislacionin tatimor.

Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 135, datë 04.04.2022, ka urdhëruar Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe DPZHT, për ndjekjen e zbatimit të rekomandimit. Në vazhdim, nuk evidentohet të jetë ndjekur ndonjë procedurë nga sektorët e ngarkuar për zbatimin e rekomandimit të KLSH-së.

Pa Zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se në Bashkinë Vau i Dejës ka 342 subjekte debitorë nga biznesi i vogël dhe i madh, në vlerën **22,932,161 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara** për buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës. Në përlllogaritjen e vlerës debitorë të paraqitur me sipër, është përfshirë edhe vlera e kamatëvonesave për mosshlyerjen në afat (0.06 % për çdo ditë vonesë).

Për ndjekjen dhe arkëtimin e debisë së subjekteve debitorë, strukturat tatimore të Bashkisë Vau i Dejës, nuk kanë ndërmarrë të gjitha masat që parashikojnë dispozitat e ligjit për procedurat tatimore, pasi në asnjë rast nuk kemi Urdhër sekuestrimi si dhe sekuestro e konfiskim të pasurisë. Gjithashtu nga strukturat tatimore të Bashkisë Vau i Dejës, për asnjë nga subjektet, ku megjithëse janë debitorë në vite dhe vlera të konsiderueshme, **pasi** janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar **kallëzim**.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9, pikat 1 dhe 3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i RSh” me ndryshime neni 181, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.3., neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, Ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1., faqe 22-45 të Raportit të Auditimit)

3.1. Rekomandim: Sektori i taksave dhe tarifave vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pavjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj **342 subjekteve** debitorë në vlerën prej **22,932,161 lekë** (sipas *Pasqyrës A15 në Aneksat e Raportit të Auditimit*), bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat tatimore” me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

b. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” i ndryshuar.

c. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana Drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar dhe Drejtorisë Juridike të Bashkisë Vau i Dejës, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 137, datë 04.04.2022, ka urdhëruar Sektorin e Kontrollit dhe Borxhit tatimor. Në vazhdim, nuk ka asnjë veprim të mëtejshëm pas urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës. Gjithashtu nuk ka asnjë masë të marrë nga Kryetari i Bashkisë Vau Dejës për punonjësin e ngarkuar për zbatimin e urdhërit.

Pa Zbatuar

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Vau i Dejës nuk ka krijuar regjistrin e subjekteve të cilët i paguajnë detyrimet e tyre nëpërmjet agjentëve tatimorë.

Me ligjin 7501 “Për tokën”, janë trajtuar me tokë bujqësore gjithsej **9,621 familje**, nga ku për vitin 2020 të ardhurat nga taksa e tokës janë realizuar në masën 43%.

Për taksat dhe tarifat e familjarëve, për vitin 2019 dhe më përpara, në Bashkinë Vau i Dejës nuk ka informacion të plotë për debitorët, kryesisht për shkak të mungesës të bazës së të dhënave dhe për problemet e akumuluar në vite. Për Nj.A. Vig-Mnelë, Temal dhe Shllak, deri më 31.12.2019, nuk ka debitorë të evidentuar për mungesë të regjistrit të taksapaguesve, pasi ekziston vetëm regjistri i atyre kryefamiljarëve që kanë likuiduar detyrimet, kur janë paraqitur për të marrë shërbime në bashki.

Nga baza ekzistuese e të dhënave, për Nj.A. Vau i Dejës qendër, Bushat dhe Hajmel rezulton vlera debitorë prej **9,781,551 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara** për buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës, nga mos arkëtimi i taksës së tokës bujqësore deri në datën 31.12.2020.

Nga auditimi u konstatua se Bashkia Vau i Dejës nuk ka lidhur kontratë me Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizimeve Vau i Dejës për vjeljen e detyrimeve të familjarëve mbi bazën e

kontratave të ujit të pijshëm që kanë abonentët familjarë, evidentimit dhe regjistrimit të abonentëve të rinj duke plotësuar regjistrin e taksapaguesve familjarë, gjë e cila ka shkaktuar edhe mangësitë e mëdha dhe një numër të lartë debitorësh në lidhje me këto detyrime.

Për kryefamiljarët gjatë vitit 2020 nuk janë bërë njoftime për pagesën e taksave dhe tarifave vendore, por janë faturuar në momentin kur janë paraqitur për të marrë një shërbim pranë Bashkisë.

Nga auditimi u konstatua se vlerat debitore të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore të familjarëve për vitet 2017-2019, nuk janë të plota dhe të sakta, për mungesë të bazës së të dhënave. Për vitin 2020, për Nj.A. Vau i Dejës qendër, Bushat dhe Hajmel, vlerat debitore janë sipas gjendjes reale për çdo taksapagues, sipas regjistrimit të gjendjes civile. Ndërsa familjet në Nj.A. Vig-Mnelë, Temal, Shllak, nuk janë pasqyruar si debitorë.

Gjendja totale e familjeve debitore **për të gjitha detyrimet** nga taksat dhe tarifave vendore, për vitet nga 2017-2020, për 10,568 familje, është **45,529,037 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara** për buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës, nga mos arkëtimi i taksave dhe tarifave të familjarëve deri në datën 31.12.2020.

Debitorët familjarë, për taksat dhe tarifave vendore të paraqitur në Aneksat e Raportit Përfundimtar të Auditimit, për Nj.A. Vau i Dejës qendër, Bushat dhe Hajmel, janë të kontabilizuar, ndërsa për Nj.A. Vig-Mnelë, Temal dhe Shllak, nuk ka vlera debitore, por edhe nuk është llogaritur asnjëherë detyrimi apo vlera debitore, për shkak të mungesës së të dhënave në vite.

Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4 pika 7 dhe neni 24, ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10; ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, UMF nr. 26, dt. 04.09.2008 dhe UMF nr. 12, dt. 4.4.2017, “Për Taksat Kombëtare”, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1., faqe 22-45 të Raportit të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës, të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për të hartuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (AKSH dhe Qarku Shkodër). Për familjet fermerë debitorë të nxirren njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë kohën e papaguar për vlerën **9,781,551 lekë** dhe për mospagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative apo penale në strukturat e tjera përkatëse, sipas rastit.

4.2.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa për të propozuar dhe diskutuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Vau i Dejës ShA, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak sipas legjislacionit në fuqi, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

4.3.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës debitore prej **45,529,037 lekë**.

4.4.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifatat apo taksat e të cilave mbledhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Vau i Dejës, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, etj.) për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga STTV Bashkia Vau i Dejës nuk janë faturuar për tarifatat vendore (gjelbërim dhe ndriçim) 5 subjekte ndërtimi të cilët janë pajisur me “Leje Ndërtimi” për llogari të subjekteve private, kanë kryer punimet përkatëse, por nuk janë pajisur me adresa sekondare për zhvillimin e biznesit, duke shkaktuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Vau i Dejës në vlerën **50,000 lekë**.

Për vitin 2020, rezulton se janë kryer investime, ku operatorët ekonomikë fitues të procedurave të prokurimit janë subjekte me aktivitet ndërtimi, të cilat kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike, por nuk janë pajisur me adresa sekondare për zhvillimin e biznesit, duke shkaktuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë Vau i Dejës në vlerën **39,808 lekë**.

Spektori i taksave dhe tarifave vendore nuk ka bashkëpunuar mjaftueshëm me sektorët e tjerë përkatës të bashkisë, për këto subjekte ndërtimi që zbatojnë kontrata me investime publike ose private, të cilët nuk kanë hapur adresa/nipete sekondare në territorin e Bashkisë Vau i Dejës, nuk ka kryer njoftimet për detyrimet përkatëse të këtyre subjekteve, duke shkaktuar **mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Vau i Dejës në vlerën 89,808 lekë**.

Sa më sipër bie në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” neni 40, “Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jo tregtare”, pika 1, neni 43 “Përditësimi i të dhënave të regjistrimit” pika 1/1; ligjin nr. 9723 dt.03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar, neni 22, “Detyrimi për regjistrim”, pika 4; ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, VKB, etj.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1.1., faqe 22-45 të Raportit të Auditimit)

5.1. Rekomandim: Spektori i taksave dhe tarifave vendore të saktësojë listat e bizneseve të pajisura me leje ndërtimi, për projektet e investimeve të prokuruar për vitet 2019-2020, pavarësisht nëse kanë selinë kryesore jashtë territorit të Bashkisë Vau i Dejës por që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, si dhe të nxjerrin njoftim detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore. Sipas listës aneks nr.A26 dhe A27, të ndjekin të gjitha procedurat administrative deri në arkëtimin e vlerës prej **89,808 lekë** nga këto detyrime vendore.

D. MASA ADMINISTRATIVE

D.1 Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të personave përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar në kapitullin III/2.4 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, mbështetur në nenin 132 të ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për

prokurimin publik” dhe shkronjat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe neneve 15 shkronja (c, ç) dhe 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, ti kërkoj Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) ndaj **8 punonjësve**, anëtarë të njësisë së prokurimit (hartues të dokumenteve standarde të tenderit), për shkeljet në procedurat e prokurimit, si më poshtë:

Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 128, datë 04.04.2022, ka urdhëruar Sektorin e Asistencës Ligjore, për hartimin e shkresave për APP, për vlerësimin e shkeljeve të konstatuara nga raporti i KLSH-së. Urdhri është nxjerrë brenda afatit 20 ditor për marrjen e masave për zbatimin e rekomanimeve të KLSH-së. Në vazhdim, nga strukturat e ngarkuara sipas urdhrin të Kryetarit të Bashkisë, është dërguar pranë APP, shkresa me nr. 2630 Prot., datë 09.05.2022, pjesa atakuese e raportit përfundimtar të auditimit të KLSH-së, ku i është propozuar APP të vlerësojë shkeljet e konstatuara nga auditimi i Bashkisë Vau Dejës. Në vazhdim, APP, ka dërguar pranë Bashkisë Vau Dejës, vendimin nr. 139, datë 09.12.2022, hyrë në Bashki me shkresën me nr. 6975 Prot., datë 12.12.2022. Në këtë vendim janë propozuar 12 masa me gjobë për 12 punonjës sipas listës së punonjësve të atakuar me shkelje nga Raporti Përfundimtar i Auditimit të KLSH-së si vijon:

Zbatuar

a) Për 5 anëtarët e njësisë së prokurimit (hartues të dokumenteve standarde të tenderit):

1. Znj. M. Gj., me detyrë, ish Përgjegjëse në Drejtorin Juridike dhe Asetet Publike. *Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mas administrative me gjobë në vlerën 60,000 lekë*

2. Znj. A. G., me detyrë ish Specialiste në Sektorin e Investimeve. *Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mas administrative me gjobë në vlerën 90,000 lekë*

3. Znj. S. Ç., me detyrë ish specialiste protokolli. *Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mas administrative me gjobë në vlerën 100,000 lekë*

4. Znj. K. Sh., me detyrë Përgjegjëse në Sektorin Ligjor Nj/A Bushat. *Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mas administrative me gjobë në vlerën 100,000 lekë*

5. Z. I. G., me detyrë ish Përgjegjës në Sektorin e Urbanistikes dhe Menaxhimit të Territorit. *Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur ti propozoj titullari të AK marrjen e masës disiplinor për mangësite në lidhje me argumentimin e kritereve.*

b) Për 7 anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit publik me objekt si vijon:

1. Znj. E.N., me detyrë ish Përgjegjëse në sektorin e Rregjistrimit dhe Kontabilizimit. Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mas administrative me gjobë në vlerën **150,000 lekë**

2. Znj. Sh. K., me detyrë ish Specialiste në Drejtorin Juridike dhe Asetet Publike Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mas administrative me gjobë në vlerën **120,000 lekë**

3. Znj. J. M., me detyrë Specialist urbanistike arkitekt, Nj/A Bushat. Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mas administrative me gjobë në vlerën **110,000 lekë**

4. Z. E. H., me detyrë Specialist hartograf NJ/A Bushat. Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mas administrative me gjobë në vlerën **120,000 lekë**

5. Znj. K. Sh., me detyrë Përgjegjëse në Sektorin Ligjor Nj/A Bushat. Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mas administrative me gjobë në vlerën **100,000 lekë**

6. Znj. A.Sh., me detyrë Drejtoresh në Drejtorin e Planifikimit Urban dhe Investimeve Publike. Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mas administrative me gjobë në vlerën **100,000 lekë**

7. Z. E.M., me detyrë Specialist në Sektori i Investimeve dhe Projekteve Publike. Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mas administrative me gjobë në vlerën **70,000 lekë**

D.2 Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar me Ligjin nr. 120/2020, datë 07.10.2020 dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Vau i Dejës, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të bëjë propozimin për fillimin e procedurës disiplinore për:

1. Znj. S. K., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në kontratën nr. 46/10 prot datë 19.10.2018 me objekt “Rikonstruksion + shtesë e Shkollës së Bashkuar Hajmel”, Bashkia Vau i Dejës, me sipërmarrës punimesh OE “J.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 658,500 lekë pa TVSH, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

2. Znj. G. K., në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në kontratën nr. 46/10 prot datë 19.10.2018 me objekt “Rikonstruksion + shtesë e Shkollës së Bashkuar Hajmel”,

Bashkia Vau i Dejës, me sipërmarrës punimesh OE “J.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 658,500 lekë pa TVSH, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 283, datë 04.04.2022, ka urdhëruar IMT, për ekzekutimin e rekomandimeve të mësipërme. Në vazhdim, IMT ka gjobitur dy mbikqyrësat përkatësisht Znj. S. K.dhe Znj. G. K., për shkeljet e konstatuara nga auditimi i kryar. Pas vendimeve të IMT me nr. 14 dhe nr. 15, datë 12.07.2022, nuk ka asnjë dokument të dorëzuar pranë grupit të auditimit për të vërtetuar realizimin e rekomandimit.

Në proces zbatim

E. MASA DISIPLINORE

I. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, geramat (b, c, ç) e nenin 58-“Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe shkronja (k) e nenit 64, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës** që t’i kërkojë Komisionit Disiplinor, që bazuar në performancës e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2018 deri më 30.09.2021, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore për **2 (dy) punonjës**, si më poshtë:

1.Znj. M. Gj., me detyrë përgjegjëse e sektorit të taksave dhe tarifave vendore.

Në mos menaxhimin e mirë të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9, pikat 1 dhe 3, neni 35, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3, pika 9 dhe 10, ligjit nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreu XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i RSh” me ndryshime neni 181, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.3., neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, ligjit nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, ligjin nr. 9482 datë 03.04.20106, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me VKM nr. 344 datë 19.04.2017 kapitulli II, pika 1; germa “b”, pikat 9, 15.1 dhe 15.2., etj..

Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 165, datë 15.04.2022, ka urdhëruar Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore për punonjësin M.Gj.. Në vazhdim, nuk ka asnjë veprim të mëtejshëm pas urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës. Gjithashtu nuk ka asnjë masë të marrë nga Kryetari i Bashkisë Vau Dejës për punonjësin e ngarkuar për zbatimin e urdhërit.

Ky urdhër i Kryetarit të Bashkisë është nxjerrë më vonë se 20 ditë ose jashtë afateve për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Zbatuar

2. Z. A. N. me detyrë Drejtor Ekonomik për vitin 2020 e në vijim. Në lidhje me anomalitë e konstatuara në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të vitit 2020. Në procesin e vlerësimit të aktiveve është vepruar në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 95; 102; 103; 104;105; 106, ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 164, datë 04.04.2022, ka urdhëruar Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore për punonjës A. N. Në vazhdim, nuk ka asnjë veprim të mëtejshëm pas urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës. Gjithashtu nuk ka asnjë masë të marrë nga Kryetari i Bashkisë Vau Dejës për punonjës e ngarkuar për zbatimin e urdhërit.

Zbatuar

G. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Vau Dejës pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

- a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.
- b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 129, datë 04.04.2022, ka urdhëruar Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore ndaj punonjësve sipas rekomandimit E duke bërë dhe njoftimet sipas rekomandimit G të KLSH-së. Në vazhdim, nuk ka asnjë veprim të mëtejshëm pas urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës. Gjithashtu nuk ka asnjë masë të marrë nga Kryetari i Bashkisë Vau Dejës për punonjës e ngarkuar për zbatimin e urdhërit.

Pa Zbatuar

V- Konkluzione dhe rekomandime:

Në përfundim të procesit të auditimit, duke vlerësuar punën e bërë nga Bashkia Vau Dejës për zbatimin e rekomandimeve të KLSH paraqitur me shkresën e saj nr. 1112/18 Prot., datë 09.03.2022, konstatohet se pjesa më me peshë e tyre nuk është zbatuar dhe nuk rikërkohen si rekomandime të pa zbatuara pasi zbatimi i tyre pasi janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual janë rekomandimet:

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Vau Dejës të merren masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse.

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Vau Dejës të merren masa që planifikimi i procedurave për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të ardhurave, kjo për të ulur në maksimum vlerën e kreditorëve (faturave të palikujduara), në fund të periudhës, duke planifikuar shpenzimet më të domosdoshme për nevojat e bashkisë Vau i Dejës.

3.1. Rekomandimi: Bashkia Vau Dejës, gjatë hartimit të buxhetit, të planifikojë saktë treguesit e planit të të ardhurave mbi baza reale, të kryejë në mënyrë të saktë. Gjithashtu të monitorohet ecuria e të ardhurave, duke vlerësuar rrisqet që mund të ndikojnë në mosrealizimin e vlerës së planifikuar dhe mbi bazën e tyre.

4.1. Rekomandimi: Sektori i Financës në bashkëpunim me Sektorin e të Ardhurave të merren masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore në fund të vitit ushtrimor 2020 në vlerën 69,523,827 lekë.

4.2.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Sektorin Juridike , të marrë masat e nevojshme për arkëtimin e vlerave debitorë të krijuar gjatë periudhës 2018-2020, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme ligjore si dhe kontabilizimin e gjobave të vendosura nga IMTV-ja në fund të vitit 2020 në vlerën **5,720,000 lekë**.

4.3. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Sektorin Juridike të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e tyre.

5.1. Rekomandimi: Nga nëpunësi zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” ,veprimet e sistemuere të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2021.

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektmeve prej **50,049,802 lekë**, sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij. Për këtë të kreditohet llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për kryerjen e inventarizimit të AAGJM, të krijojë dhe të mbajë regjistrin analitik aktiveve, ku të përmbajë të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vendndodhjen, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

7.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të marr masa për përlllogaritjen e saktë të amortizimit, aktiv për aktiv sipas të dhënave regjistrit të aktiveve, duke aplikuar normat e amortizimit të miratuara me qëllim saktësimin e vlerës së mbetur të AAGJ dhe reflektimi i të gjithë ndryshimeve në kontabilitet nëpërmjet sistemeve kontabël, duke pasqyruar saktë dhe realisht gjendjet e AAGJ në llogaritë përkatëse të klasës 20 dhe 21 në pasqyrat financiare.

9.1. Rekomandimi: Nga nëpunësi zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësjiellës Kanalizime Vau Dejës

Sh.a me vlerë 350,812,349 lekë, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkëpunim me Sektorin e Urbanistikës të evidentojë subjektet të cilat kanë shlyer detyrimin për të cilin ju është ngurtësuar vlera 5% e garancisë së punimeve dhe të bëjë likuidimin e kësaj vlere për subjektet.

11.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të ngrëjë grup pune me specialist të fushës për evidentimin e të gjitha aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (AQT) të cilat janë pasuri e Bashkisë, duke evidentuar statusin dhe gjendjen e tyre faktike në teren.

11.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me strukturat e tjera të bashkisë të plotësojë regjistrin e të gjitha aktiveve sipas llogarive përkatëse, i cili të jetë elektronikë dhe shkresor dhe të marrë masa për regjistrimin e pronave në ASHK dhe kontabilitet

Rekomandimet të cilat i rikërkohen për zbatim Bashkisë Vau Dejës në përfundim të auditimit të kësaj pike të programit të auditimit janë:

14.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa që në të ardhmen të lidhë kontrata pasi të jetë bërë sigurimi i kontratës, si kusht i kërkuar në DST, me qëllim realizimin e kontratës në kohë dhe me cilësi.

14.2.Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të 126, datë 04.04.2022, “Për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të auditimit të KLSH- së”, Njësia e Prokurimit ka marrë masa që në procedurat e prokurimit të lidhura janë bërë pasi është bërë sigurimi i kontratës “ Njësia e prokurimit ka marrë parasysh të gjitha rekomandimet e bëra nga KLSH-ja, duke i pasqyruar në DST e publikuara në SPE gjatë vitit 2022.

Në proces zbatimi

15.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa që në të ardhmen të mos përsëriten situata si në 2 rastet e mësipërme ku pretendohet se janë tërhequr nga procedurat sipas raportit përmbledhës këta operatorë ekonomikë, të cilët kanë paraqitur oferta me vlerë më të favorshme ekonomike, pasi tërheqja rezultoi e dokumentuar vetëm në raportin përmbledhës dhe çdo dokumentacion apo procedurë mbetet vetëm në nivel deklarami.

15.2.Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të 126, datë 04.04.2022, “Për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të auditimit të KLSH- së”, Njësia e Prokurimit ka marrë masa që në procedurat e prokurimit ku OE që tërhiqen nga procedura e prokurimit “ Të arshivohen dokumentacionet e tërheqës nga procedura”. Njësia e prokurimit ka marrë parasysh të gjitha rekomandimet e bëra nga KLSH-ja, duke i pasqyruar në DST e publikuara në SPE gjatë vitit 2022.

Në proces zbatimi

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në Ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të Ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, dhe pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e

Titullarit të njësisë publike (Bashkia Vau Dejës), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, si dhe nga Nëpunësi zbatues të ndiqet procesi me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **7,298,450 lekë** si më poshtë:

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës, të merren masa për të pajisur subjektet me liçenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë dhe të arkëtojë tarifat e plota për subjektet që kanë bërë pagesa pjesore për paisje me autorizime, për shumën debitore prej **6,320,000 lekë** sipas aneksit nr. A28 bashkëlidhur raportit të auditimit. Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për liçencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së liçencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

1.1.Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhërin nr. 127, datë 04.04.2022, ka urdhëruar marrjen e masave për paisjen e subjekteve me liçensa sipas rekomandimit të lënë nga KLSH. Urdhri është nxjerrë brenda afatit 20 ditor për marrjen e masave për zbatimin e rekomanimeve të KLSH-së.

Më gjerësishtë ky rekomandim është prajtuar në akt konstatimin nr. 5 datë 23.12.2022.

Pa Zbatuar

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **“Rikonstruksion + shtesë e Shkollës së Bashkuar Hajmel”**, Bashkia Vau i Dejës, me vlerë të kontratës (me tvsh) 84,245,750 lekë, fituar nga OE “J.” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 658,500 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 46/10 prot datë 19.10.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Vau i Dejës dhe OE “J.” SHPK.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 3.1., faqe 66-111 të Raportit të Auditimit)

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **658,500 lekë pa TVSH** nga OE “Junik” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 46/10 prot datë 19.10.2018, me objekt “Rikonstruksion + shtesë e Shkollës së Bashkuar Hajmel”, Bashkia Vau i Dejës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

3.2.Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhërin nr. 130, datë 04.04.2022, ka urdhëruar marrjen e masave për arkëtimin e vlerës 658,500 lekë nga OE “J.” SHPK. Urdhri është nxjerrë brenda afatit 20 ditor për marrjen e masave për zbatimin e rekomanimeve të KLSH-së.

Në vazhdim, nga Inspektoriatin i Mbrojtjes së Territorit, është bërë njoftimi i OE “J.” SHPK me vendimin nr. 17, datë 14.07.2022, për arkëtimin e vlerës së dëmit të konstatuar nga KLSH. Në vazhdim nga IMT, me shkresën nr. 5288 Prot., datë 06.12.2022, OE është paditur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër për mos dëmshpërblim të Bashkisë Vau Dejës në vlerën e dëmit të konstatuar nga KLSH. Pas padisë së bërë, edhe OE ka bërë kundërpadi për IMT. Çështja është në proces.

C.1. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE. (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Vau Dejës 8 masa në vlerë 83,662,327 lekë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike, duke rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore të cilat Bashkia Vau Dejës është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhrave si vijon:

1.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Sektorin e taksave dhe tarifave vendore të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **984,790 lekë**, duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të paarkëtuara në afat, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve.

Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhërin nr. 133, datë 04.04.2022, ka urdhëruar marrjen e masave për të kontabilizuar detyrimin dhe për të ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej 984,790 lekë, sipas rekomandimit të lënë nga KLSH. Urdhri është nxjerrë brenda afatit 20 ditor për marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së. Në vazhdim, nga strukturat e ngarkuara sipas urdhrin të Kryetarit të Bashkisë, nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

Pa Zbatuar

2.1. Rekomandim: Bashkia Vau i Dejës nëpërmjet bashkëpunimit institucional t'i kërkojë ASHK-së, Drejtoria Shkodër, që të mos lëshojë dhe të mos pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi pranë Bashkisë Vau i Dejës. Drejtoria ekonomike dhe Drejtoria e planifikimit të territorit dhe investimeve publike, të ndjekin procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijoje me masa shtrënguese deri në arkëtimin e kësaj takse nga të gjithë individët e listuar si debitorë në **Pasqyrën A7**, bazuar në legjislacionin tatimor.

Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhërin nr. 135, datë 04.04.2022, ka urdhëruar Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe DPZHT, për ndjekjen e zbatimit të rekomandimit. Në vazhdim, nuk evidentohet të jetë ndjekur ndonjë procedurë nga sektorët e ngarkuar për zbatimin e rekomandimit të KLSH-së.

Pa Zbatuar

3.1. Rekomandim: Sektori i taksave dhe tarifave vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pavjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj **342 subjekteve** debitorë në vlerën prej **22,932,161 lekë** (sipas **Pasqyrës A15** në Anekset e Raportit të Auditimit), bazuar në nenin 70 pika

3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat tatimore” me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

d. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

e. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurose (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” i ndryshuar.

f. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana Drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar dhe Drejtorisë Juridike të Bashkisë Vau i Dejës, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 137, datë 04.04.2022, ka urdhëruar Sektorin e Kontrollit dhe Borxhit tatimor. Në vazhdim, nuk ka asnjë veprim të mëtejshëm pas urdhrin të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës. Gjithashtu nuk ka asnjë masë të marrë nga Kryetari i Bashkisë Vau Dejës për punonjës të ngarkuar për zbatimin e urdhrin.

Pa Zbatuar

4.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës, të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për të hartuar regjistrin e familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse (AKSH dhe Qarku Shkodër). Për familjet fermerë debitorë të nxirren njoftim-vlerësimet e detyrimeve për të gjithë kohën e papaguar për vlerën **9,781,551 lekë** dhe për mospagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative apo penale në strukturat e tjera përkatëse, sipas rastit.

4.2.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa për të propozuar dhe diskutuar në Këshillin Bashkiak kontraktimin e shoqërisë Ujës-jellës Kanalizime Vau i Dejës ShA, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak sipas legjislacionit në fuqi, me synim përmirësimin e vjeljes së detyrimeve nga familjarët.

4.3.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e familjeve ndaj të cilave nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore, të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës debitorë prej **45,529,037 lekë**.

4.4.Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa për të krijuar bazat e të dhënave për subjektet, tarifave apo taksat e të cilave mbledhen nëpërmjet agjentëve tatimorë etj., të kryqëzohet informacioni me institucionet e tjera përkatëse dhe rakordimet të bëhen në fund të çdo muaji sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministri i Financave. Bashkia Vau i Dejës, të bashkërendojë veprimtarinë e saj me institucionet e tjera të linjës, të nisë menjëherë procedurat për të krijuar të plotë regjistrin e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e saj, si dhe të zhvillojë

korrespondencë të rregullt periodike me këto institucione (QKB-në, QKL-në, DRT-në, ASHK-në, etj.) për të evidentuar bizneset që ushtrojnë aktivitet në territorin e saj dhe për të përditësuar bazën ekzistuese të të dhënave.

5.1. Rekomandim: Sektori i taksave dhe tarifave vendore të saktësojë listat e bizneseve të pajisura me leje ndërtimi, për projektet e investimeve të prokuruar për vitet 2019-2020, pavarësisht nëse kanë selinë kryesore jashtë territorit të Bashkisë Vau i Dejës por që ushtrojnë aktivitet me adresë dytësore në këtë territor, si dhe të nxjerrin njoftim detyrimet për taksat dhe tarifat vendore. Sipas listës aneks nr. **A26 dhe A27**, të ndjekin të gjitha procedurave administrative deri në arkëtimin e vlerës prej **89,808 lekë** nga këto detyrime vendore.

Rekomandim mbas verifikimit: Për sa më sipër KLSH i kërkon Titullarit të Bashkisë Vau Dejës ndjekjen me përgjegjësi të procedurave ligjore, për masat e konsideruara të pa zbatuara të cilat janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual me qëllim arkëtimin e vlerës në buxhetin e bashkisë.

D. MASA ADMINISTRATIVE

KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, ti kërkoj Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) ndaj **8 punonjësve, anëtarë të njësisë së prokurimit (hartues të dokumenteve standarde të tenderit), për shkeljet në procedurat e prokurimit, si më poshtë:**

*Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 128, datë 04.04.2022, ka urdhëruar Sektorin e Asistencës Ligjore, për hartimin e shkresave për APP, për vlerësimin e shkeljeve të konstatuara nga raporti i KLSH-së. Urdhri është nxjerrë brenda afatit 20 ditor për marrjen e masave për zbatimin e rekomanimeve të KLSH-së. Në vazhdim, nga strukturat e ngarkuara sipas urdhrin të Kryetarit të Bashkisë, është dërguar pranë APP, shkresa me nr. 2630 Prot., datë 09.05.2022, pjesa atakuuese e raportit përfundimtar të auditimit të KLSH-së, ku i është propozuar APP të vlerësojë shkeljet e konstatuara nga auditimi i Bashkisë Vau Dejës. Në vazhdim, APP, ka dërguar pranë Bashkisë Vau Dejës, vendimin nr. 139, datë 09.12.2022, hyrë në Bashki me shkresën me nr. 6975 Prot., datë 12.12.2022. Në këtë vendim janë propozuar 12 masa administrative nga të cilat 11 masa me gjobë në vlerën **1,090,000 lekë** dhe 1 masë administrative. **Sa më sipër KLSH i kërkon nga Bashkia Vau Dejës ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës 1,090,000 lekë** ndaj 11 punonjësve dhe ndjekjen e procedurave disiplinore për 1 punonjes si vijon:*

Zbatuar realizimi në proces

a) Për 5 anëtarët e njësisë së prokurimit (hartues të dokumenteve standarde të tenderit):

1. Znj. M. Gj., me detyrë, ish Përgjegjëse në Drejtorin Juridike dhe Asetet Publike. Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mase administrative me gjobë në vlerën 60,000 lekë

2. Znj. A. G., me detyrë ish Specialiste në Sektorin e Investimeve. Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mase administrative me gjobë në vlerën 90,000 lekë

3. Znj. S. Ç., me detyrë ish specialiste protokolli. Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mase administrative me gjobë në vlerën 100,000 lekë

4. Znj. K.Sh., me detyrë Përgjegjëse në Sektorin Ligjor Nj/A Bushat. Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mase administrative me gjobë në vlerën 100,000 lekë

5. Z. I. G., me detyrë ish Përgjegjës në Sektorin e Urbanistikes dhe Menaxhimit të Territorit. Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur ti propozoj titullari të AK marrjen e masës disiplinor për mangësite në lidhje me argumentimin e kriterëve.

b) Për 7 anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit publik me objekt si vijon:

1. Znj. E.N., me detyrë ish Përgjegjëse në sektorin e Rregjistrimit dhe Kontabilizimit. Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mas administrative me gjoë në vlerën 150,000 lekë

2. Znj. Sh. K., me detyrë ish Specialiste në Drejtorin Juridike dhe Asetet Publike Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mase administrative me gjoë në vlerën 120,000 lekë

3. Znj. J.M., me detyrë Specialist urbanistike arkitekt, Nj/A Bushat. Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mase administrative me gjobë në vlerën 110,000 lekë

4. Z. E. H., me detyrë Specialist hartograf NJ/A Bushat. Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mase administrative me gjobë në vlerën 120,000 lekë

5. Znj. K.Sh., me detyrë Përgjegjëse në Sektorin Ligjor Nj/A Bushat. Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mase administrative me gjobë në vlerën 100,000 lekë

6. Znj. A. Sh., me detyrë Drejtoresh në Drejtorin e Planifikimit Urban dhe Investimeve Publike. Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mase administrative me gjobë në vlerën 100,000 lekë

7. Z. E. M., me detyrë Specialist në Sektori i Investimeve dhe Projekteve Publike. Nga verifikimi rezulton se APP me vendimin nr. 139, datë 09.12.2022 ka vendosur mas administrative me gjoë në vlerën 70,000 lekë

D.2 Për Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV).

Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i ka rekomanduar, Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Vau i Dejës, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të bëjë propozimin për fillimin e procedurës disiplinore për:

1. Znj. S. K., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në kontratën nr. 46/10 prot datë 19.10.2018 me objekt *“Rikonstruksion + shtesë e Shkollës së Bashkuar Hajmel”*, Bashkia Vau i Dejës, me sipërmarrës punimesh OE “J.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 658,500 lekë pa TVSH, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

2. Znj. G. K., në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në kontratën nr. 46/10 prot datë 19.10.2018 me objekt *“Rikonstruksion + shtesë e Shkollës së Bashkuar Hajmel”*, Bashkia Vau i Dejës, me sipërmarrës punimesh OE “J.” SHPK, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 658,500 lekë pa TVSH, si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 283, datë 04.04.2022, ka urdhëruar IMT, për ekzekutimin e rekomandimeve të mësipërme. Në vazhdim, IMT ka gjositur dy mbikëqyrësat përkatësisht Znj. Syme Koci dhe Znj. Greta Kapcari, për shkeljet e konstatuara nga auditimi i kryar. Pas vendimeve të IMT me nr. 14 dhe nr. 15, datë 12.07.2022, nuk ka asnjë dokument të dorëzuar pranë grupit të auditimit për të vërtetuar realizimin e rekomandimit.

Në proces zbatim

Rekomandim mbas verifikimit: Për sa më sipër KLSH i kërkon Titullarit të Bashkisë Vau Dejës ndjekjen me përgjegjësi të procedurave ligjore, të konsideruara në proces zbatimi, me qëllim arkëtimin e vlerës në buxhetin e bashkisë.

Kriteri:

Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa j), ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin” me ndryshime,

Shkaku:

Mos ndjekja e gjitha procedurave për të bërë të mundur arkëtimin e vlerës 1,748,500 lekë.

Ndikimi/Efekti:

Ndikon në të ardhurat e buxhetit të Bashkisë Vau Dejës.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandim:

Kryetari i Bashkisë Vau Dejës të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përsheptuara për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të pa zbatuara dhe në proces zbatimi si vijon;

Për 2 masa organizative të cilat janë konsideruar në proces zbatimi (renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm):

14.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa që në të ardhmen të lidhë kontrata pasi të jetë bërë sigurimi i kontratës, si kusht i kërkuar në DST, me qëllim realizimin e kontratës në kohë dhe me cilësi.

15.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa që në të ardhmen të mos përsëriten situata si në 2 rastet e mësipërme ku pretendohet se janë tërhequr nga procedurat sipas raportit përmbledhës këta operatorë ekonomikë, të cilët kanë paraqitur oferta me vlerë më të favorshme ekonomike, pasi tërheqja rezultoi e dokumentuar vetëm në raportin përmbledhës dhe çdo dokumentacion apo procedurë mbetet vetëm në nivel deklarimi.

Për 1 masë shpërblim dëmi në vlerën 658,500 lekë si vijon:

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **658,500 lekë pa TVSH** nga OE “J.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 46/10 prot datë 19.10.2018, me objekt “Rikonstruksion + shtesë e Shkollës së Bashkuar Hajmel”, Bashkia Vau i Dejës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Për 12 masa administrative nga të cilat 11 masa me gjobë në vlerën 1,090,000 lekë dhe 1 masë disiplinore si vijon:

Për 5 anëtarët e njësisë së prokurimit (hartues të dokumenteve standarde të tenderit):

- 1. Znj. M. Gj.,** me detyrë, ish Përgjegjëse në Drejtorin Juridike dhe Asetet Publike *në vlerën 60,000 lekë*
- 2. Znj. A. G.,** me detyrë ish Specialiste në Sektorin e Investimeve *në vlerën 90,000 lekë*
- 3. Znj. S. Ç.,** me detyrë ish specialiste protokolli. *në vlerën 100,000 lekë*
- 4. Znj. K.Sh.,** me detyrë Përgjegjëse në Sektorin Ligjor Nj/A Bushat *në vlerën 100,000 lekë*
- 5. Z. I. G.,** me detyrë ish Përgjegjës në Sektorin e Urbanistikes dhe Menaxhimit të Territorit të vazhdoj procedurat për marjen e masës disiplinore sipas vendimit të APP.

b) Për 7 anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit publik me objekt si vijon:

- 1. Znj. E. N.,** me detyrë ish Përgjegjëse në sektorin e Rregjistrimit dhe Kontabilizimit *në vlerën 150,000 lekë*
- 2. Znj. Sh. K.,** me detyrë ish Specialiste në Drejtorin Juridike dhe Asetet *në vlerën 120,000 lekë*
- 3. Znj. J.M.,** me detyrë Specialist urbanistike arkitekt, Nj/A Bushat *në vlerën 110,000 lekë*
- 4. Z. E. H.,** me detyrë Specialist hartograf NJ/A Bushat *në vlerën 120,000 lekë*
- 5. Znj. K. Sh.,** me detyrë Përgjegjëse në Sektorin Ligjor Nj/A Bushat *në vlerën 100,000 lekë*
- 6. Znj. A.Sh.,** me detyrë Drejtoresh në Drejtorin e Planifikimit Urban dhe Investimeve Publike *në vlerën 100,000 lekë*
- 7. Z. E. M.,** me detyrë Specialist në Sektori i Investimeve dhe Projekteve Publike. *në vlerën 70,000 lekë*

➤ **Në zbatim të pikës 5. të Raportit të Auditimit “Të ndryshme të dala gjatë auditimit”, u auditua:**

- Ankesa e paraqitura nga z. D.N. me emailin e datës 24.11.2021, protokolluar në KLSH me nr.1285 prot., datë 24.11.2021
- Ankesa e paraqitura nga z. D.N., me emailin e datës 19.09.2022, protokolluar në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 856 prot., datë 19.09.2022.
- Procedurat e ndjekura nga Bashkia Vau Dejës
- Të tjera dokumente mbështetëse.

Kronologjia e ngjarjes parashtruar nga z. D. N.:

Në Nëntor të vitit 2015 jam emëruar si Inspektor i zhvillimit, emërimi është bere me konkurrim, pasi ka kaluar 1 vit pune, jam dërguar për statusin e nëpunësit dhe me pas me Vendimi Nr. 49 Date 07.05.2016 jam emëruar si specialist IT. Me date 26.04.2018 jam emëruar si Përgjegjës në Sektorin e Zyrës së Integruar me një Ndalese, ku pas auditimit të KMSHC-së në bashkinë Vau Dejës, për paaftësi të burimeve njerëzore komisioni ka lenë shënim qe janë bere gabime me kontraten time si dhe të shume personave të tjerr, me konkretisht pasqyrohet në Vendimin Nr.39, date 19.04.2019 të KMSHC, ku shprehet se Vendimi i NJMBNJ Nr.45, datë 05.08.2019, "Për shpalljen absolutisht të pavlefshëm të aktit të "Emërimit në detyre Nr.77, date 26.04.2018, për z, D. N." . the me sa kam dijeni unë edhe para një muajt e ca KMSHC-ja ka lënë përsëri disa vrenjtje të tjera tek burimet njerëzore po për të njëjtën gjë sepse ato Skan sistemu dosjet e atyre që të paktën janë aktualisht në punë. Pasi nuk është rregulluar dokumentacioni nga ana e burimeve njerëzore dhe si pasoj e këtyre gabimeve qe nuk kanë lidhje me mua jam shkarkuar nga detyra me VENDIMIN Nr. 286 prot 720 date 18.11.2019 'Për zgjidhjen e kontratës se punës ' nga kryetari i bashkisë, ku ne baze të ligjit për nëpunësit civil vetëm drejtësi i burimeve njerëzore duhet të firmos për largimin nga puna të punonjësit me status.

Ndërkohë që unë jam trajtuar me Kod Pune dhe auditi i KMSHC ka lënë disa here detyre për ta rregulluar kontratën time të punës, burimet njerëzore kanë vazhduar duke i faturuar gabimet ose shkeljet tek unë si punonjës, në një kohe kur nuk ishte detyre e imja te sistemoja dosjen.

Jam drejtuar gjykatës se Shkodrës dhe ajo ka pranuar kërkesën e padis duke me dhen të drejte me Nr. Vendimi 276 (1144), date 04.03.2020 për largimin duke e marr si të pjesshëm padinë vetëm për shkeljet ligjore qe ka ber institucioni i Bashkisë.

Titulli i Gjetjes: *Mbi shqyrtimin e ankesës së shtetasi D. N.*

Situata:

Rezultoi se z. D.N. i është drejtuar me krekës padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Shkodër e cila me vendimin nr. 276 (1144) datë 04.03.2020 ka cilësuar si të pa drejtë vendimin e largimit nga detyra duke i caktuar dhe dëmshpërblimin. Nga ana e Bashkisë është bërë kundërshtimi në Gjykatën e Apelit Shkodër e cila me vendimin nr. 463 datë 13.12.2021 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 276 (1144) datë 04.03.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Shkodër. Në përfundim të afatit Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Shkodër ka lëshuar urdhër ekzekutimi nr. 4 datë 19.01.2022 duke njoftuar Bashkinë Vau Dejës mbi urdhrin e ekzekutimi nr. 4 datë 19.01.2022, protokolluar në bashkinë Vau Dejës me shkresën nr. 28.01.2022.

Konstatohet se Bashkia Vau Dejës nuk ka Bërë ekzekutimin vullnetar i vendimin nr. 276 (1144) datë 04.03.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Shkodër lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër e cila me vendimin nr. 463 datë 13.12.2021. Në mungesë të mos ekzekutimit vullnetar të detyrimit z. D. N. i është drejtuar zyrës së përbarimit e cila me vendimin nr. 816 regj datë 22.04.2022 ka vendosur kalimin në ekzekutim të detyrueshëm duke e ngarkuar bashkinë dhe me tarifën përbarimore në masën 119,102 lekë vlerë e cila konsiderohet efekt negativ në të ardhurat e bashkisë. për zbatimin e vendimit gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve z. D. N., për vitin 2022 Bashkia ka shpenzuar vlerën 1,333,942 lekë, e cila përbënë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur, konkretisht për likuidimin e subjektit z. D. N., në urdhrin nr.190, datë 04.05.2022 të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna të subjektit z. D. N., moslikujdimit në kohë të detyrimit pa krijuar shpenzime të

përmbartimit) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Vau Dejës. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendit gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësi administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore dhe si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *Sa me sipër me veprime dhe mosveprime ngarkohet me përgjegjësi z. B. M. me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore; znj. K. Sh. me detyrë Përgjegjëse e Asistences Ligjore, Kontratave dhe Çështjeve Gjyqësore.*

Kriteri:

Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Krijimi i detyrimeve të prapambetura, të cilat ndikojnë negativisht në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës, si dhe 1,333,942 lekë, shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit rregullator të fushës.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimin e shtetasi D. N., si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjes së mësipërme pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Për sa është trajtuar në raport, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 39. datë 05.01.2022, nga z. B. M. në cilësinë e Drejtorit të Burimeve Njerëzore, protokolluar në KLSH me nr.1112/21 datë 16.01.2023. si dhe me shkresën nr 1680 prot datë 03.03.2023 protokolluar në KLSH me shkresën nr. 08.03.2023 ka ripërsëritur observacionet e akt konstatimeve, ku janë shprehur komentet si më poshtë:

Observacion nga Subjekti i audituar:Drejtoria e Burimeve Njerëzore është njohur me akt-verifikimin Tuaj të auditit nëpërmjet e-mail zyrtar me datë 29.12.2022 për të cilat paraqesim observacionin tonë kundër këtij akti si më poshtë vijon:

1. Lidhura nga sa thuhet në akt-verifikimin tuaj përsa i përket personit përgjegjës për mosveprime në lidhje me largimin nga puna të z. D. N., grupi i auditit ka dalë me konkluzione të gabuara duke berë si person përgjegjës Drejtorin e Burimeve Njerëzore z. B. M. pa bërë një hetim të plotë të akteve administrative që disponon NJMBNJ.

2. Nuk është e vërtete ajo që pretendon subjekti juaj i ankimit z, D.N. kurë thotë se vendin e tij të punës ai e ka fituar me procedura të rregullta konkurrimi sipas dispozitave të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil" i ndryshuar, i emëruar në nëntor 2015, si "Inspektor Zhvillimi", pasi në 2015 në Bashkinë Vau Dejës nuk është zhvilluar asnjë procedure konkurrim për vende punë në shërbimin

civil, pasi me bashkimin e komunave në Bashkinë Vau Dejës është operuar me strukture tranzitore 1.8.2015-31.12.2015.

3. Në vendimin e kryetarit të bashkisë nr.49, datë 07.05.2016, thuhet se z. D.N. lirohet nga detyra e "inspektorit të Zhvillimit" dhe në piken 2 të këtij akti thuhet se z. D. N. emërohet në pozicionin e "Punonjësit të IT Web" në Bashkinë vau Dejës (vend pune në shërbimin civil)

4. Me vendimin e Zv/Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës nr.77, datë 26.4.2018, në kapërcim të kompetencave ligjore dhe në shkelje të ligjit z. D. N. është emëruar në pozicionin: "Përgjegjës në Sektorin e Zyrës së Integruar me një Ndalesë", pa zhvilluar asnjë procedurë konkurrimi dhe me nivel diplome "bachelor"

5. Ju bëjmë me dije se NJMBNJ nga 01.01.2016 deri 01.10.2019 ka zhvilluar vetëm një procedurë konkurrimi për nivelin ekzekutiv ku ka shpallur 62 vende të lira pune, proces i cili është përmbyllur me datë 30.06.2016 (bashkëlidhur lista emërore e pjesëmarrësve), ku emiri i z. D.N. nuk gjendet në këtë listë. Në maj 2016 kanë konkurruar 22 persona për vende të lira pune në nivel ekzekutiv nga të cilët kanë fletuar 12 persona (shih shpalljet në shërbimin kombëtar të punësimit).

6. Gjithashtu nuk rezulton që z. D. N. të ketë përfituar statusin e nëpunësit civil për shkak të ligjit "për nëpunësin civil", ligj i cili i ka filluar efektet ligjorë me datë 26.02.2014, pasi ai ka filluar punë me datë 1.11.2015.

7. Referuar asaj çfarë thuhet me sipër të dyja emërimet në detyrë të sipërcituara, kanë dalë në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së aktit administrativ, referuar parashikimeve të legjislacionit në fuqi, çka në vështrim të nenit 108, pika 1 dhe 2 të shkronjës a të ligjit nr.44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të RSH", i bën këto akte absolutisht të pavlefshme.

8. Për më tepër ndalimi i emërimit në kundërshtim me procedurën, është theksuar shprehimisht në piken 4, të nenit 23, të ligjit nr. 153/2013, "Për Nëpunësin Civil" të ndryshuar, për të mos lejuar subjektivitet apo keqinterpretime në interpretimin e kësaj dispozite në praktikë.

9. Në vijim të këtij arsyesimi, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të RSH", veprimi administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo i tillë.

10. Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka realizuar mbikëqyrjen e përgjithshme në Bashkinë Vau Dejës në lidhje me zbatimin e "Ligjit për shërbimin civil", proces i cili ka filluar me datë 04.07.2018 dhe është mbyllur me datë 22.10.2019.

11. Në fundmi i kërkojmë Grupit të auditit që pasi të shqyrtoje edhe një herë aktet administrative të sipërcituara nga ana jonë të reflektojë në raportin e saj përfundimtar në lidhje me personin përgjegjës për largimin e z. D. N. nga puna, pasi personat përgjegjës direkt dhe në shkelje flagrante të ligjit me pasojë për institucionin janë Kryetari dhe Zv/Kryetari i Bashkisë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Lidhur me Observacionet e paraqitura nga z. B. M. nuk do të meren në konsideratë pasi.

Së pari Z. D.N. me Vendimi Nr. 49 Date 07.05.2016 është emëruar si specialist IT.

Së dyti pretendimet e ngritura nga z. B. M. janë parashtruar në konkluzionet e gjykatës për të cilat gjykata me vendimin nr. 276 (1144) datë 04.03.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Shkodër ka konstatuar pavlefshmëri në largimin nga detyra të z. D.N. e lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër.

V. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE:

1.Gjetje nga auditimi: Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konstatohet se nga Bashkia Vau Dejës, nuk ka njohje dhe nuk është zbatuar ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, konkretisht:

-Nuk është ngritur një sistem efektiv i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, gjë e cila është reflektuar në mangësinë e plotë të rregullave të shkruara për funksionimin e institucionit.

-Nga ana e titullarit nuk është hartuar një strategji e menaxhimit të riskut për vitin 2021, manuali dhe harta e proceseve të punës, gjurma e auditimit e cila duhet të përfshinte të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë.

-Nga ana e nëpunësit autorizues, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut dhe dokumentimin e tij, si dhe nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e këtyre fenomeneve.

-Gjithashtu, u konstatua se një numër i konsiderueshëm punonjësish, kanë rregulluar marrëdhënien e punës sipas dispozitave të Kodit të Punës, ndërkohë që pozicionet e tyre të punës, evidentohen si pozicione me status “Nëpunës Civil” dhe për rrjedhojë rekrutimi i tyre është bërë në kundërshtim me ligjin. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 20, 21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 21-31 të Raportit të Auditimit*)

1.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, të marrë masa të menjëhershme për:

- Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përkrahimit të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësive dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.

- Grupi i Menaxhimit Strategjik, të hartoj strategjia e riskut, regjistri i riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.

- Rregullimin e pozicioneve të punës për punonjësit të cilët sipas ligjit, duhet të trajtohen si “Nëpunës Civilë”, bazuar në ligjin “Për statusin e nëpunësit Civil”, por që janë trajtuar si punonjës me “Kodin e Punës”, si dhe të njoftojë DAP për procedurat e konkurrimit, duke zbatuar procedurat e përcaktuara në ligjin për Nëpunësin Civil.

-Sektori i Burimeve Njerëzore të hartojë programe të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit si dhe vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se struktura organizative e Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 ka funksionuar me **3** (dy) punonjës **1** përgjegjës i njësisë i certifikuar dhe **2** specialist auditit të pa certifikuar si dhe **2** specialist auditit ne proces, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015, “Manualit të Auditimit të Brendshëm” miratuar nga Ministër i Financave nr.100/ 2016 dhe VKM nr.83/2016, përcaktohet qartë që në strukturën e [AB] mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si auditues të brendshëm dhe gjatë afatit 2 vjeçar zhvillon trajnimet e mjaftueshme për t’u certifikuar si dhe Njësia e Auditit të Brendshëm nuk janë respektuar trajnimet e detyrueshme vjetore planifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm

Financiar në MFE/Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në kundërshtim me Ligjin nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, “Manualin e Auditimit të Brendshëm të Sektorit Publik”. Gjithashtu Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Vau Dejës, nuk ka një vlerësim të riskut, dhe për rekomandimet e lëna nuk ka analizuar dhe nuk ka hartuar program të veçantë për shkallën e zbatimit të rekomandimeve të lëna, për të adresuar përgjegjësi si dhe marrje masash për rastet e konstatimeve të problematikave të trajtuar në raportet e auditimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 21-31 të Raportit të Auditimit)*

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës, të marrë masa për plotësimin e strukturës së NJAB konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi duke marrë masa për certifikimin e audituesve të pa certifikuar.

2.2 Rekomandimi: Përgjegjësi i Auditimit Brendshëm të marrë masa për hartimin e Kartës së Auditimit, çeljen e dosjes së përhershme të auditimit si dhe të vendosë dhe të mirëmbaje një sistem për monitorimin e trajtimit të rezultateve të komunikuar menaxhimit sipas Manualit AB.

- Në hartimin e planeve vjetore të planifikohen sektorë me fusha me risk, siç janë zbatimi i procedurave të prokurimit, dhënia e lejeve të ndërtimit/zhvillimit, administrimi i taksave e tarifave vendore, si dhe institucionet e varësisë në Bashkisë Vau Dejës.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta ka vlerën **523,235 mijë lekë**, ndërsa realizimi **404,418 mijë lekë**, ose në masën 77% sipas aneksit nr. 4 pika 2.3 bashkëlidhur raportit të auditimit. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën **455,523 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **84,515 mijë lekë**, ose në masën 19 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Vau Dejës në fillim të vitit buxhetor planifikohen angazhime buxhetore, referuar aneksit nr 1 pika 2.1 bashkëlidhur raportit të auditimit, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifave vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 Gjithashtu konstatohet se gjatë vitit 2021 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2021. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 46 -Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 31-40 të Raportit të Auditimit)*

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë, Sektori i Financës dhe Buxhetit, si dhe Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrin masa për një planifikim të studiuar të buxhetit, duke u mbështetur mbi parashikime të studiuar dhe realiste të të ardhurave. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani shpenzimeve publike, me qëllim që këto shpenzime të kenë burime financimi të sigurt për tu realizuar. Nëse gjatë vitit ka mosrealizim të të ardhurave të planifikuara, atëherë Kryetari i Bashkisë, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi, të kërkojë korrigjimin e buxhetit nga këshilli bashkiak, me qëllim që të mos ketë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Bashkia Vau Dejës në datën 01.01.2021 ka pasur si çelje të vitit ushtrimor detyrime të prapambetura progresive vlerën 44,578 mijë lekë, e cila ka si burim financimi të

ardhurat e veta. Në planin e buxhetit vjetor 2021 nuk është planifikuar likuidim i detyrimeve të prapambetura në kundërshtim me ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. Pra, në datën 31.12.2021 vlera e detyrimeve të prapambetura me burim financimi të ardhurat e veta, krahasuar me këtë vlerë në fillim të vitit ushtrimit (01.01.2021), është ulur me 12,701 mijë lekë, ose në masën prej 28.4%, duke mbetur pa u likuiduar vlera 31,877 mijë lekë. Lista analitike e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2021 në mënyrë të detajuar paraqiten në aneksin nr. 5 pika 2.4 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Rezulton se gjatë vitit 2021 Bashkia Vau Dejës ka planifikuar investime nga të ardhurat e veta në vlerën 76,682 mijë dhe ka realizuar 18,728 mijë lekë.

Për sa më sipër rezulton Bashkia Vau Dejës ka ndërmarrë angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, e cila ka çuar në krijimin e detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 31-40 të Raportit të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës dhe Sektori i Financës dhe Buxhetit të marrin masa për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve brenda afatit 30 ditor nga momenti i ardhjes së faturës. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi të jetë në dispozicion në llogarinë e thesarit të autoritetit kontraktor, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura si dhe të merren masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të krijuara në vitet e mëparshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” për vitin 2021, paraqitet në vlerën 1,550,494 lekë të cilat janë detyrime përpara vitit 2015 të trashëguara nga ish komunat i cili është detyrim i pa definuar, pa dokumentacionin përkatës për t`u paraqitur si detyrim ndaj furnitorëve për mallra shërbime dhe punime të kryera, i mbartur, të cilat konsistojnë me kontrata pa vlerë, pa faturë të thjeshtë tatimore apo faturë tatimore me TVSH apo dhe pa procedurë të mbyllur, në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, kapitulli II, pika 6.

Sipas akt rakordimit të mbajtura midis “Sektorit të ardhurave dhe tarifave vendore” dhe “Sektorit të Financës” sipas shkresës nr. 660 prot., datë 11.02.2022, gjendja debitorë e subjekteve taksapagues privat dhe familjar, janë në vlerën 195,912,670 lekë dhe për 36 kontrata në vlerën 725,742 lekë. Nga analiza e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” konstatohet se vlera 196,638,412 lekë nuk është kontabilizuar në llogarinë e sipërcituar çka ka sjell një nënvlerësim të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në vlerën 196,638,412 lekë. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, aneksi 1, pika 3.3, ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, urdhrin nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.8 “Të ardhurat”, pika 8 e standardit ku përcaktohet njohja fillestare e të ardhurës. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 60-81 të Raportit të Auditimit)

5.1.Rekomandimi: Sektori i Financës në bashkëpunim me Drejtorin e të Ardhurave të merren masat për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore në fund të vitit ushtrimor në vlerën **196,638,412 lekë** sipas evidencave të Drejtorisë të Ardhurave Vendore.

5.2.Rekomandimi: Sektori i Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të vlerësojë rastet e debitorëve pa shpresë arkëtimi dhe të procedojë sipas kërkesave ligjore për sistemimin e vlerave debitorë.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor datë 31.12.2021)” në aktiv të pasqyrave financiare (Formati nr.1), paraqitet në vlerën 430,343 lekë pozicionimi i kësaj llogarie është bërë në mënyrë të gabuar. Pasi kjo llogari përbëhet nga detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2021 të cilat trashëgohen në vitin 2022, e cila në analizë përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën 39,766,988 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 14,719,865 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 947,426 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 4,379,413 lekë, llog. 436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 601,918 lekë, çka ka sjell një nënvlerësim të llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin” në vlerë 59,985,267 lekë, veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjin 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 6, neni 10 dhe 11, Udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 32 e tij. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 60-81 të Raportit të Auditimit)

6.1.Rekomandime: Nga Bashkia Vau Dejës, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 4342 Operacione me shtetin” dhe kundër partisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” Veprimet e sistemuese të bëhen me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 61,220,902 lekë. sipas akt rakordimit me degën e thesarit Shkodër e analizuar sipas të dhënave kontabël në aneksin nr. 2 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Rezulton: Sipas të dhënave kontabël të paraqitura sipas kostos historike, dhe sipas inventarizimit kontabël kjo llogari është e analizuar në 40 raste në vlerën 61,220,902 lekë Në analizë të llog. 202 llogari “Studime dhe Kërkime” konstatohet se vlera e mbetur në fund të vitit 2021 prej 61,220,902 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për 40 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 60-81 të Raportit të Auditimit)

7.1. Rekomandimi Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Vau Dejës të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime” dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare dërguar në degën e thesarit Shkodër me shkresën nr. 1641 prot., datë 30.03.2022 si dhe akt rkordimet me degën e thesarit konstatohet se vlera e paraqitur në llogaritë e poshtëpërmendura është e njëjtë me vlerën e rakorduar me degën e thesarit. Nga analiza e llogarive konstatohet se:-Llogaria **210 “Toka, Troje, Terrene”** në datën 31.12.2020, paraqitet në vlerën 6,208,378 lekë, në 31.12.2021 paraqitet po në vlerën 6,208,378 lekë e pa ndryshuar. -Llogaria 211 *“Pyje kullota plantacione”* më 31.12.2020 paraqitet për vlerën kontabël historike 113,039,105 **lekë** dhe më 31.12.2021 paraqitet po në vlerën 113,039,105 lekë e pa ndryshuar. -Llogaria **212 “Ndërtime e konstruksione”** më 31.12.2021, paraqitet në vlerën 1,787,556,508, lekë. -Llogaria **213 “Rrugë, rrjete vepra ujore”** më 31.12.2020, paraqitet në vlerën 2,082,261,462 lekë, më 31.12.2021 gjendja e kësaj llogarie rezulton 2,123,426,367 lekë, e cila përfaqëson vlerën e investimeve të kryera ndër vite për rrugë, rrjete dhe vepra ujore si dhe shtesat gjatë periudhës raportuese. -Llogaria . **214 “Instalime teknike, makineri e paisje”**, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Vau Dejës dhe ish Komunat, në fund të vitit 2020 rezulton për vlerën 46,937,264 lekë dhe në fund të vitit 2021 për vlerën 52,920,775 lekë.-Llogaria. **215“Mjete transporti”**, e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Vau Dejës dhe ish Komunat, në fund të vitit 2020 rezulton për vlerën 35,829,016 lekë dhe në fund të vitit 2021 për vlerën 42,732,433 lekë.-Llogaria **218 “Inventar ekonomik”** e cila pasqyron gjendjen e llogarisë për Bashkinë Vau Dejës dhe ish Komunat, në fund të vitit 2020 rezulton për vlerën 105,773,478 lekë dhe në fund të vitit 2021 për vlerën 105,773,478 lekë e pa ndryshuar

Vlera e këtyre zërave në pasqyrën e pozionit financiar 2021, është marrë bruto nga pasqyrat financiare. Nuk ka një regjistër kontabël ku të specifikohen analitikët e këtyre zërave si dhe nuk ka informacioni për secilin aktiv në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Duke qenë se nuk ka një regjistër kontabël, nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur behet inventarizimi fizik çdo vit për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet.

Spektori i financës nuk disponon dokumente analitike justifikuese për të dokumentuar dhe vërtetuar vlerën e pasqyruar në pasqyrat e pozicionit financiar, të vitit 2021, Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”*, kapitulli II, pika 6; 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, nënpika 2.1, paragrafi, -Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit 20, "Aktive afatgjata materiale" dhe pika 33. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 60-81 të Raportit të Auditimit)*

8.1.Rekomandim:Spektori Ekonomike në Bashkinë Vau Dejës të marrë masa për kryerjen e inventarizimit të AAGJM, të krijojë dhe të mbajë regjistrin analitik aktiveve, ku të përmbajë të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vendndodhjen, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

8.2.Rekomandim:Të kryejë veprimet për përlllogaritjen e saktë të amortizimit aktiv për aktiv sipas të dhënave regjistrit të aktiveve, duke aplikuar normat e amortizimit të miratuara me qëllim saktësimin e vlerës së mbetur të AAGJ dhe reflektimi i të gjithë ndryshimeve në kontabilitet nëpërmjet sistemeve kontabël, duke pasqyruar saktë dhe realisht gjendjet e AAGJ në llogaritë përkatëse të klasës 20 dhe 21 në pasqyrat financiare.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Llogaria 26 “Aktive afatgjata Financiare”, sipas pasqyrës financiare paraqitet me vlerë zero lekë për periudhën objekt auditimi. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Bashkia Vau Dejës, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 31/12/2021 paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të Ujësjetllës Kanalizime Vau Dejës SHA me NUIS “L...M” e cila është shoqëri aksionare me objekt “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyre”. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi”. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 350,812 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 350,812,349 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Vau Dejës në “Ujësjetllës Kanalizime Vau Dejës SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2021, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 60-81 të Raportit të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Bashkia Vau Dejës, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues të merren masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësjetllës Kanalizime Vau Dejës Sh.a me vlerë 350,812,349 lekë, në debi të llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” më 31.12.2020, paraqitet në vlerën **39,862,041 lekë**, ndërsa më 31.12.2021 paraqitet në vlerën **40,737,035 lekë**. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se: Drejtoria e Financës nuk disponon listën analitike për sa janë kontabilizuar në debi të llogarisë 466 “Kreditor për mjete në ruajtje” Mungesa e këtij afati, nuk jep mundësi për ndjekjen e grafikut të kthimit të garancisë për investimet e marra në dorëzim në mënyrë përfundimtare dhe evidentimin e investimeve të pa përfunduara ende, të cilat konsistojnë me kontrata pa vlerë, pa faturë të thjeshtë tatimore apo faturë tatimore me TVSH apo dhe pa procedurë të mbyllur. *Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshur, Kap. III, pikat 30, 50. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 60-81 të Raportit të Auditimit)*

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkëpunim me Sektorin e Urbanistikës të evidentojë subjektet të cilat kanë shlyer detyrimin për të cilin ju është ngurtësuar vlera 5% e garancisë së punimeve dhe të bëjë likuidimin e kësaj vlere për subjektet.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Rezultoi se, për periudhën objekt auditimi janë certifikuar në total 10 prona sipas tabelës së sipërcituar si dhe për vitit 2020 janë certifikuar 35 prona objekte inventari në ndërtesa e konstruksione të administruara llog.(212) pasuri e paluajtshme (sasi e vlerë) pjesa e

konsiderueshme e tyre prej 4860 prona (trajtuar analitikisht) nuk janë të regjistruara në kontabilitet dhe pasqyrat financiare në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, pasi 153 objekte janë të trashëguara nga (ish/komunat) Konstatohet se sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga sektori i aseteve, u konstatua se një pjesë e pronave janë regjistruar nga Bashkia Vau Dejës në Drejtorinë rajoneve të ASHK Vau Dejës, por pa vlerë. Kështu gjithsej janë regjistruar 45 prona por pa vlerë, gjë e cila vështirëson procesin e kontabilizimit në pasqyrat financiare si asetet të Bashkisë Vau Dejës. Për rrjedhojë kontabilizimi i AAM, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur. Në mënyrë të detajuar prona të certifikuar nga Bashkia Vau Dejës pasqyrohen në Aneksin nr. 4 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit. Veprime dhe mosveprime e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe veprim në mospërputhje me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe Kreu (II), pika (16). (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 60-81 të Raportit të Auditimit)

11.1.Rekomandimi Sektori i Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të ndërmarr të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin 45 prona të certifikuar në ASHK Shkodër, por pa vlerë respektive si dhe paraqitjen e vlerës së këtyre aktiveve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të njësisë publike vendore Bashkia Vau Dejës sipas aneksit nr. 4 pika 3 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi Rezulton se për vitin 2021 Bashkia Vau Dejës nuk ka kryer procesin e inventarizimit çka do të thotë që llogaritë analitike janë mbyllur sipas ditarit kontabël pa rakorduar me gjendjen fizike. Konstatohet se nga nëpunësi zbatues nuk janë marrë masa për hartimin dhe mbajtjen e regjistrit të aktiveve të njësisë, duke specifikuar në mënyrë analitike secilin aktiv, me informacione në lidhje me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e s’ kadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia si dhe nuk janë marrë masa për nxjerrjen e urdhrave për krijimin e komisioneve për inventarizim e menjëhershëm të Aktiveve Afatgjata Materiale të pa inventarizuara deri më sot respektivisht; për llogaritë 32- “Inventar i imet”, 202- “Studime dhe kërkime”, 210- “Toka, Troje, Terrene”, 211 – “Pyje, Plantacione” llog 212- “Ndërtesa e Konstruksione”, 213- “Rruge, Rrjete dhe Vepra. Ujore”, 214 – “Instalime teknike, makineri e pajisje”, 215- “Mjete Transporti”. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, pjesa e parë, “Rregulla të përgjithshme” kapitulli i parë “Mbajtja e kontabilitetit”; UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njësisë që varen prej tyre”, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësisë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj”; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 2, neni 4 ,pika 9 “përgjegjshmëria menaxheriale”, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014, pika 36, pika 52, pika 73, pika 85. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 60-81 të Raportit të Auditimit)

12.1.Rekomandimi: Sektori i Financës në Bashkinë Vau Dejës, të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi rezulton se Bashkia Vau Dejës, ka dërguar në KLSH, planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve me shkresën nr. 1407/1 Prot., datë 04.04.2022, dhe nuk ka raportuar rregullisht në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se: 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 81-114 të Raportit të Auditimit)

13.1. Rekomandim: Bashkia Vau Dejës të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

Menjëherë

14.Gjetje nga auditimi: Në bazë të programit të auditimit nr. 1112/1 prot., datë 01.11.2021 të Kontrollit të Lartë të Shtetit Bashkia Vau Dejës është audituar për periudhën nga data 01.01.2018 deri në datën 30.09.2021. Me shkresën nr. 1112/18 prot., datë 09.03.2022 është dërguar raporti përfundimtar i auditimit. - Nga auditimi aktual u konstatua se

a . Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 19 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 3 masë organizative, në proces zbatimi 5 masa organizative dhe nuk janë zbatuar 11 masa organizative. Nga 16 masa organizative të cilësuar si të pa zbatuara dhe në proces zbatimi 14 prej tyre nuk rikërkohen pasi janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual respektivisht rekomandimet: (1.1, 2.1, 3.1, 4.1, 4.2, 4.3, 5.1, 6.1, 7.1, 7.2, 9.1, 10.1, 11.1 dhe 11.2)

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 3 masa me vlerë 7,298,450 lekë, deri me datë 23.12.2022, është arkëtuar vlera 319,950 lekë është në proces vlera 658,500 lekë dhe nuk është zbatuar vlera 6,320,000 lekë e cila është pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual si dhe rikërkon ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës prej 658,500 lekë pa TVSH nga OE “J.” SHPK.

c.2. Për shpenzime në kundërshtim me principet e 3 E-të është rekomanduar që të arkëtohet vlera 83,662,327 lekë. vlerë e cila nuk është zbatuar të cilat janë pjesë e rekomandimeve që janë dhënë në përfundim të auditimit aktual me qëllim arkëtimin e vlerës në buxhetin e bashkisë.

d.1. 1 Masë Administrative, I është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, t'i kërkoj Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, apo rekomandimin Autoritetit Kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) ndaj 8 punonjësve, anëtarë të njësisë së prokurimit (hartues të dokumenteve standarde të tenderit), për shkeljet në procedurat e prokurimit. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 128, datë 04.04.2022, ka urdhëruar Sektorin e Asistencës Ligjore, për hartimin e shkresave për APP, për vlerësimin e shkeljeve të konstatuara nga raporti i KLSH-së. Urdhri është nxjerrë brenda afatit 20 ditore

për marrjen e masave për zbatimin e rekomanimeve të KLSH-së. Në vazhdim, nga strukturat e ngarkuara sipas urdhrit të Kryetarit të Bashkisë, është dërguar pranë APP, shkresa me nr. 2630 Prot., datë 09.05.2022, pjesa atakuese e raportit përfundimtar të auditimit të KLSH-së, ku i është propozuar APP të vlerësojë shkeljet e konstatuara nga auditimi i Bashkisë Vau Dejës. Në vazhdim, APP, ka dërguar pranë Bashkisë Vau Dejës, vendimin nr. 139, datë 09.12.2022, hyrë në Bashki me shkresën me nr. 6975 Prot., datë 12.12.2022. Në këtë vendim janë propozuar 12 masa administrative nga të cilat 11 masa me gjobë në vlerën 1,090,000 lekë dhe 1 masë disiplinore. Sa më sipër KLSH i kërkon nga Bashkia Vau Dejës ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore për arkëtimin e vlerës 1,090,000 lekë ndaj 11 punonjësve dhe ndjekjen e procedurave disiplinore për 1 punonjës.

d.2. Masë Administrative, I është rekomanduar, Kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës t'i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Vau i Dejës, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të bëjë propozimin për fillimin e procedurës disiplinore për: 1 mbikëqyrës dhe 1 kolaudator. Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të rekomandimit Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 283, datë 04.04.2022, ka urdhëruar IMT, për ekzekutimin e rekomandimeve të mësipërme. Në vazhdim, IMT ka gjobitur përkatësisht Znj. S. K. dhe Znj. G. K., për shkeljet e konstatuara nga auditimi.. Pas vendimeve të IMT me nr. 14 dhe nr. 15, datë 12.07.2022, nuk ka asnjë dokument të dorëzuar pranë grupit të auditimit për të vërtetuar realizimin e rekomandimit.

e. Masa Disiplinore i është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për 2 punonjës. Nga verifikimi rezultoi se kryetari i Bashkisë nuk ka nxjerr urdhrat për vazhdimin e procedurave për dhënie masë disiplinore për znj. M. Gj. dhe z. A.N.

Sa më sipër rezulton se për disa nga rekomandimet e mësipërme, Bashkia Vau Dejës, nuk ka nxjerrë vendimet ekzekutive por në disa raste është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e vendimeve për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar me padi gjyqësore për arkëtimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk kanë filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e mundshëm të afateve ligjore të kerkimit të dëmit të përcaktuara në nenin 115, të Kodit Civil në R.SH, me ndryshime. *Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nenin 15 germa (c) dhe (ç), si dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin" me ndryshime. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 81-114 të Raportit të Auditimit)*

14.1.Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përshtetshme për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të pa zbatuara dhe në proces zbatimi si vijon;

Për 2 masa organizative të cilat janë konsideruar në proces zbatimi, renditur sipas numrit rendor në shkresën e auditimit të mëparshëm si vijon:

14.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa që në të ardhmen të lidhë kontrata pasi të jetë bërë sigurimi i kontratës, si kusht i kërkuar në DST, me qëllim realizimin e kontratës në kohë dhe me cilësi.

15.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa që në të ardhmen të mos përsëriten situata si në 2 rastet e mësipërme ku pretendohet se janë tërhequr nga procedurat sipas raportit përmbledhës këta operatorë ekonomikë, të cilët kanë paraqitur oferta me vlerë më të

favorshme ekonomike, pasi tërheqja rezulton e dokumentuar vetëm në raportin përmbledhës dhe çdo dokumentacion apo procedurë mbetet vetëm në nivel deklarimi.

Për 1 masë shpërblim dëmi në vlerën 658,500 lekë si vijon

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Vau i Dejës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **658,500 lekë pa TVSH** nga OE “J.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 46/10 prot datë 19.10.2018, me objekt “Rikonstruksion + shtesë e Shkollës së Bashkuar Hajmel”, Bashkia Vau i Dejës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Për 12 masa administrative nga të cilat 11 masa me gjobë në vlerën 1,090,000 lekë dhe 1 masë disiplinore si vijon:

Për 5 anëtarët e njësisë së prokurimit (hartues të dokumenteve standarde të tenderit):

1. Znj. M.Gj., me detyrë, ish Përgjegjëse në Drejtorin Juridike dhe Asetet Publike në vlerën 60,000 lekë

2. Znj. A.G., me detyrë ish Specialiste në Sektorin e Investimeve në vlerën 90,000 lekë

3. Znj. S. Ç., me detyrë ish specialiste protokolli. në vlerën 100,000 lekë

4. Znj. K. Sh., me detyrë Përgjegjëse në Sektorin Ligjor Nj/A Bushat në vlerën 100,000 lekë

5. Z. I. G., me detyrë ish Përgjegjës në Sektorin e Urbanistikës dhe Menaxhimit të Territorit të vazhdoj procedurat për marjen e masës disiplinore sipas vendimit të APP.

b) Për 7 anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit publik me objekt si vijon:

1. Znj. E. N., me detyrë ish Përgjegjëse në sektorin e Regjistrimit dhe Kontabilizimit në vlerën 150,000 lekë.

2. Znj. Sh.K., me detyrë ish Specialiste në Drejtorin Juridike dhe Asetet në vlerën 120,000 lekë.

3. Znj. J. M., me detyrë Specialist urbanistike arkitekt, Nj/A Bushat në vlerën 110,000 lekë.

4. Z. E. H., me detyrë Specialist hartograf NJ/A Bushat në vlerën 120,000 lekë.

5. Znj. K. Sh.me detyrë Përgjegjëse në Sektorin Ligjor Nj/A Bushat në vlerën 100,000 lekë.

6. Znj. A. Sh.me detyrë Drejtoresh në Drejtorin e Planifikimit Urban dhe Investimeve Publike në vlerën 100,000 lekë.

7. Z. E. M., me detyrë Specialist në Sektori i Investimeve dhe Projekteve Publike. në vlerën 70,000 lekë

Menjëherë

B.1. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE. (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1.Gjetje nga auditimi Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura rezulton se Bashkia Vau Dejës për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2021 ka shpenzuar vlerën **639,100 lekë**, për 1 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Gjithashtu konstatohet se për likuidimet e subjekteve të mësipërme janë nxjerrë urdhrat përkatës nga titullari i institucionit, por nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësisë administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe

nxjerrja e përgjegjësi administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me pikën nr. 60, të UMFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 40-60 të Raportit të Auditimit)*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, nuk ka marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, pasi në datën 31.12.2021 rezulton një vlerë e pa arkëtuar prej **195,912 mijë lekë**, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Vau Dejës e krijuar nga mos pagesa e kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe privat, respektivisht; -subjektet fizik/juridik në vlerë 28,844 mijë lekë, si dhe abonentë familjarë në vlerë 167,067 mijë lekë. Ndërsa detyrimet e subjekteve dhe familjarëve të vitit ushtrimor 2021 janë në vlerën 149,765 lekë. Veprimet e mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 40-60 të Raportit të Auditimit)*

2.1. Rekomandimi: Bashkia Vau i Dejës, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimeve të pavjela nga subjektet fizikë/juridikë, për të gjitha detyrimet tatimore të pa mbledhura ndaj evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të pa arkëtuar (debitor), në vlerën **195,912 mijë lekë**, nga e cila: subjekte fizik/juridik në vlerë **28,844 mijë lekë**, si dhe abonentë familjarë në vlerë **167,067 mijë lekë**.

Bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat tatimore” me ndryshime, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

g. T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

h. Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” i ndryshuar.

i. Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i zhvillimit ekonomik të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesve, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar.

Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare bizneset, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet në vite, nga ana Drejtorisë së zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar dhe Drejtorisë Juridike të Bashkisë Vau i Dejës, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet

kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181, “*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*

Menjëherë dhe në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi Rezulton se nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT Shkodër janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ZVRPP (ASHK) Shkodër për periudhën deri më **01.01.2021-31.12.2021**. Sipas listave të vëna në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton se detyrimi për këtë taksë është në vlerën **496,796 lekë** për 15 persona, e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës, sipas aneksit nr. 3 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit. Rezulton se sektori i taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Vau i Dejës nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që jetë drejtuar ASHK-në Shkodër (ish ZVRPP), për shkëmbim informacioni mbi hipotekimin e ndërtimeve informale të pajisura me leje legalizimi dhe për t'i propozuar lidhjen e një aktmarrëveshjeje ndërmjet Bashkisë Vau i Dejës dhe ASHK Rajonale Shkodër. *Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Ligji nr. 9482 datë 03.04.2006, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar; VKB Vau i Dejës “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në territorin e bashkisë Vau i Dejës”, etj. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 40-60 të Raportit të Auditimit)*

3.1Rekomandimi: Drejtoria e Planifikim Urban në bashkëpunim me Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje për vitin 2021 në vlerën **496,796 lekë** ndaj **15** personave si dhe t'i kërkojnë Drejtorisë Rajonale Vendore ASHK Shkodër, vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë, deri në pagesës e taksës së ndikimit në infrastrukturë. - Drejtoria e të Ardhurave të ndjekë procedurat e njoftimit të personave për detyrimet, si dhe të vijoje me masa shtrenguese deri në arkëtimin e kësaj takse në shumën **496,796** lekë, nga të gjithë individët e listuar si debitorë bazuar në legjislacionin tatimor.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi Nga auditimi rezulton se në Bashkinë Vau Dejës gjatë vitit 2021 kanë ushtruar aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikantë dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë 21 subjekte, sipas akeksit 4 pika 2.6 bashkëlidhur rapoartit të auditimit. Nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se 1 subjekt (V. D.), i cili vazhdon të ushtrojë aktivitetin i papajisur me autorizimin përkatës, për të cilin tarifa për pajisjen e mëparshme me licencë tregtimi është ndarë në afat 1 vjeçar. Për këtë rast, nga Bashkia Vau i Dejës është aplikuar në mënyrë të gabuar tarifimi, duke e trajtuar këtë subjekt me pagesë të pjesshme, në vlerën 200,000 lekë, pra me 20% të vlerës së kësaj pagese. Janë pajisur me autorizim 10 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte si dhe nuk është ndërmarr asnjë procedur ligjore për pajisjen me autorizim 5 vjeçar sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017 11 subjekte, **në total vlera e munguar për bashkinë Vau Dejës është 19,300,000 lekë sipas tabelës së sipërcituar**. *Veprime dhe Mosveprime janë në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pikës 1 germës “b” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 40-60 të Raportit të Auditimit)*

4.1.Rekomandimi: Drejtoria e Shërbimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, të ndjekë të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e tarifës së patakshuar prej **19,300,000 lekë** sipas pasqyrës Aneks nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi Në lidhje me auditimin e kryer për realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) të Bashkisë Vau Dejës rezulton se për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Vau Dejës janë vendosur 11 gjoba në vlerën 2,700,000 lekë sipas aneksit nr. 5 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Sa më sipër rezulton se për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Vau Dejës janë vendosur 11 gjoba në vlerën **2,700,000 lekë** nga të cilat është arkëtuar vlera **500,000 lekë** duke mbetur pa u arkëtuar vlera **2,200,000 lekë**, të cilat nuk janë shpallur titull ekzekutiv, por që nuk ka filluar procesi i kërimit të tyre. duke **sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerën prej 2,200,000 lekë.**

Rezultoni se për të gjitha praktikantët IMT-ja, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës, nuk kanë ndjekur të gjitha rrugët ligjore, me qëllimin arkëtimin e detyrimeve, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë Vau Dejës në vlerën prej **2,200,000 lekë**, në kundërshtim me nenin 16, i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", me ndryshime; nenin 15-(Ndryshuar dy fjalitë e para me ligjin nr. 9794, datë 23.7.2007, neni 1)(Ndryshuar fjalia e fundit me ligjin nr. 9826, datë 1.11.2007, neni 2)(Shtuar një paragraf në fund të nenit me ligjin nr.10324, datë 23.9.2010, neni 3); - nenet, 9, 22 dhe 30, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 40-60 të Raportit të Auditimit)

5.1.Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat dhe të kërkojnë në Gjykatë të marrin masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv duke llogaritur edhe kamat vonesat në masën 60% mbi shumën e gjobës së papaguar në vlerën **2,200,000 lekë** sipas aneksit nr. 5 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi Nga auditimi i kontratave të qiradhënies së pasurive të paluajtshme të Bashkisë Vau Dejës me palët e treta, u konstatua se nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe Drejtoria e Bujqësisë, gjatë ushtrimit të funksioneve të veta, nuk janë respektuar plotësisht detyrimet ligjore të fushës (mostarifim të subjekteve për përdorimin e pronave të Bashkisë Vau Dejës, përlllogaritje e gabuar e tarifave, mosaplikim i kamatëvonesave, mungesën e marrjes së masave për arkëtimin e qirave, etj), veprime dhe mosveprime të cilat kanë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vau Dejës në vlerën 4,226,414 lekë. Gjithashtu referuar korrespondencës të zhvilluar midis Bashkisë Vau Dejës dhe shoqëria "SPE Gj." shpk ku në përgjigje të shkresës nr. 1695/1 datë 02.04.2019 të dërguar nga bashkia subjekti "SPE Gj." shpk me shkresën nr. 296 prot datë 05.04.2019, protokolluar në bashki me shkresën nr. 1851 prot datë 09.05.2019 i ka vendosur në dispozicion "Hartën me parcelat pyjore dhe gjurmët e rrugëve ndihmëse si dhe tabelën e detajuar me parcelat dhe gjatësinë e rrugëve ndihmëse për ndërtimin e linjës 110 kv të "HIDROCENTRALEVE NË LUMIN GJADËR" për të cilat nuk është lidhur kontratë për dhënie me qira të ngastra nr. 30 Vig tokë bujqësore me sipërfaqe prej 5.832 ha në kundërshtim me VKB nr.44, datë 21.03.2018 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me

shkresën nr. 891/1 datë 16.07.2018. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenet 154, 296 801 e vijues të Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Pika 5 në nenin 3, pika 1, 5 dhe 6 në nenin 16, shkronja “g” në pikën 1 në nenin 17, shkronja “c” e pikës 1 dhe pika 3 në nenin 25, pikat 1 dhe 2 në nenin 30, pikat 1 dhe 4 në nenin 34, shkronja “a” e pikës 2 në nenin 35, nenin 38 në Ligjin nr.57/2020 “Për pyjet”; Pikat 19 dhe 33 të nenit 2, shkronjën “a” të pikës 3 të nenit 15, pikën 3 të nenit 19, pikën 18 të nenit 21, neni 40/3 në Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar; Pika 2 në VKM nr.391 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM nr.1064, datë 22.12.2010. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 40-60 të Raportit të Auditimit)*

6.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës të analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësitë, si dhe të marrë masa për lidhjen e kontratës me shoqëria “S.P.E. Gj. Sh.p.k për ngastrat nr. 2c, 4b,4c, 41b, 56b, 96c, Mnelë dhe ngastra nr. 30 Vig tokë bujqësore me sipërfaqe prej 6.22 ha për të cilën Bashkia Vau Dejës nuk ka lidhur kontratë sipas VKB nr.44, datë 21.03.2018.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi Rezultoi se z. David Nikaj i është drejtuar me kërkesë padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Shkodër e cila me vendimin nr. 276 (1144) datë 04.03.2020 ka cilësuar si të pa drejtë vendimin e largimit nga detyra duke i caktuar dhe dëmshpërblimin. Nga ana e Bashkisë është bërë kundërshtimi në Gjykatën e Apelit Shkodër e cila me vendimin nr. 463 datë 13.12.2021 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 276 (1144) datë 04.03.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Shkodër. Në përfundim të afatit Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Shkodër ka lëshuar urdhrë ekzekutimi nr. 4 datë 19.01.2022 duke njoftuar Bashkinë Vau Dejës mbi urdhrin e ekzekutimi nr. 4 datë 19.01.2022, protokolluar në bashkinë Vau Dejës me shkresën nr. 28.01.2022.

Konstatohet se Bashkia Vau Dejës nuk ka Bërë ekzekutimin vullnetar i vendimin nr. 276 (1144) datë 04.03.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Shkodër lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër e cila me vendimin nr. 463 datë 13.12.2021. Në mungesë të mos ekzekutimit vullnetar të detyrimit z. D. N. i është drejtuar zyrës së përmbarrimit e cila me vendimin nr. 816 regj datë 22.04.2022 ka vendosur kalimin në ekzekutim të detyrueshëm duke e ngarkuar bashkinë dhe me tarifën përmbarrimore në masën 119,102 lekë vlerë e cila konsiderohet efekt negativ në të ardhurat e bashkisë. për zbatimin e vendimit gjyqësorë me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve z. D. N., për vitin 2022 Bashkia ka shpenzuar vlerën 1,333,942 lekë, e cila përbënë shpenzime pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur, konkretisht për likuidimin e subjektit z. D. N., në urdhrin nr.190, datë 04.05.2022 të Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna të subjektit z. D. N., moslikujdimin në kohë të detyrimit pa krijuar shpenzime të përmbarrimit) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Vau Dejës. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendit gjyqësorë dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore dhe si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqe 115-117 të Raportit të Auditimit)*

7.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Vau Dejës të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga njësia e burimeve njerëzore për largimin e shtetasi . N., si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjes së mësipërme pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

V. ANEKSET

Aneksi nr. 1 pika 2.1 investimet e reja të parashikuara në buxhet viti 2021.

<i>Nr</i>	<i>Emërtimi i investimit</i>	<i>Nr dhe data e VKB</i>	<i>Burimi financimit</i>	<i>Vlera e miratuar në VKB</i>	<i>Vlera e realizuar e investimit (me TVSh)</i>
1	<i>F.V Pajisje per mobilimin e zyrave te administrates</i>	<i>Nr.80dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	960	
2	<i>F.V Kamera sigurie ne administrate</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	1,000	
3	<i>F.V Pajisje komputerike per administrate</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	960	840
4	<i>F.V Kondicionera, paisje ngrohje per administraten</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	960	684
5	<i>Sistemim/meremetim I zyrave ne njesine Administrative Koman</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	960	662
6	<i>Blerje tuba betoni</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	3,600	3,345
7	<i>Sistemim Asfaltim & Ndriçim i Lagjes Lisen, Vau Dejes</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	960	960
8	<i>Rikonstrukcion I rruges Vile, Nj.A Temal</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	5,351	5,119
9	<i>Sistemim Asfaltim & Ndriçim i Lagjes NFP, Vau Dejes</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	960	
10	<i>Sistemim Asfaltim & Ndriçim i Lagjes Mllojë, Vau Dejes</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	960	
11	<i>Sistemim Asfaltim & Ndriçim I rrugës nga kopshti i fëmijeve deri tek pallatet dykatëshe</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	7,866	
12	<i>Sistemim, Asfaltim& Ndriçim i rrugës së Lagjes Pecaj-Shelqet</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	3,725	
13	<i>Shtrim rrugësh ,sistemim ndricim Qendër Bushat</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	1,205	
14	<i>Sistemim & Ndriçim I qendres se fshatit Shkjeze</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	960	
15	<i>Ndertim ure Lagjia Kovac, Hajmel</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	2,419	
16	<i>Sistemim i Qendrës së fshatit Nënshat</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	9,308	
17	<i>Ndërtim Ure mbi lumin Gjadër që lidh Lagjet Kovaç-Kabash dhe Dheulehtë</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	960	
18	<i>Sistemim Asfaltimi ures se Komanit dhe ndriçimi I saj</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	960	
19	<i>Riparim i Pasarelës Lagjia Jakaj</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	960	
20	<i>F.V Kamera sigurie ne qendrat e fshatrave</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	2,600	
21	<i>Ndërtim Ujësjiellësi në fshat që ju shërben 20 familjeve. Fshati Vukaj, Nj.A Shllak</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	1,920	
22	<i>Ndriçimi i qendrës së fshatit Kac</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	960	917
23	<i>Ndriçim i Qendrës së fshatit Plezhe</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	960	913
24	<i>Sistemim& Ndriçim rruga Qender Stajke</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	1,200	
25	<i>Ndriçim I Qendrës së fshatit Ashte</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	960	835
26	<i>Ndriçim rrugor i qendrës së fshatit Plepan Konaj</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	960	866
27	<i>Ndriçimi i rrugëve dhe vendosja e stolave ne fshatin Barbullush</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	960	
28	<i>Ndriçimi I rrugës nga shkolla tek kisha, Dheu I Lehte</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	960	903
29	<i>Ndriçimi i rrugës kryesore nga shkolla tek qendra e fshatit Pistull</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	960	910
30	<i>Sistemim i ambientit tek Ambulanca e fshatit Dheu I Lehte</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	960	826
31	<i>Rikonstrukcioni i Qendrës Shendetsore fshati Narac</i>	<i>Nr.80 dt 24.12.2020</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	2,500	

32	Rikonstruksion I Qendrës Shëndetësore Karme	Nr.80 dt 24.12.2020	Të ardhurat e veta	960	
33	Sistemim dhe rrethim I fushës së sportit ne shkollen Narac	Nr.80 dt 24.12.2020	Të ardhurat e veta	10,915	
34	Riparim çatie në shkollën Vig	Nr.80 dt 24.12.2020	Të ardhurat e veta	960	948
35	Ndërtim shtesë objekti shkolle 9-vjeçare në fshatin Kishë-Arrë	Nr.80 dt 24.12.2020	Të ardhurat e veta	2,914	
Total të ardhurat e veta per vitin 2021				76,682	18,728

Burimi: Drejtoria e financës

Aneksi nr. 2 pika 2.2 tabela e ndryshimeve në buxhet

Në 000 lekë

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve			
	Nr/ datë	Vlera	Nr/ datë	Vlera	Pakësuar artik (me emër)/ shtuar artikull (me emër)			
					SHTESA art.	shuma	PAKSIME art.	shuma
Viti 2020	Nr.92 dt 24.12.2019	805,159	Nr.8 dt 24.01.2020	5,656	606, transferime	5,656	609	5,656
				148	604	148	609	148
				36,528	604	11,610	231, investime	36,528
			Nr.19 dt 06.04.2020		602, operative	11,927		
			Nr.17 dt 25.02.2020	450	606, Transferta	450	609	450
			Nr.15 dt 25.02.2020	585	606, Transferta	585	609	585
			Nr.14 dt 25.02.2020	122	606, Transferta	122	609	122
			Nr.13 dt 25.02.2020	120	606, Transferta	120	609	120
			Nr.27 dt 24.04.2020	188			609	188
			Nr.28 dt 24.04.2020	81	606, Transferta	269	604	81
			Nr.63 dt 26.10.2020	138,449	600,601, paga dhe sigurime	57,052	600,601, paga dhe sigurime	70,329
					604, Transferim	4,913	602, shpenzime operative	27,000
					231, investime	6,155	230,231, projekte dhe investime	41,120
Viti 2021	Nr.80 dt 24.12.2020	823,602	Nr.10 dt 26.02.2021	8,715	231, investime	8,815	231, investime	8,715
			Nr.12 dt 26.02.2021	3,448	600+601 paga dhe sigurime	3,448		
			Nr.21 dt 24.03.2021	1,901	606, tranferte	1,901	604, transferime	1,901
			Nr.22 dt 24.03.2021	91	606, tranferte	91	604, transferime	91
			Nr.55 dt 27.09.2021	147	606, tranferte	147	604, transferime	147
			Nr.47 dt 26.07.2021	239	606, tranferte	239	604, transferime	239
			Nr.52 dt 26.08.2021	2,007	606, tranferte	2,007	604, transferime	2,007
					600, paga	600	600, paga	600
			Nr.34 dt 28.06.2021	5,160	231, investime	4,560	231, investime	4,560

Burimi: Bashkia Vau Dejës

Shenim: Ndryshimet e tjera buxhetesh për bashkinë Vau Dejës për vitin 2021 vetëm brenda grupit të shpenzimeve (brenda Programit 1110 dhe nuk ka qene nevoja për vendim këshilli Bashkiak kjo në mbështetje të Udhëzimit nr.9 dt.20.03.2018”Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit” pika 100 germa “b” dhe “c” ndërmjet zërave të shpenzimeve kapitale, brenda të njëjtit program, miratohen nga Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore, Pra është bërë vetëm me Shtesë nga ana Kryetarit për Degën e Thesarit Shkodër.

Aneksi nr. 3 pika 2.3 Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Vau Dejës, për vitin 2021

Në lekë

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Vau Dejës, për vitin 2021. Në lekë										
Nr	Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi mi ne %	Nga të ardhurat e veta	% e realizimit nga të ardhurat	Nga Granti Qeveritar			
							Nga transferta e pakushtëzuar	Nga transferta e kushtëzuar specifike	Nga transferta e kushtëzuar për	Nga transferta e kushtëzuar për investimet
Burimi i financimit të shpenzimit										

									funksonet e deleguara	
1	Paga600	368,876,525	224,024,927	61%	3,873,992	2%	213,431,076	2,055,000	4,664,859	-
2	Sigurime shoqërore 601	58,310,800	37,141,217	64%	-	0%	36,375,785	-	765,432	-
3	ShP. Operat602+ F. Rezervë	232,338,500	102,683,464	44%	39,654,873	39%	54,064,760	8,963,832		
4	Subvencion Ujësjetësi, etj. 603	9,673,246	6,406,453	66%	6,400,000	100%				
5	K. Q Emergj Civile 604	37,243,391	4,387,135	12%		0%	4,387,135			
6	Nd/Ekonom invalid 606	294,751,000	293,783,520	100%		0%		293,783,520		
7	Mjete ne ruajtje 466									
8	Investime 230-231	455,523,764	84,515,807	19%	37,350,921	44%	8,880,122			38,284,764
9	Shpenzime 605									
10	Interesa kredia 166									
11	Principali 651									
12	Shto, pakso sipas faktit në B.Vau Dejës									
	Totali	1,456,717,226	752,942,523		87,279,786		317,138,878	304,802,352	5,430,291	38,284,764

Burimi: Bashkia Vau Dejës

Aneksi nr. 4 pika 2.3 Planifikimi i shpenzimeve me të ardhurat e veta

Nr.	E M E R T I M I	2021	në lekë
		Vlera për periudhën e raportimit 2021 (Fakt progresiv)	Vlera e Buxhetit vjetor 2021 (Plan)
I	Të ardhurat e Pushtetit Vendor	90,970,579	168,854,000
1	Taksat e veta vendore	28,209,515	54,893,000
a.	Taksa mbi pasurinë	23,183,187	50,763,000
b.	Biznesi i vogel	645,252	30,000
c.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	3,189,038	2,000,000
d.	Taksa të tjera vendore	1,192,038	2,100,000
2	Të ardhura jotatimore	37,439,581	90,351,000
a.	Tarifat e shërbimeve publike	28,996,056	50,552,000
b.	Tarifa administrative	1,691,791	21,469,000
c.	Të tjera jo tatimore	6,751,734	18,330,000
3	Taksa të ndara	25,321,483	23,610,000
a.	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	-	500,000
b.	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	16,115,104	15,000,000
c.	Renta minerare	271,630	10,000
d.	Tatim mbi të ardhurat personale	8,821,979	8,000,000
e.	Të tjera	112,770	100,000
II	Shpenzime te Buxhetit Vendor	404,418,663	523,235,488
1	Shpenzime Korrente	358,187,620	446,552,525
a.	Paga dhe fond i veçantë për paga	217,305,068	243,673,815
b.	Kontributi për Sigurime Shoqërore	36,375,785	41,287,037
d.	Shpenzime Operative	104,506,767	161,591,673
e.	Të tjera korrente		
2	Shpenzime Kapitale	46,231,043	76,682,963
3	Burimet e Financimit	427,352,067	523,235,488
a.	Të ardhurat e veta vendore	90,970,579	186,854,000
b.	Transferta e pakushtezuar	224,556,625	224,556,625
c.	Transferta specifike/transferta e pakushtezuar sektoriale	111,824,863	111,824,863
d.	Të ardhurat e pa-planifikuara (jashtë limit)		
f.	Financimi i huaj		
g.	Huamarrja Vendore Vjetore		

Burimi: Bashkia Vau Dejës

Aneksi nr. 5 pika 2.4 Të dhëna të hollësishme për detyrimet e prapambetura më 31.12.2021 jepen në tabelat në vijim:

Kodi i detyrimit te prapamb.	Emerimi i detyrimit te prapamb.	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2020	Vlera e paguar gjatë vitit 2021 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2021 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2020)	Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2021 (situata më 31.12.2021)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetur pa më 31.12.2021
1	2	3	4	5=3-4	6	7=5+6
28130	NDERTIM I VENDEPOZITIMIT Bushat (FII)	3,870,553	-	3,870,553		3,870,553
28262	rikonstruksion rruga Barbullush QENDER-DEDAJ-VARREZA-KARRAMETAJ-KELMEND-BARDHANJOR,FAT nr 72666637, DT 19.08.2011	4,500,000	4,500,000	-		-
28286	Kerkese padi nr 115 dt 19.11.2015(LEK BIBAJ),Vendim nr 5324 dt 01.10.2014(GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES PARË Tirane),VENDIM NR, 1110(4781) DT 12/10/2018	1,230,000		1,230,000		1,230,000
28288	Vendim nr, 9723 rep 1731 kol 30.05.2013,DHIMITER PAPA	2,112,860		2,112,860		2,112,860
31607	ujesjellesi vaudejes,ft pjesor nr38259530 dt30.09.2020	17,528,773	17,528,773	-		-
32626	ujesjellesi vaudejes,ft pjesor nr38259530 dt30.09.2020	15,336,000	2,471,227	12,864,773		12,864,773
1633	UJESJELLESI VAU DEJES				6,265,565	6,265,565
5315	UJESJELLESI VAU DEJES				4,040,164	4,040,164
5326	SUPERVIZIM PUNIMESH				19,800	19,800
URDP nr 12-ditar 21359	Permiresimi I kushteve te banimit per komunitete te varfera dhe te pafavorizuara				267,642	267,642
URDP nr 19	UJESJELLESI VAU DEJES				1,196,793	1,196,793
URDP nr 22	Supervizim punimesh per objektin Ujesjellesi Vau Dejes				9,000	9,000
	Totali	44,578,186	24,500,000	20,078,186	11,798,964	31,877,150
Detyrime te prapambetura nga FZHR (Ministrite e linjës)				16,735,326	11,798,964	28,534,290
	Detyrime ne total					31,877,150

Burimi: Bashkia Vau Dejës

Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2021 për investimet (Nga të ardhurat e veta)

Nr.	Emërtimi i i Objektivit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Numri dhe data e faturës	Numër serial fature	Vlera e kredisë (detyrimit) ne 31.12.2020	Shtesat gjate vitit 2021	Shlyerjet gjatë vitit 2021	Vlera e detyrimit me 31.12.2021
1	Permiresim I Kushteve Te Banimit Per Komunitetet E Varfera Dhe Te Pafavorizuara Per Vitin 2021 Likuidim I Situacionit Nr.2- Pjesor L. C. Shpk	L.C.	18/10/2021	14/12/2021	14/2021		107,604		107,604
2	Mbikqyrje punimesh ne objektin sitemim i sistemit vadites njesia administrative bushat	A. Shpk	30/07/2021	19/11/2021	5/2021		55,992		55,992
Totali i detyrimit							163,596		163,596

Burimi: Bashkia Vau Dejës

Faturat e pa likuiduara në datën 31.12.2021 për investimet (Nga granti/Transferta e kushtezuar Specifike)

Nr.	Emërtimi i i Objektivit	Emërtimi i Subjektit	Data e lidhjes së kontratës	Numri dhe data e faturës	Numër serial fature	Vlera e kredisë (detyrimit) ne 31.12.2020	Shtesat gjate vitit 2021	Shlyerjet gjatë vitit 2021	Vlera e detyrimit me 31.12.2021
	NDERTIM I VENDEPOZITIMIT Bushat (Fii)	MANDI 1	29.05.2017	19.02.2018	54251560	3,870,553			3,870,553
	rikonstrukcion rruga Barbullush QENDER-DEDAJ-VARREZA-KARRAMETAJ-KELMEND-BARDHANJOR,FAT nr 72666637, DT 19.08.2011	A.B.	20/07/2011	19/08/2011	48	4,500,000		4,500,000	
	ujesjellesi vaudejes,ft pjesor nr38259530 dt30.09.2020	A. B.	29/07/2019	30.09.2020	38259530	17,528,773		17,528,773	
	ujesjellesi vaudejes,ft pjesor nr38259530 dt30.09.2020	A. B.	29/07/2019	30.9.2020	38259530	15,336,000		2,471,227	12,864,773
3	UJESJELLESI VAU DEJES	A.	29.07.2019	30.11.2020	38259532		6,265,565		6,265,565
4	UJESJELLESI VAU DEJES	A.	29.07.2019	31.12.2020	38259538		4,040,164		4,040,164
5	SUPERVIZIM PUNIMESH	P. C.	29.07.2019	31.12.2020	77590599		19,800		19,800
6	Permiresimi I kushteve te banimit per komunitete te varfera dhe te pafavorizuara	A. I. G. C.shpk	28.09.2020	18.02.2021	7/2021		2,446,800	2,179,158	267,642
7	UJESJELLESI VAU DEJES	A.	29.07.2019	29.01.2021	6/2021		1,196,793		1,196,793
8	Supervizim punimesh per objektin Ujesjellesi Vau Dejës	P.C.	29.07.2019	21.04.2021	7/2021		9,000		9,000
9	Ndertim I Vendepozitimit Bushat (Fii)	D. Al Shpk	24.06.2019	29/10/2021	85/2021		10,976,626		10,976,626
10	Permiresim I Kushteve Te Banimit Per Komunitetet E Varfera Dhe Te Pafavorizuara Per Vitin 2021 Likuidim I Situacionit Nr.2- Pjesor L. C. Shpk	L. C.	18.10.2021	14/12/2021	14/2021		92,476		92,476
Totali i detyrimit						41,235,326	25,047,224	26,679,158	39,603,392

Burimi: Bashkia Vau Dejës

Të paraqitet në mënyrë analitike lista e vendimeve gjyqësore të ardhura në financë dhe likuidimet e kryera prej saj për dëmshpërblim page, për punonjësit e larguar nga puna dhe vendime të tjera .

Në lekë

Emri i kreditorit	Vendim Gjykate nr. datë	Objekti i Vendimit	Vlera e detyrimi t sipas Vendimi t te Gjykatës	Gjendja e palikujduar a 31/12/2020	Vendime të ardhura gjatë vitit 2021		Vendime të ardhura gjatë vitit 2022		Detyrimi total	Likujduar ne vitin 2021	Likujduar ne vitin 2022	Gjendja e palikujduarar më 31.12.2021
					Nr dhe data e vendimit	Vlera e vendimit	Nr dhe data e vendimit	Vlera e vendimit				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10=	11	12	13=
P. P.	Nr.4 (27) dt.07.01.2021	Dëmshpërbl im page	639,100	0	Nr.107 dt 23.03.2021	639,100			639,100	639,100		0
D. P.	Nr.5324 dt 01.10.2014	Detyrime kontraktuale	884,402	884,402	Nr.5324 dt 01.10.2014	884,402				884,402		0
E.P.	Nr 246(367) dt 03.05.2019	Detyrime kontraktuale	3,805,000	976,590	Nr 246(367) dt03.05.2019	976,590			976,590	976,590		0
I. K.	Nr.416 (582) dt 09.06.2021	Dëmshpërbl im page	385,576				Nr.416 (582) dt 09.06.2021	385,576			385,576	
L.M.	Nr 51-2021-26 dt 07.01.2021	Dëmshpërbl im page	684,824				Nr 51-2021-26 dt 07.01.2021	684,824			684,824	
D. N.	Nr. 276 (1144) datë 04.03.2020	Dëmshpërbl im page	1,333,942				Nr. 276 (1144) datë 04.03.2020	1,333,942			1,333,942	
A.	NR. 7247 dt 09.11.2021 Shkurtim vendimi	Detyrime kontraktuale	103,841				NR. 7247 dt 09.11.2021 Shkurtim vendimi	103,841			103,841	

Burimi: Bashkia Vau Dejës

Aneksin nr. 1 pika 2.6 **Struktura e Sektorit të taksave dhe tarifave vendore për vitin 2021 paraqitet si vijon;**

Nr.	Emri Mbiemri	Funksioni Sipas Strukturës	Lloji i shkollës	Larte ose i mesëm	Urdhri i emërimit Nr, datë	Urdhri largimit Nr, datë	Pozicioni i punës
a	b	1	2	3	4	5	6
1.	M. Gj.	Pergjegjes	Ekonomik	Larte			Pergjegjes
2	Gj.N.	Specialist	Ekonomik	Larte			Specialiste,biznesi Nj.A V-dejes,kontabilizimi,evidenca, rakordime.
3	G. Rr.	Specialist	Ekonomik	Larte			Specialist,biznesi,Nj.A. Bushat
4	M.M.	Specialiste	Juridik	Larte			Specialiste Kontrata qeraje, pergatitje shkresa,projekt-vendime etj.
5.	A.N.	Specialiste	Ekonomik	Larte			Specialiste taksash familjare, Nj.A. Vau dejes, Temal, Vig-Mnele
6.	R.L.	Specialiste		Larte			Specialiste taksash familje Nj.A. Bushat.
7.	R.Gj.	Specialiste	Ekonomik	Larte			Specialiste, taksa familjare, Nj.A Hajmel, Shllak
8	S.V.	Specialist transporti	Inxhinieri	Larte			Specialist transporti, dhenie certifikate, licenca etj.

Burimi: Bashkia Vau Dejës.

Aneksi nr. 2 pika 2.6 Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave për vitin 2021

LLOJET E TË ARDHURAVE	PLANI	FAKTI	% e REALIZ
TË ARDHURAT NGA BURIMET E VETA GJITHSEJ	186,854	90,970	49
TË ARDHURA TATIMORE/NGA TAKSAT VENDORE	96,504	53,531	55
Të ardhura nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël	-	645	
2% tatimi mbi te ardhurat personale	8,000	8,822	110
Të ardhura nga taksa mbi Biznesin e vogel (e prapambetur)	30	0	0
Te ardhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme	50,764	23,183	46
Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat	20,000	11,172	56
<i>Ndërtesa banimi</i>	<i>12,000</i>	<i>4,008</i>	
<i>Ndërtesa të tjera</i>	<i>8,000</i>	<i>7,164</i>	
Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore	22,238	6,984	31
Te ardhura nga taksa vendore mbi truallin	8,525	5,028	59
<i>Të ardhura nga taksa mbi truallin familje</i>	<i>282</i>	<i>121</i>	
<i>Të ardhura nga taksa mbi truallin biznes</i>	<i>8,243</i>	<i>4,907</i>	
Të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel	100	58	58
Të ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	20,000	3,189	16
Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës pronësisë për pasur e paluajtshme	500	0	0
Të ardhura nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura	15,000	16,115	107
Të ardhura nga taksa e rentës minerare (Grante Nj. Vendore)	10	271	2,710
Të ardhura nga taksa e akteve të pulles	100	113	113
Të ardhura nga taksa e tab.+ reklames	2,000	1,135	57
Të ARDHURAT JOTATIMORE	90,350	37,440	41
Të ardhurat nga Tarifat vendore	72,172	30,688	43
Te ardhura nga tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave	32,686	21,723	66
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga familjet	13,480	6,221	
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga institucione	90	493	
Të ardhura nga tarifë pastrimi nga biznesi	19,116	15,008	

Të ardhura nga tarifa për ndriçimin publik	9,319	3,684	40
Të ardhura nga tarifë për ndriçimin publik nga familje	7,337	1,938	
Te ardhura nga tarifë ndricimi nga institucione institucione	18	28	
Të ardhura nga tarifë ndricimi nga biznesi	1,964	1,718	
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin	4,547	2,678	59
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga familjet	2,540	804	
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga institucionet	18	28	
Të ardhura nga tarifa për gjelbrimin nga biznesi	1,989	1,846	
Të ardhura nga tarifa mirembajtje për ujitje,kullim	4,151	911	0
Të ardhura nga tarifa të shërbimit administrativ të bashkisë	21,469	1,692	8
Nga tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit te sistemimeve te jashtme	8,000	197	2
Nga tarifa për vulošje veterinerë të bagëtive të therura	500	766	153
Nga Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit	300	89	30
Nga tarifa parkimi për mjetet e liçensuara, dhe për vendparkime publike	300	305	102
Nga tarifë për dhënie liçensa për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	10,000	0	0
Nga tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.	1,639	144	9
Nga tarifat e shërbimeve që kryen struktura e MNZ	500	95	38
Nga tarifat e miratimit të projektit të MNZ	-	96	
Nga tarifa për zënien e hapësirave publike	30	0	0
Nga tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfillle	-	0	0
Nga linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	200	0	0
TË ARDHURA TË TJERA	18,178	6,752	37
Të ardhura nga kundravajtjet ad ministrative (Gjobat)	2,000	1,100	55
Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve (ndertese)	1,318	789	60
Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve (truall)	3,579	531	15
Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve (toke bujqesore)	1,008	1,289	128
Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve (pyje-kullota)	9,943	2,886	29
Të ardhura nga sekuestrime dhe zhdëmtime	100	0	0
Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve	100	0	0
Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndruesh. të trupëzuara	100	0	0
Të ardhura nga privatizimi	-	0	0
Të ardhura te tjera(dok tenderi, T.gjuetie, kamatvonesa)	30	0	0
Te ardhura tjera (detyrime prapamb viti 2019)	-	150	0
Te ardhura dokumenta tenderi	-	6	0

Burimi:Bashkia Vau Dejës.

Aneksit nr. 3 pika 2.6 Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Prot Bashkisë	Data	Sip. totale e ndërtimit (m ²)	Vlera e taksës (lekë)	Paguar	Pa paguar
1	B. , T. B. Sh.M.	B. E.	D.	318	19.01.2021	300.4	49,028	-	49,028
2	Gj.	P.	M.	2754	05.05.2021	168.4	27,485	-	27,485
3	G.	L.	B.	309	19.01.2021	332	54,186	-	54,186
4	V.	P.	U.	2756	05.05.2021	440	71,812	-	71,812
5	L.,S. M.	M. ,Gj.	L.	3244/3	08.06.2021	105.9	17,284	-	17,284

6	A.	E.	Sh.	4152/2	18.08.2021	105.8	17,268	-	17,268
7	R.	H.	C.	5372	14.09.2021	158.6	25,885	-	25,885
8	Er.	Sh.	T.	311	19.01.2021	153.2	25,004	-	25,004
9	A.	N.	P.	312	19.01.2021	88.4	14,428	-	14,428
10	L.	N.	N.	499/1	03.02.2021	374	61,041	-	61,041
11	Gj.	J.	L.	499/2	03.02.2021	119.6	19,520	-	19,520
12	Z.	G.	K.	499/3	03.02.2021	234.3	38,240	-	38,240
13	P.	Gj.	T.	2757	05.05.2021	154.2	25,167	-	25,167
14	D.	B.	N.	4152/1	18.08.2021	224.6	36,657	-	36,657
15	V. ,M., V.,S.	Z.,V.	M.	5512/1	08.11.2021	84.5	13,791	-	13,791
		Totali				3,043.9	496,796	-	496,796

Burimi: *Bashkia Vau Dejës*

Aneksi nr. 4 pika 2.6 Subjektet e tregtimit të karburanteve dhe nënprodukteve të tyre që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Vau Dejës

Nr.	Emri Subjektit	Nipt-i	Dt leshim autorizimi	Afati i autorizimit	Detyrimi per autorizim	Pagesat e kryera	Diferenca
1	A.E.LI.	L.....F	178/10/2016	17/10/2021	2,000,000	200,000	1,800,000
2	L.-A	K.....C	27/02/2020	26/02/2025	1,000,000	1,000,000	-
3	I. Z. Sh.P.K	L.....7O	24/5/2017	23/5/2022	1,000,000	100,000	900,000
4	F-O. G.	L.....C	20/02/2014	19/2/2019			
5	Ç. Sh.P.K	L.....P	11/3/2017	10/3/2022	2,000,000	200,000	1,800,000
6	"G. C. Gkg"	K.....T		Pa liçence	1,000,000		1,000,000
7	V. 3	J.....Ë		Pa liçence	1,000,000		1,000,000
8	F-P.	L.....K		Pa liçence	1,000,000		1,000,000
9	S.Sh.P.K	K.....S		Pa liçence	1,000,000		1,000,000
10	J. P.	L.....I	6/9/2017	5/9/2022	1,000,000	100,000	900,000
11	D.-Al	L.....U		Pa liçence	1,000,000		1,000,000
12	P.P.	L.....G	25/10/2018	24/10/2023	1,000,000	1,000,000	-
13	V. D.	L.....R	26/3/2018	25.3.2019	200,000		200,000
14	A-D.	K.....F		Pa liçence	1,000,000		1,000,000
15	G. P. Sh.P.K	L.....P	4/12/2019	3/12/2024	1,000,000	1,000,000	-
16	N.-O. Sh.P.K	L.....U	16/8/2017	15.8.2022	1,000,000	100,000	900,000
17	V.Gj.	L.....L		Pa liçence	1,000,000		1,000,000
18	S.SH.P.K	K.....S		Pa liçence	1,000,000		1,000,000
19	V. N.2015	L.....S		Pa liçence	1,000,000		1,000,000
20	GD-O.	L.....D		Pa liçence	1,000,000		1,000,000
21	E.SHPK	L.....D		Pa liçence	1,000,000		1,000,000
	total				23,000,000	4,700,000	19,300,000

Burimi: *Bashkia Vau Dejës*

Aneksit nr. 5 pika 2.6 Gjoha e Vendosura nga IMTV për periudhën objekt auditimi.

Nr.	Subjekti	Nr. data e vendimit	Arsyeja/Shkaku i gjobës	Vlera e gjobës	Situata aktuale e gjobës		Totali pa likuiduar
					Likuiduar	P. gjyqësor	
1	P. AS Shpk	33,dt 04.03.21	Tejkalim afati	100,000	100,000		0
2	Sh. E.M.	12,dt 14.05.21	Ndertim pa leje	500,000			500,000
3	T.D.P.	38,dt 21.05.21	Tejkalim afati	500,000			500,000

4	Z. Gj.K.	37,dt 17.05.21	Tejkalim afati	100,000	100,000		0
5	Z. Gj. N.	39,dt 14.07.21	Tejkalim afati	100,000	100,000		0
6	Xh.A. B.	41, dt 09.09.21	Tejkalim afati	100,000			100,000
7	L. Shpk	42,dt 27.09.21	Tejkalim afati	100,000			100,000
8	Z. A. H.	19,dt 12.10.21	Ndertim pa leje	500,000			500,000
9	I. F. Shpk	44,dt 01.12.21	Tejkalim afati	100,000	100,000		0
10	I. F. Shpk	45,dt 21.12.21	Tejkalim afati	100,000	100,000		0
11	P.Gj. D.	46,dt 28.12.21	Ndertim pa leje	500,000			500,000
TOTALI				2,700,000	500,000	-	2,200,000

Burimi: *Bashkia Vau Dejës*

Aneksi nr. 1 pika 3 Formati nr.1 i pasqyrave financiare për vitin 2021

Nr. Rreshti	Referenca e Logarive	EMËRTIMI	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
1	A	A K T I V E T	4,570,170,802	4,475,363,374
2		I.Aktivët Afat shkurtër	235,654,205	252,028,430
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	217,559,358	190,210,054
4	531	Mjete monetare në Arke		
5	512,56	Mjete monetare në Banke		
6	520	Disponibilitete në Thesar	216,585,008	188,778,304
7	50	Letra me vlerë		
8	532	Vlera të tjera	974,350	1,431,750
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provizione zhvlerësimi letra me vlerë (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	12,771,150	15,233,387
12	31	Materiale	6,899,100	9,801,725
13	32	Inventar i imet	5,872,050	5,431,662
14	33	Prodhim në proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe në rritje e majmeri		
18	37	Gjendje të pambërritura, ose pranë të treta		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provizione për zhvlerësimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari të Arketueshme	1,980,837	2,006,803
22	411	Kliente e llogari të ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjopa		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore që mbulohe në shteti		
27	435	Sigurime Shoqërore		
28	436	Sigurime Shëndetsore		
29	437,438,	Organizma të tjera shtetërore		
30	44	Institucione të tjera publike		
31	465	Efekte për tu arketuar nga shitja e letrave me vlerë		
32	468	Debitorë të ndryshëm	1,550,494	1,550,494
33	4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	430,343	456,309
34	45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)		

36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	3,342,860	44,578,186
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes të marredhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	3,342,860	44,578,186
42	Klasa 4	Te tjera aktive afatshkurtra		
43		II.Aktivet Afat gjata	4,334,516,597	4,223,334,944
44		1.Aktive Afatgjata jo materiale	61,220,902	61,220,902
45	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
46	202	Studime dhe kerkime	61,220,902	61,220,902
47	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
48		2.Aktive Afatgjata materiale	4,231,430,672	4,160,016,007
49	210	Toka, Troje, Terrene	6,208,378	6,208,378
50	211	Pyje, Plantacione	113,039,105	113,039,105
51	212	Ndertesa e Konstruksione	1,787,556,508	1,769,967,304
52	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	2,123,426,367	2,082,261,462
53	214	Instalime teknike, makineri e paisje	52,920,775	46,937,264
54	215	Mjete Transporti	42,732,433	35,829,016
55	216	Rezerva Shteterore		
56	217	Kafshe pune e prodhimi		
57	218	Inventar ekonomik	105,547,106	105,773,478
58	24	Aktive afatgjata te demtuara		
59	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
60		3.Aktive Afatgjata Financiare	0	
61	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
62	26	Pjesemarrje ne kapitalin e vet		
63		4.Investime	41,865,023	2,098,035
64	230	Per Aktive Afatgjata jomateriale	398,800	398,800
65	231	Per Aktive Afatgjata materiale	41,466,223	1,699,235
66	232	Transferime kapitale		
67	B	PASIVET	4,570,170,802	4,475,363,374
68		I.Pasivet Afat shkurtra	105,414,488	174,537,366
69		1. Llogari te Pagueshme	105,414,488	105,013,632
70	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	39,766,988	
71	42	Detyrime ndaj personelit	14,719,865	14,726,956
72	16,17,18	Hua Afatshkurtra		
73	460	Huadhenes		
74	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	947,426	891,906
75	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
76	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
77	435	Sigurime Shoqerore	4,379,413	4,355,094
78	436	Sigurime Shendetsore	601,918	599,449
79	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
80	44	Institucione te tjera publike		
81	45	Marredhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
82	464	Detyrime per tu paguar per bl. e letrave me vlere		
83	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	40,737,035	39,862,041
84	467	Kreditore te ndryshem	4,261,843	44,578,186
85	4341	Operacione me shtetin(detyrime		
86	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		

87		2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	69,523,734
88	419	Kreditore, Parapagime		
89	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		69,523,734
90	476	Te ardhura te caktuara për tu perdorur		
91	478	Diferenca konvertimi pasive		
92	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
93	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
94		Te tjera pasive afatshkurtra		
95		II.Pasivet Afatgjata		
96	Klase 4	Llogari te pagueshme		
97	16.17,18	Huate Afat gjata		
98		Provizijonet afatgjata		
99	C	AKTIVET NETO/ FONDET NETO (A-B)	4,464,756,314	4,300,826,008
100		FONDET NETO PERBEHEN NGA :		
101	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	4,366,360,220	4,236,470,296
102	12	Rezultatet e mbartura		
103	85	Rezultati i Veprimtarise Ushtrimore	70,583,113	40,923,232
104	111	Rezerva		
105	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	27,812,981	3,824,327
106	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		19,608,153
107	107	Vlera e mjeteve te caktuara ne perdorim		
108	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
109		Nga faktore te tjere		

Burimi Bashki Vau Dejës

Aneksi nr. 2 Pika 3 Inventari i llogarisë 202 "Studime dhe kërkime " me 31.12.2021

Nr.Rend	Emërtimi	Gjendje ne vitin 2020	Shtesa 2021	Gjendje ne vitin 2021
	TOTALI	61,220,902	-	61,220,902
1	Hartimi I studimit pergjate autostrades dhe master plani I kesaj zone	8,300,000		8,300,000
2	oponence teknile per vendepozitim	445,232		445,232
3	projek irugesBarbullush-qender-dedaj	397,000		397,000
4	studim projektim rik shtese zyrat e komunes	470,000		470,000
5	studim projektim ujesjelles ashte-konaj-Mali jushit	1,825,000		1,825,000
6	oponence teknike pere ujesjellesat Kosmac,Stajke,Plezh	142,622		142,622
7	projektimim iruges varreza Bushat	98,400		98,400
8	projektimi I rruges nacinale Kukel	168,000		168,000
9	projektim I rruges varreza Melgushe	105,600		105,600
10	projektim I rruges suplezStajk	397,200		397,200
11	projekt -preventiv per rrethimin e rezervuarve te Komunes te fshatrave Rranxa,kukel,Bushat1 ,Bushat 2.Bushat3	159,400		159,400
12	projekt preventiv per rrethimin e stacionit te pompave te Komunes te fshatrave Rranxa,Kukel,Bushat1 ,Bushat2.Bushat 3	104,760		104,760
13	studim mjedisor mjedisor landfiel	150,000		150,000
14	studim mjedisor shkolla e fermereve Bushat	50,000		50,000
15	studim projektim per ujesjellesat e fshatrave Hoten,Fshat I Ri,Konej,Ashte,Kosmac,Plezhë,Melgush 2,Kukel 2	282,000		282,000
16	projekt preven rrethim rezervuari UJI B1,B2.B3 Rranxa,Kulel.Barbullush	239,100		239,100
17	projekt preven rrethim stacioni I pompave te ujit B1,B2.B3 Rranxa,Klulel.Barbullush	157,140		157,140
18	oponence teknike per ujesjellesat	138,587		138,587
19	hart projektit per objektin rik rruga Trush I poshtem-fshat I ri-Mali Jushit-hoten-kukel 60%	1,168,560		1,168,560
20	hart projektit per objektin rik rruga Trush I poshtem-fshat I ri-Mali Jushit-hoten-kukel 40%	779,040		779,040
21	Pregatitje projekti ,sistemim asfaltim I rruges se varrezave fshati kosmac,KON, NR 710/1 DT 14.05.2015,LEK 180000, Furnitor Bledar Dizdari,2302100	180,000		180,000

22	Pergatitje projekti „sistemim asfaltim I rruges se varrezave fshati stajke,NR 710/2 DT 14.05.2015,LEK 300000, Furnitor Bledar Dizdari	300,000		300,000
23	Projekte me donator(PROJEKTI PAKTI NDERKIFITAR,TRASHIGIMIA KULTURORE,VRESHTARIADSATOËARDS MODERNENTERPRISE)	33,125,761		33,125,761
24	Hartimi Rregullores Planifikimit urban	348,000		348,000
25	Projek.sist.asfalt.Rrug.D.N.Mazrreku	46,000		46,000
26	Projek.Sist.asf.Rrug. Pallateve	42,800		42,800
27	Projekt Rikonstruksion Bashkise	120,000		120,000
28	Projekt Nderim ura Dheu lehte-Vig	120,000		120,000
29	Pergatitje projekti (Rik Godina Bashkise faza II) (kap 05)	119,100		119,100
30	Pergatitje projekti (Rik Godina Nj.A.Hajmel dhe Vig-Mnele) (kap 05)	120,000		120,000
31	Pergatitje projekti "Projekti I rruges Ashte, Kosmaç, Nj.A. Bushat"	114,000		114,000
32	Pergatitje projekti "Sistemim Asfaltim I rruges se Xhamise Bushat, sistemim asfaltim I rruges se varrezave, Bushat, ndertim trotuari, fshati Bushat, Nj.A Bushat	114,000		114,000
33	Pergatitje projektsh rruge: Sistemim asfaltim I rruges Qender Spathar-rruge Nacionale, Sistemim asfaltim I rruges Rruga Nacionale Mjede-Kaçë, Sistemim asfaltim I rruges Qender Stajke-Varreza, faza II, Sistemim asfaltim I rruges Qender Ashte Varreza	117,600		117,600
34	Studim gjeologjik-inxhinierik, bazamenti I I ures Hajmel dhe studimi gjeologjik-inxhinierik I bazamentit te ures Barbullush, Bashia Vau Dejes	72,000		72,000
35	Hartim projektsh(1.Rikonstruksion I kopshteve te femijeve ,oborreve dhe kendeve te lojrave te fshatrave Naraç,Mjede.Kosmaç,Barbullush,Kukel,Vau Dejes.2.Rikonstruksion I rrjetit KUZ Nënshat.3.Sistemim asfaltim I rruges fshati Kukel.4.Ndertim trotuari dhe vendosje e barrierave brojtese qender fshati Barbullush.5.Sistemim oborri dhe terreneve sportive,shkollat 9-vjeçare,Fshati Ri,Rranxa,Naraç,Nenshat,Barbullush,Kukel.6.Rikualifikim i qendres fshati Kosmaç7..F.V barriera mbrojtese per kembesoret ne segmentet nga kryqezimi i Rranxave deri ne fshatin Bushat.8.Sistemim asfaltim i rruges Bushat-PLezhë-Superstrate.9.Rikonstruksion i nyjeve hidrosanitare i shkollës 9 vjeçareBarbullush.10.Sistemim asfaltim i rruges te lagjes "Kapedani" Qyteti Vau Dejes.11. Rikualifikim qendres fshati Stajke.12.Sistemim asfaltim i rruges se xhamise fshati Bushat faza e II.13.Sistemim i bankinave te rruges Kosmaç,Stajke,Melgush,Gjondrekaj,Barbullush.14.Sistemim asfaltim i rruges se lagjes Muçejan.15.Sistemim i shesheve dhe rrethim varrezash te fshatrave Rranxa,Hajmel,Nenshat,Dheu i lehte.16.Nderti i ures ne lagjen "Kovaçë" Nj.A Hajmel dhe Ures se fshatit Hoten Nj.A Bushat17.Sistemim asfaltim i rrugeve te brendshme te fshatit Konaj).	744,000		744,000
36	Hartim projektsh per menaxhimin e infrastruktures ujitjes dhe kullimit (kap.05)	2,988,000		2,988,000
37	Hartim projektsh per menaxhimin e infrastruktures ujitjes dhe kullimit (kap.05)	1,632,000		1,632,000
38	Hartim projektsh per menaxhimin e infrastruktures ujitjes dhe kullimit (kap.05)	360,000		360,000
39	Hartim projektsh per menaxhimin e infrastruktures ujitjes dhe kullimit (kap.05)	1,992,000		1,992,000
40	Hartim projektsh e rikonstruksionit te arsimit baze parashkollor(kap.05)	2,988,000		2,988,000

Burimi: Sektori i Financës

Aneksi nr. 4 pika 3 Në mënyrë të detajuar paraqiten pronat të cilat janë aplikuar për regjistrim në ASHK për periudhën 2020 - 2021 si vijon:

Nr	Emertimi i Pasurisë	Zona kadastral	Nr Pasurise	Indeksi I harte	Siperfaqia sipas V.K.M.		Data e aplikimit Nr. Dt.	Vertetim ose certifikate Hipoteke	Siperfaqia sipas Faktit	
					Truall	Ndert			Truall	Ndert
1	Truall+Ndertese	3506	442	34-76-3-BD	6437	819	11.09.2020		6437	819
2	Kullote	3205	381/1	K-34-76-3	184871		09.04.2020			
3	Truall+Ndertese	2763	149/2	K-34-64-245-C	400	90	16.09.2020		400	90
4	Lapidar	2702	85/41/S1	K-34-64-244-D	80	80	16.09.2020		80	80
5	Truall+Ndertese	3498	150	K34-64-244-C	950	140	16.09.2020		tjetersim prone	
6	Ndertese	8598	1/54	L;C-5		190	10.04.2020			190
7	Ndertese	1057	225/19	K-34-64-(242-A)	400	400	09.04.2020		400	400
8	Truall+Ndertese	8598	1/29	L;D-5	663	663	10.04.2020		663	663
9	Truall+Ndertese	3205	252/8	K-34-76-(33-B)	91	91	09.04.2020		91	91
10	Truall+Ndertese	2763	98/1	K-34-76-(5-C)	13950	540	09.04.2020		13950	540
11	Truall+Ndertese	2702	85/28	K-34-64-(244-D)	4500	650	09.04.2020		4500	650

12	Truall+Ndertese	1920	411/15	K-34-76-(21-C)	235	180	09.04.2020		235	180
13	Truall+Ndertese	2975	38	K-34-76-(19-B)	6100	700	09.04.2020		6100	700
14	Truall+Ndertese	1920	411/52	K-34-76-(21-C)	5000	360	09.04.2020		5000	360
15	Truall+Ndertese	1920	411/49	K-34-76-(21-C)	2500	250	09.04.2020		2500	250
16	Truall+Ndertese	8598	5/83		324	324	16.09.2020	25.06.2021	324	324
17	Shesh	8598	5/82		112		16.09.2020	25.06.2021	112	--
18	Varreza	2236	110		2600		16.09.2020	25.06.2021	2600	
19	Shesh	8598	5/85		465		16.09.2020	25.06.2021	465	
20	Terren Sportiv	3205	253		2125		16.09.2020	25.06.2021	2125	
21	Truall+Ndertese	8598	5/86		602	602	16.09.2020	25.06.2021	602	602
22	Truall+Ndertese	1329	85/2		4950	1399	25.05.2020	30.06.2021	4950	1399
23	Shesh	1329	85/3		380	--	25.05.2020	30.06.2021	380	
24	Truall+Ndertese	2708	663		29180	250	09.04.2020	28.04.2020	29180	250
25	Shesh	8598	1/471		8646	--		4.10.2019	8646	
26	Truall	2702	237/1		92600	--		7.10.2019	92600	
27	Truall+Ndertese	8598	1/22		581	581	09.04.2020	27.04.2020	581	581
28	Truall+Ndertese	8598	1/23		5334	375	09.04.2020	30.04.2020	5334	375
29	Truall+Ndertese	2015	109/7		288	100	09.04.2020	30.04.2020	288	100
30	Truall+Ndertese	2097	162		4100	260	09.04.2020	05.05.2020	4100	260
31	Truall+Ndertese	2707	974		5595	570	09.04.2020	27.04.2020	5595	570
32	Truall+Ndertese	3769	391		12086	185	09.04.2020	30.04.2020	12086	185
33	Kullote	1100	284/4		114180		09.04.2020	14.05.2020		
34	Kullote	3389	425/6		113934			Vertetim Hipotekor, dt 14.05.2020		
35	Kullote	2993	148/1		571651		09.04.2020	13.05.2020		
36	Are	2015	125/35		5911		05.02.2020	26.02.2021		
37	Shesh	8598	5/82	L-B-5	112			25.06.2021	112	
38	Truall	8598	5/86	L-B-5	602	602		25.06.2021	602	
39	Shesh	8598	5/85	L-B-5	465			25.06.2021	465	
40	Arë	2015	125/35	K-34-76-(20-B)	5911			26.02.2021	5911	
41	Truall	8598	5/83	L-B-5	324	324		25.06.2021	324	
42	Shesh	1329	85/3	K-34-76-(2-C)	380			30.06.2021	380	
43	Terren Sportiv	3205	253	K-34-76-(33-B)	2125			25.06.2021	2125	
44	Shesh	1329	85/2	K-34-76-(2-C)	4950	1399		30.06.2021	4950	1399
45	Varreza	2236	110	K-34-64-(242-D)	2600			25.06.2021	2600	

Burimi Bashkia Vau Dejës

Aneksi nr. 3 pika 3 Formatin nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”

Nr. Rreshti	Nr. Reference Llogarie	E M Ë R T I M I	Teprica në fillim			Shtesat gjatë vitit		Teprica në Fund		
			Kosto Historike	Amortizim i Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
a	b	c	1	2	3	4	5	8	9	10
1	20	I. AAGJ/JO MATERIALE	61,220,902	0	61,220,902	0	0	61,220,902	0	61,220,902
2	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave			0			0	0	0
3	202	Studime dhe kerkime	61,220,902		61,220,902			61,220,902	0	61,220,902
4	203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme			0			0	0	0
5	21,28	II. AAGJ/ MATERIALE	4,458,225,100	298,209,093	4,160,016,007	84,515,807	13,101,142	4,542,740,907	311,310,235	4,231,430,672
6	210	Toka,troje, Terene	6,208,378		6,208,378			6,208,378	0	6,208,378
7	211	Pyje,Kullota Plantacione	113,039,105		113,039,105			113,039,105	0	113,039,105
8	212	Ndertime e Konstruksione	1,858,505,927	88,538,623	1,769,967,304	22,945,932	5,356,728	1,881,451,859	93,895,351	1,787,556,508
9	213	Rruge,rrjete,vepra ujore	2,178,634,503	96,373,041	2,082,261,462	47,554,989	6,390,084	2,226,189,492	102,763,125	2,123,426,367
10	214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	64,299,449	17,362,185	46,937,264	6,143,126	159,615	70,442,575	17,521,800	52,920,775
11	215	Mjete transporti	113,311,705	77,482,689	35,829,016	7,032,000	128,583	120,343,705	77,611,272	42,732,433
12	216	Rezerva shtetore			0		0	0	0	0
13	217	Kafshe pune e prodhimi			0		0	0	0	0
14	218	Inventar ekonomik	124,226,033	18,452,555	105,773,478	839,760	1,066,132	125,065,793	19,518,687	105,547,106
15	24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara			0			0	0	0
16	28	Caktime			0			0	0	0
17		TOTALI (I + II)	4,519,446,002	298,209,093	4,221,236,909	84,515,807	13,101,142	4,603,961,809	311,310,235	4,292,651,574

Burimi: Sektori i Financës

Për sa më sipër është hartuar ky Raport Përfundimtar i Auditimit.

GRUPI I AUDITIMIT

H.I.

A. T.

E. V.

G.P.

DREJTORI I DEPARTAMENTIT

Bledar DORACAJ